



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

“Projektet kërkimore-shkencore të realizuara nga Akademia e Shkencave, në nxitjen e përparimit shkencor, teknologjik dhe inovacionit, për të mirën e vendit”

Tiranë, shkurt 2025

P Ë R M B A J T J A

1.1 Konteksti i problemit social.....	5
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës	6
1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë.....	6
2. SUBJEKTET NËN AUDITIM	7
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....	7
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	9
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit:	10
2.4 Pesha në buxhet	12
2.5 Përkufizimet dhe terminologjia	12
2.6 Skema e analizës së programit auditues.....	13
2.7 Feedback-u i subjektit në fazën studimore	14
3. DETAJET E AUDITIMIT.....	16
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit	16
3.2 Objektivi i auditimit.....	17
3.3 Pyetjet e auditimit	17
3.4 Fushëveprimi i auditimit	18
4.SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE.....	18
V. TRAJTIMI I OBSERVACIONEVE TË SUBJEKTEVE.	47
VI. ANEKSE.....	57

AKRONIMET

RSH	Republika e Shqipërisë
BE	Bashkimi Evropian
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
ASHSH	Akademia e Shkencave e Shqipërisë
ASHAK	Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës
VKM	Vendimi i Këshillit të Ministrave
INTOSAI	The International Organization of Supreme Audit Institutions
EUROSAI	The European Organisation of Supreme Audit Institutions
ISSAI	International Standards of Supreme Audit Institutions

PËRMBLEDHJA

Auditimi me temë “Projektet kërkimore-shkencore të realizuara nga Akademia e Shkencave, në nxitjen e përparimit shkencor, teknologjike dhe inovacionit, për të mirën e vendit” ka pasur si objekt kryesor vlerësimin e procesit administrativ të ASH sa i përket aplikimit, shqyrtimit dhe miratimit të projekteve dhe kërkimeve shkencore të financuara prej saj. Periudha objekt auditimi ka qenë 2019-2023. Përgjatë këtij auditimi është diskutuar me përfaqësues të ndryshëm të Akademisë së Shkencave për të mbledhur informacion sa më të saktë mbi mënyrën se si planifikohen projektet dhe punimet shkencore, si vlerësohen dhe shqyrtohen nga ato nga strukturat e ASH-së dhe si respektohen kriteret e përcaktuara të këtij procesi. Gjithashtu një tjetër fokus i këtij auditimi ka qenë edhe transparenca e procesit të realizimit të projekteve e kërkimeve shkencore. Siç jemi shprehur edhe përgjatë të gjithë ecurisë së procesit të auditimit, grupi i auditimit nuk ka pasur objekt vlerësimin dhe interpretimin lidhur me cilësinë e kërkimeve shkencore në vetvete, por vetëm të procesit administrativ lidhur me aplikimin, shqyrtimin, përzgjedhjen dhe miratimin e tyre. Drejtimet kryesore të fokusimit në këtë auditim kanë qenë përshtatshmëria e kuadrit rregullator të Akademisë së Shkencave, përmbajtja e dosjeve fizike të projekteve të analizuara si dhe menaxhimi financiar i tyre. Në drejtim të elementit të parë është konkluduar se Akademia e Shkencave të Shqipërisë nuk ka hartuar dhe nuk ka miratuar një plan strategjik zhvillimor institucional i cili do të duhej të shpaloste qartë misionin dhe vizionin e këtij institucioni lider në fushën e shkencave në Shqipëri. Kështu, krahas mungesës së përcaktimit të objektivave të qartë e konkretë lidhur me zhvillimin dhe rritjen e ndikimit të studimeve e punimeve shkencore, mungon gjithashtu një rregullore e qartë për mënyrën e organizimit, orientimit dhe përcaktimit të kriterëve që duhet të përmbushin projektet e propozuara. Akademia e Shkencave të Shqipërisë ndryshe nga institucionet homologe ndërkombëtare të saj është më e mbyllur në drejtim të realizimit të projekteve, punimeve e simpoziumeve shkencore duke qenë se në këto marrin pjesë përgjithësisht studiues e kërkues të strukturave të brendshme të Akademisë. Në drejtim të përmbajtjes apo përbërjes të dosjeve fizike i cili është edhe elementi i dytë i trajtuar në këtë raport auditimi, Akademia e Shkencave të Shqipërisë nuk ka siguruar një menaxhim të duhur dhe sistematik të dokumentimit të veprimtarisë lidhur me projektet e kërkimit shkencor. Fillimisht, mungesa e një akti rregullator ku të përcaktohej procedura, e më tej hartimi e miratimi i Udhëzimit nr. 1, datë 27.02.2023, i cili përcakton në mënyrë tejet të përgjithshme hapat që ndiqen në këtë procedurë, ka krijuar mundësinë e diferencimeve dhe riskun në ndjekjen e ecurisë së projekteve të kërkimit shkencor. Është evidentuar mungesë transparence lidhur me publikimin e rezultateve të projekteve për kërkimin shkencor, me qëllim transferimin e aftësive dhe njohurive të reja në përfitimin e përgjithshëm publik.

Gjithashtu, mosrespektimi i normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, duke mos evidencuar në regjistrin e korrespondencës dhe duke mos numërtuar sipas përcaktimeve ligjore të gjithë dokumentet e krijuara nga vetë institucioni dhe ato të ardhura nga zbatuesit e projekteve, ka pamundësuar ndjekjen dhe gjurmimin e përshtatshëm të kronologjisë së veprimeve dhe proceseve.

Së fundmi, lidhur me menaxhimin financiar për projektet kërkimore shkencore krahas mos përcaktimit të një zëri buxhetor të dedikuar mbi kërkimin shkencor, evidentohet mungesë e regjistrimit të parashikimit të nevojave për çdo vit buxhetor në lidhje me kërkimin shkencor, si dhe se nuk janë përmirësuar metodikat dhe udhëzuesit mbi programin, shpalljen e thirrjes për projekte, realizimin, financimin, kontrollin e brendshëm dhe transparencën mbi monitorimin e projekteve kërkimore - shkencore.

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

1.1 Konteksti i problemit social

Akademia është institucioni publik më i lartë që përfaqëson e mbart vlerat më të mira të shkencës, të kërkimit shkencor, të krijimtarisë dhe të debatit e bashkëveprimit të mendimit shkencor në vend, përmes një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh e krijuesish.¹

Në Shqipëri fjala “Akademi” u përmend për herë të parë më 1750, kur në Voskopojë u krijua e ashtuquajtura “Akademia e Re”, që ishte një shkollë e mesme, por dhe një qendër kulturore e mirënjohur brenda dhe jashtë vendit. Ndonëse “Akademia e Re” nuk kishte ndërtimin dhe detyrat e Akademive të Shkencave në vende të tjera të Evropës, ajo është pjesë e përpjekjes e ruajtjes së trashëgimisë dhe zhvillimeve kulturore të popullit shqiptar. Më pas, Rilindja Kombëtare me përpjekjet e saj për të zgjuar ndërgjegjen tonë kombëtare i dha një shtytje të madhe edhe përparimit të mendimit shkencor për çështje të historisë së popullit shqiptar, të traditave e të gjuhës së tij, për përhapjen e arsimit në gjuhën amtare etj. Akademizmi shqiptar do të merrte një formë më të zgjeruar pas Shpalljes së Pavarësisë në Nëntor 1912. Në shumë qytete u krijuan disa qendra kulture dhe klube që kryenin edhe funksione studimore. Këto përpjekje të para për të krijuar shtratin e shkencës shqiptare u shtuan dhe u bënë më të organizuara me konsolidimin e shtetit shqiptar, pas Kongresit të Lushnjës. U ngritën disa shërbime të veçanta që kryenin edhe ndonjë funksion studimor, si Shërbimi veterinar ose epidemiologjik (1928), ferma e Xhafzotajt e ndonjë tjetër. Edhe kërkues të huaj, si F. Nopça, H. Luis, F. Markgraf, A. Hajek, E. Durham, L. Rey etj., dhanë ndihmesën e tyre të çmuar për zhvillimin e studimeve shqiptare, duke çuar më tej traditën e studimeve albanologjike të shekullit XIX. Akademia e Shkencave është themeluar më 10 tetor 1972. Themelimi i saj ishte kurorëzimi i përpjekjeve shekullore për zhvillimin e akademizmit shqiptar. Mbledhja e parë e Asamblesë së Akademisë së Shkencave u mbajt më 25 janar 1973. Profesor Aleks Buda u zgjodh Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në fillimet e saj Akademia kishte 20 anëtarë të rregullt dhe 5 anëtarë korrespondentë; ajo funksiononte me një varg institutesh të shkencave shoqërore dhe albanologjike, si dhe të shkencave natyrore e teknike. Akademia e Shkencave përbënte institucionin më të lartë shkencor në vend dhe varej nga Këshilli i Ministrave. Organet drejtuese të Akademisë së Shkencave ishin Asambleja dhe Presidiumi. Sikurse edhe sot, Asambleja ishte organi më i lartë drejtues i ASH-së dhe përbëhej nga anëtarët dhe anëtarët korrespondentë. Ajo mund të kishte gjithashtu edhe anëtarë nderi dhe anëtarë të jashtëm.²

Akademia e Shkencave e Shqipërisë nuk ka ndonjë traditë për punën me projekte të mbështetura me buxhetin e saj. Tradita e mëhershme e ngarkimit të saj me detyra projektimi të nivelit qeveritar dhe institucional, me shuarjen e 13 instituteve në vitin 2007, u ndërpre. Përjashtim bëjnë tre projektet madhore në albanologji: Fjalori i madh i shqipes, Histori e shqiptarëve dhe Enciklopedia shqiptare, që kanë mbështetje të drejtpërdrejtë si projekte ndërqeveritare. Me miratimin e Ligjit 53/2019 u krijua hapësirë ligjore për ngritjen e njësive dhe qendrave të përkohshme të kërkimit dhe riorganizimin e buxhetit në mënyrë të atillë që dy përbërëseve kryesore të mëparshme të veprimtarisë së ASHSH, botimeve dhe konferencave, t’u shtoheshin dhe projektet, që janë dukuri e re në zhvillimin e progresin e saj. Projektet janë ura të ndërveprimit midis trupës akademike, njësive e qendrave dhe rrjetit

¹ Ligji nr. 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë, neni 3 pika 1

² <https://gazetatdita.al/sfidat-e-akademise-e-krijuan-mendjet-me-te-ndritura-te-shqiperise-sot-ben-50-vjec-por-a-eshte-atje-ku-duhet/>

kombëtar të kërkimit. Përmes tyre janë përfshirë në kërkim studiues e profesorë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, si dhe nga arbëreshët.³

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200), Manuali i Auditimit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficientia dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit. KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë një panoramë të qartë lidhur me procesin e aplikimit, shqyrtimit, vlerësimit dhe miratimit të projekteve dhe kërkimeve shkencore sa i përket procesit administrativ të tyre pa ndikuar kurrësi në aspektin profesional apo cilësor të veprave apo punimeve shkencore të Akademisë së Shkencave.

1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë

K Kontrolli i Lartë i Shtetit në veprimtarinë e tij audituese, gjatë viteve të fundit është duke i kushtuar një rëndësi gjithmonë e më të madhe institucioneve të ndryshme që në fokus të veprimtarisë së tyre kanë kërkimin shkencor, realizimin e projekteve dhe studimeve në fusha të ndryshme me qëllim maksimizimin e përfitimeve jo vetëm ekonomike, por edhe sociale, kulturore, historike e më gjerë. Më konkretisht KLSH ka kryer:

- Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë i ushtruar në Akademinë e Shkencave për periudhën nga 01.01.2021 deri më datë 31.12.2023, i cili konkludoi me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 88, datë 16.05.2024.
- Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për projektin “Cilësi dhe barazi në arsim”, me objekt auditimi “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare, të projektit”, për periudhën nga data 31.08.2010 deri me datë 31.12.2012 i miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 36, datë 22.04.2013.
- Auditimin e performancës me temë “Performanca e universiteteve publike gjatë periudhës së pandemisë” për periudhën nga data 01.01.2019 deri në datën 31.12.2021 i ushtruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Universiteti Politeknik Tiranë, Universiteti “A. Xhuvani” Elbasan, Universiteti “Fan. S. Noli” Korçë, Universiteti “I. Qemali” Vlorë, i miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 206, datë 26.10.2022.

³ Email nga ASH, dt 14.06.2024

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjekti i përfshirë në këtë auditim është Akademia e Shkencave të Shqipërisë. Akademia është institucioni publik më i lartë që përfaqëson e mbart vlerat më të mira të shkencës, të kërkimit shkencor, të krijimtarisë dhe të debatit e bashkëveprimit të mendimit shkencor në vend, përmes një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh e krijuesish.⁴ Akademia është institucion autonom në fushën e kërkimit, që e mbështet veprimtarinë e saj në prova shkencore dhe në dobi të vendit. Akademia, si person juridik, përbëhet nga trupa e shkencëtarëve dhe e kërkuesve, që në këtë ligj do të quhet Asamble.

Akademia si institucion përbëhet nga organet e saj drejtuese:

a) Asambleja

Asambleja është trupa e shkencëtarëve dhe e kërkuesve, e cila përbëhet nga akademikë dhe akademikë të asociuar, të cilët do të quhen anëtarë të Asamblesë.⁵ Numri i akademikëve është deri në 30, ndërsa numri i akademikëve të asociuar është deri në 10.

Anëtarët zgjidhen nga Asambleja ndër mbajtësit e titullit “Profesor”, që kanë një kontribut të veçantë me një ndikim të gjithëpranuar në fushën përkatëse, në bazë të kandidaturave të përzgjedhura nëpërmjet procedurave e kriterëve të përcaktuara në statutin e Akademisë. Në procedurat e kandidimit të përzgjedhjes përfshihen edhe struktura apo përfaqësues të institucioneve të kërkimit shkencor, të arsimit të lartë e të kulturës. Në raste të veçanta, anëtarë zgjidhen personalitete me kontribut të spikatur nga fusha e krijimtarisë artistike, kulturës dhe jetës sociale në përgjithësi. Si rregull, akademikët zgjidhen nga radhët e akademikëve të asociuar. Në rast kandidimi të drejtpërdrejtë, kandidati duhet të marrë mbështetjen e jo më pak se 2/3-ve të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Asamblesë.

Asambleja zgjedh edhe anëtarë të jashtëm ndër personat me shtetësi apo origjinë shqiptare me banim jashtë vendit, figura të shkencës e të kulturës, si dhe anëtarë nderi ndër figurat e shkencës e të kulturës që janë shtetas joshqiptarë me banim jashtë vendit, të cilët me punimet e tyre kanë ndikuar në ecurinë e mendimit e të zbatimit të shkencës në Shqipëri apo në promovimin e të vërtetave dhe të vlerave të origjinës, gjuhës e kulturës shqiptare.

b) Kryesia

Kryesia është organ ekzekutiv i Akademisë.

1. Kryesia përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari shkencor dhe drejtuesit e seksioneve.⁶

2. Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe anëtarët e Kryesisë zgjidhen nga Asambleja me votim të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë me shumicën absolute të votave të vlefshme të anëtarëve të Asamblesë.

c) Kryetari

Referuar *Ligjit nr. 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë, neni 13* dhe *Statutit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë* miratuar me vendimin e Asamblesë nr. 22, datë 18 tetor 2019, neni 32, detyrat e kryetarit janë:

1. Drejton dhe organizon punën e veprimtarinë e Akademisë e të Kryesisë;
2. Përfaqëson Akademinë në marrëdhënie me të tretet dhe nënshkruan në emër të saj;
3. Raporton në Asamble për aktivitetin e përgjithshëm;
4. Raporton në Kryesi për aktivitetin semestral;

⁴ Ligji nr. 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë, neni 3 pika 1

⁵ Ligji nr. 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë, neni 6 pika 1

⁶ Ligji nr. 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë, neni 11 pika 1, 2.

5. Drejton mbledhjet e Asamblesë;
6. Nënshkruan vendimet e Kryesisë dhe të Asamblesë;
7. Zbaton detyrat e përcaktuara në statut;
8. Në zbatimin e detyrave dhe kompetencave të tij, Kryetari nxjerr urdhra të brendshëm;
9. Detyrat e Kryetarit, në mungesë të tij (e me porosi) i kryen Zëvendësi.

Akademia përfshin edhe disa struktura të ngritura në përbërje ose pranë saj, si:

a) seksione

Referuar ligjit dhe mbështetur në Statutin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në Akademi veprojnë *Seksioni i Shkencave Shoqërore Albanologjike dhe Seksioni i Shkencave Natyrore e Teknike*. Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike ndjek veprimtarinë për kërkim e zhvillim në të gjitha shkencat shoqërore dhe ato albanologjike në vend. Në strukturën e këtij seksioni funksionon edhe revista shkencore “*Studia Albanica*”. *Seksioni i Shkencave Natyrore e Teknike ndjek veprimtarinë për kërkim e zhvillim në të gjitha shkencat natyrore e teknike në vend. Në strukturën e këtij seksioni funksionon edhe revista shkencore JNTS.*

Seksionet përbëhen nga anëtarët e rregullt, anëtarët e përhershëm dhe anëtarët e asociuar të Akademisë, sipas profilit përkatës. Për ndjekjen e problemeve specifike të zhvillimit të shkencës, në përbërje të seksionit ngrihen grupe/komisione të posaçme ekspertësh, ku mund të marrin pjesë edhe punonjës shkencorë-mësimorë nga jashtë Akademisë, brenda dhe jashtë vendit.

b) komisione

Pranë Akademisë ngrihen komisione të përhershme ose të posaçme.

2. Në përbërje të komisioneve ka si anëtarë, përveç akademikëve, edhe përfaqësues të institucioneve dhe qendrave të kërkimit shkencor dhe të arsimit të lartë.
3. Komisionet e përhershme ngrihen sipas fushave.
4. Numri, emërtimi, lloji, objekti dhe detyrat e tyre caktohen në Statutin e Akademisë.
5. Komisionet e posaçme ngrihen me vendim të Kryesisë, sipas përcaktimeve në statut.

c) njësi të kërkim-studimit

1. Sipas nevojave, detyrave e problemeve në fushën e kërkimit, në përmbushje të rolit të saj, pranë Akademisë mund të ngrihen njësi të kërkim-studimit me aktivitet afatshkurtër e afatgjatë.
2. Këto njësi janë autonome në realizimin e detyrave të tyre, mbajnë marrëdhënie me Kryesinë e Kryetarin dhe raportojnë pranë tyre.
3. Sipas rëndësisë, problemeve e kohëzgjatjes, këto njësi ngrihen me akte të Asamblesë apo të Kryesisë për njësitë me afat deri në 2 vjet dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për njësitë e tjera.
4. Objekti i tyre, financimi, shtrirja, veprimtaria dhe përbërja përcaktohen në aktet përkatëse që dalin për ngritjen e tyre.

ç) Akademia e të Rinjve

1. Me qëllim inkurajimin e drejtpërdrejtë të veprimtarisë kërkimore-shkencore të kërkuesve të rinj dhe për vendosjen e një ure komunikimi dhe promovimi me ta, funksionon Akademia e të Rinjve, si organ këshillues e bashkëpunues pranë Akademisë. Akademia e të Rinjve ka deri në 20 anëtarë, të zgjedhur nga radhët e kërkuesve të rinj me gradën shkencore “doktor”. Mandati si anëtar është 4–7 vjet dhe ndërpritet në moshën 40 vjeç.
2. Në përbërjen e saj synohet përfaqësimi nga të gjitha fushat kryesore të dijes, kulturës e shkencës.
3. Anëtarët e Akademisë së të Rinjve përfshihen në komisionet e Akademisë, marrin pjesë në mbledhjet e seksioneve, si dhe një përfaqësi prej 3-4 personash nga radhët e tyre marrin pjesë në mbledhjen vjetore të Asamblesë, ku miratohet raporti, plani vjetor e projektbuxheti i Akademisë së Shkencave.

4. Akademia e të Rinjve funksionon si një organizëm autonom në bazë të një statuti të miratuar prej saj dhe me vendim të Kryesisë.

d) biblioteka;

dh) enti botues;

e) administrata ndihmëse.

2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

Akte ligjore e nënligjore:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 53/2019, datë 18.07.2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Udhëzimeve përkatëse;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr.16/2020 “Për prokurimin publik”;
- Ligj nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
- Ligjet vjetore të buxhetit të shtetit;
- Ligji 152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil”, i ndryshuar;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar;
- VKM nr. 918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”;
- VKM nr. 717, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, i ndryshuar;
- Vendimi nr. 36/2020, datë 09.07.2020 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe nivelit të pagave për akademinë e shkencave në Republikën e Shqipërisë" i Kuvendit të Shqipërisë;
- Udhëzimi MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;
- Udhëzimet standard të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit;
- Dispozitat ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e Njësive të Menaxhimit të Projekteve.

Praktika të mira ndërkombëtare

- Plani Strategjik i Akademisë së Shkencave të Turqisë⁷

⁷ <https://www.tuba.gov.tr/files/stratejik/2019-2023-Tuba-Stratejik-Plan.pdf>

- Gjendja financiare institucionale dhe Raporti i parashikimeve i Akademisë së Shkencave të Turqisë⁸
- Rregullore për projektet shkencore e Akademisë së shkencave dhe Arteve të Kosovës
- Këshilli Kombëtar i Kërkimeve i Italisë⁹

2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit:

Konferenca

Seminare

Simpoziume

In memoriam

Çmime Kombëtare

Buletinët Informativë

I. Projekte të ASHSH me financim nga buxheti i shtetit

1. Enciklopedia shqiptare
2. Fjalori i madh i gjuhës shqipe
3. Historia e shqiptarëve (në 3 tre vëllime)
4. Udhëzuesi kombëtar për adoptimin e Eurokodeve
5. Studimi i ndryshimeve mjedisore me imazhet satelitore
6. Ngritja e Kriobankës, e para në Shqipëri për konservimin e materialit gjenetik të specieve dru frutore autoktone në Laboratorin e ri të Qendrës **CRYOFRUIT**
7. Ngritja e një banke kombëtare të ADN në popullatën shqiptare për studime gjenetike në këtë popullatë dhe organizimi i një regjistri kombëtar dhuruesish të qelizave staminale për nevojat e transplantit të këtyre qelizave në Shqipëri **ADN CeLLSTAM**
8. Një platformë e përbashkët për energjinë elektrike në sistemin elektroenergjetik të Shqipërisë dhe Kosovës **PPEE-SESHK**
9. Barleti i rigjetur/rizbuluar - Barleti i heshtur” - Përkthimi nga origjinali e botimi italisht i dorëshkrimit të panjohur të autorit / paratekstut të *De obsidione Scodrensi* të Marin Barletit

II. Projekte të realizuara nga ASHSH me financim nga AKKSHI, periudha 2022-2023

1. Vlerësimi zonal dhe kohor i parametrave fizike, fiziko-kimike dhe sizmike të rrjedhjes së nxehtësisë dhe modelimi i energjisë gjeotermale në zonën e Elbasanit.
2. Përdorimi i metodave bioteknologjike *in vitro* dhe të biologjisë molekulare në përpjekje për të fituar material mbjellës të kategorisë "baze" të kultivarëve autokton të kumbullës.
3. Karakterizimi i variabilitetit gjenetik në popullatat njerëzore shqiptare sipas markerëve gjenetike të ADN-se.
4. Zhvillimi i metodave alternative, inovative dhe ekonomike për kontrollin e cilësisë së produkteve ushqimore.
5. Modifikimi i sensorëve të printuar me nanomateriale për përcaktimin e antibiotikëve në ujëra **MOSENSNANO**.
Projekt bilateral për mobilitet, në bashkëpunim me TUBITAK Turqi.
6. Ruajtja e gjermoplazmës frutore autoktone shqiptare nëpërmjet teknologjisë së farave sintetike dhe konservimi i avancuar në temperatura ultra të ulëta (kriokonservimi në -196°C) **CRYOFRUITS**.

⁸<https://www.tuba.gov.tr/files/malidurum/2023%20Kurumsal%20Mali%20Durum%20ve%20Beklentiler%20Raporu.pdf>

⁹<https://www.cnr.it/>

Projekt bilateral për mobilitet, në bashkëpunim me CNR

III. Projekte me financim nga AKKSHI në kuadër të thirrjes PKKZH 2023-2024

1. Përdorimi i mjeteve molekulare për detektimin e hershëm të infektimit nga *Fusarium & Vlerësimin e tolerancës ndaj faktorëve abiotikë në kultivarë lokalë të grurit (*Triticum aestivum* L.)*
2. Roli i dhene si portator i *Escherichia Coli* ekskretuese të toksina Shiga, bazuar në strategjinë “Një shëndet” .
3. Vlerësimi ekonomik dhe mundësitë e zhvillimit të turizmit natyror i zonave ligatinore (rast studimor Liqeni i Shkodrës).
4. Vlerësimi inovativ i rolit të biomarkerëve dhe bioindikatorëve në cilësinë e produkteve ushqimore detare.
5. Përcaktimi i cilësisë së verërave shqiptare në mënyrë të shpejtë dhe të lirë me metodën *ex situ*.
6. Modelimi i sistemit të integruar të energjisë dhe transportit të energjisë: Roli i energjisë në gaz dhe hidrogjenit në skenarët afatgjatë për Shqipërinë drejt dekarbonizimit të thellë në 2030.
7. Studimi i incidencës së virusit Tomato brown rugose fruit virus, sekuencimi i plotë i gjenomës së izolateve Shqiptare duke përdorur nanoteknologjinë MinION në domatet e kultivuara në serra.
8. Përcaktimi i fosfateve të padeklaruara në ushqime me origjinë shtazore si një mjet i mundshëm drejt parandalimit të mashtrimit.
9. Studimi i rolit diagnostikues të autoantitropave specifike në sëmundjet e sistemit nervor me mekanizma imune.
10. Konferenca Ndërkombëtare në Nanoshkencë dhe Nanoteknologji “Nano Balkan 2023”.

Pavarësisht se AKKSHI nuk ka qenë subjekt i këtij auditimi, duke qenë se Akademia e Shkencave ka aplikuar dhe fituar disa projekte të financuara pjesërisht ose tërësisht nga AKKSHI, grupi i auditimit më poshtë ka përshkruar në mënyrë të përmbledhur objektin e funksionimit të këtij institucioni. “Krijimi i AKKSHI synon ndërtimin e një sistemi modern të shkencës, fuqizimin e kërkimit shkencor dhe teknologjik, si dhe integrimin e tyre në sistemin e arsimit të lartë. AKKSHI lehtëson shkëmbimin e njohurive, veprimtarisë së përbashkët dhe partneritetit brenda dhe jashtë vendit, me qëllim forcimin e kërkimit në vend dhe rajon. Vizioni i themelimit të AKKSHI është krijimi i një strukture koordinuese dhe udhëzuese që bashkëpunon me institucionet në fushën e shkencës dhe teknologjisë duke shërbyer zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, realizohet në përputhje me përparësitë kombëtare, zhvillimin e politikave shkencore dhe teknologjike dhe menaxhimin e Kërkimit dhe Zhvillimit të institucioneve të linjës. AKKSHI ka mision të vlerësojë, financojë, monitorojë dhe administrojë programet dhe projektet në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit në Shqipëri dhe në nivel ndërkombëtar. Vizioni i AKKSHI-t është të zhvillojë shkencën dhe teknologjinë në përputhje me prioritet kombëtare, duke bashkëpunuar me të gjithë institucionet dhe sektorët e linjës. AKKSHI kontribuon në krijimin e infrastrukturës dhe instrumenteve të përshtatshme që zbatojnë politikat e kërkimit dhe zhvillimit në Shqipëri, duke promovuar aktivitete dhe sipërmarrje që zhvillojnë shkencën, teknologjinë dhe inovacionin dhe duke luajtur një rol lider në krijimin e kulturës së kërkimit shkencor.”¹⁰

¹⁰ <https://nasri.gov.al/>

2.4 Peshë në buxhet¹¹

Për vitin 2019 nuk ka fonde të realizuar për kërkimin shkencor. Për vitet 2020 dhe 2021, fondet e kërkimit shkencor janë planifikuar, buxhetuar dhe realizuar në kodin e produktit 92201AA. Për vitet 2022 dhe 2023 janë planifikuar, buxhetuar dhe realizuar në kodin e produktit 92201AB. Në raportet vjetore të monitorimit, vlera e shpenzuar për projekte kërkimore shkencore është pjesë e buxhetit të planifikuar dhe realizuar për produktet përkatës 92201AA për vitin 2020-2021 dhe 92201AB për vitin 2022-2023. Në formatet e raporteve të monitorimit shpenzimet operative për çdo produkt paraqiten në total për gjithë Institucionin (jo me zëra apo me emërtim projekti). Të gjitha shpenzimet e kryera në lidhje me projektet kërkimore shkencore, kontabilizohen sipas llogarive të planit kontabël buxhetor si në llogarinë e shpenzimeve të artikullit “602-Mallra e shërbime” nën llogaritë përkatëse sipas llojit të shpenzimit (shpenzime për udhëtime brenda dhe jashtë vendit, dieta, qira salle, shpenzime të tjera për konferenca dhe honorare).

	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Buxheti sipas produkteve	108,243	195,552	217,084	143,937	212,847
Realizimi produktit	99,850	94,925	123,988	143,230	196,759
Realizimi i Produktit ne %	92%	49%	57%	100%	92%
Fondi realizuar (projekte)	-	4,206	17,752	38,374	67,384
Realizim Projekti kundrejt totalit të produktit ne %	0%	4%	14%	27%	34%

2.5 Përkufizimet dhe terminologjia

“Kërkimi shkencor bazë” është veprimtaria kërkimore-shkencore, që ka për qëllim kryesor zgjerimin, thellimin, rikonceptimin dhe riintegrimin e njohurive shkencore mbi fenomenet e studiuara dhe të kuptuarit teorik të ndërveprimit midis aktorëve të ndryshëm dhe vetë procesit ku ato ndikojnë.

“Kërkimi shkencor i zbatuar” është veprimtaria kërkimore-shkencore, që ka për qëllim të gjejë zgjidhje praktike dhe specifike me objektiv kryesor shfrytëzimin e njohurive teorike, me qëllim zbatimin e tyre në praktikë.

“Në kategorinë “Profesorë” përfshihen titujt akademikë: “Profesor”, “Profesor i asociuar”, “Profesor emeritus”, si dhe titujt “Akademik i asociuar” dhe “Akademik”, të njohura sipas kuadrit ligjor në fuqi.

“Karrierë akademike” është veprimtaria mësimore dhe kërkimore-shkencore e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë.

“Plani buxhetor afatmesëm” është parashikimi i specifikuar i aktivitetit financiar të një institucioni të arsimit të lartë, që pritet të kryhet në një periudhë trevjeçare.

“Plani buxhetor njëvjeçar” është parashikimi i specifikuar i aktivitetit financiar të një institucioni të arsimit të lartë, që pritet të kryhet në një periudhë njëvjeçare.


“Plani strategjik i zhvillimit të institucionit” është dokumenti ku përcaktohen objektivat e institucionit të arsimit të lartë apo të njësisve përbërëse të tij, si dhe mjetet e mënyrat e realizimit të tyre.¹²

¹¹ Të dhënat e të gjitha subjekteve nën auditim për vitin 2023 nuk janë përfundimtare duke qenë se buxheti për vitin 2023 nuk është mbyllur dhe mund/do të përditësohen në vijim të auditimit.

¹² Ligj nr. 80/2015 Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 6.

2.6 Skema e analizës së programit auditues

Skema 1: Modeli Input – Output



2.7 Feedback-u i subjektit në fazën studimore

Auditimi i performancës në ASHSH është iniciuar sipas Njoftimit të Kryetarit të KLSH për fillimin e projektit të auditimit, me nr. 416 date 25.4.2024. Projekti i Auditimit ka si objekt temën “*Projektet kërkimore-shkencore të realizuara nga Akademia e Shkencave, në nxitjen e përparimit shkencor, teknologjik dhe inovacionit, për të mirën e vendit*”.

ASHSH, si subjekt i vetëm dhe i një rëndësie të veçantë sa i takon fokusit të auditimit, fillimisht ka kërkuar shtyrjen e auditimit me pretendimin se: *ASHSH i janë bashkuar institutet e shkencave albanologjike njësi të përhershme të kërkimit shkencor (dikur pjesë e rrjetit të saj)¹³; janë në proces stabilizimi i strukturave, përtëritja e vënia në funksion e këshillave shkencorë; riorganizimi i arkivave të trashëgimisë dhe bibliotekave, etj.* Në vijim, ka patur një vendim të Asamblesë së ASHSH (me nr. 44, datë 22.04.2024) dhe Bordit të Drejtorëve (me nr. 518, datë 09.04.2024), që arrijnë në konkluzionin e tyre se “*auditimi i performancës së kërkimit shkencor e posaçërisht rezultateve të tij është atribut i vetëm i komunitetit shkencor dhe kryhet nëpërmjet ballafaqimit e debatit shkencor e aktiviteteve shkencore e botimeve të specializuara e nga struktura të ngritura posaçërisht për akreditimin dhe rankimin e njësive kërkimore e shkencore. Çdo formë tjetër kontrolli i programit, produktit e metodologjisë shkencore, veçanërisht i ushtruar nga organet e administratës shtetërore përbën cenim të hapur të lirive akademike në kërkimin shkencor...*”.

Edhe në praktika të tjera të mëvonshme, administrative e shkresore¹⁴, nga ana e ASHSH është pretenduar se auditimi i performancës cenon haptazi lirinë akademike, etj., duke krijuar kushte kufizimi dhe bllokimi të procesit dhe veprimtarisë audituese në terren për fazën studimore dhe të punës në terren.

Në komunikimet shkresore e elektronike me drejtues të ASHSH, por dhe në takimet e zhvilluara në mjediset e ASHSH dhe të KLSH-së me përfaqësues të lartë të këtij institucioni, grupi i auditimit ka theksuar e nënvizuar qartësisht se, auditimi i performancës ka për synim të vetëm vlerësimin e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomikitetit në projektet kërkimore e shkencore dhe nuk ka asnjë pikë takimi me cenimin e autonomisë akademike. Auditimi i projektuar i performancës është në sinkron me qëndrimet e shprehura nga Federata Evropiane e Akademive të Shkencave dhe atyre Humane (ALLEA), sipas të cilës: “*Hulumtimi i shkëlqyer varet fuqishëm nga aftësia e studiuesve dhe institucioneve shkencore për të kryer punën e tyre pa ndërhyrje të panevojshme të jashtme dhe për të zgjedhur lirisht agjendat e tyre kërkimore. Liria e kërkimit është jetike jo vetëm për cilësinë e kërkimit, por edhe për besimin e vendeve më të gjera publike në institucionet shkencore. Si të tilla, liria akademike dhe autonomia institucionale janë me rëndësi dhe vlerë themelore për shoqërinë dhe duhet të mbrohen.*”. Në asnjë rast e në asnjë mënyrë KLSH nuk ka synuar të ndërhyjë në agjendat e kërkimit shkencor të këtij institucioni publik përse i takon cilësisë së këtyre punimeve dhe projekteve, dhe garanton autonominë e vendimeve të financimit nga njësitë e kërkimit dhe organet e financimit. Si rrjedhojë, duke u mbështetur në korniza rregullatore të qartë dhe konsistente, KLSH ka kërkuar kryerjen e procedurave të auditimit mbi mënyrë e shpalljes, publikimit, miratimit, zhvillimit dhe monitorimit të këtyre projekteve shkencore në dobi të vendit. Gjithashtu, Ligji për ASH ka përcaktuar se *Akademia është institucion autonom në fushën e kërkimit, që e mbështet veprimtarinë e saj në prova shkencore dhe në dobi të vendit.*

Neglizhencat, vonesat, pengesat dhe refuzimet për t’iu nënshtruar procedurave normale të auditimit, si dhe vënien në dispozicion të audituesve të autorizuar të KLSH-së të dokumentacionit të kërkuar,

¹³ -Shkresa e ASH nr. 433/1 prot, datë 29.03.2024 drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit

¹⁴ - Shkresa e ASH nr. 896/37 prot, datë 21.05.2024 drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit

kanë krijuar pengesa në lidhje me përmbushjen në afat të objektit të auditimit të projekteve kërkimore- shkencore.

Kështu, mund të përmendim komunikimet ku në mënyrë të përsëritur është kërkuar krijimi i kushteve normale për realizimin e auditimeve, ku mund të përmendim p.sh.

- Me datën **3.5.2024** sipas e-mailit që grupi i auditimit i ka përcjellë Sekretarit Shkencor është shprehur:

“Në kuadër të auditimit të performancës mbi projektet kërkimore-shkencore të realizuara nga Akademia e Shkencave dhe në vijim të takimit më të fundit në të cilin kërkuam të na viheshin në dispozicion dosjet fizike të 6 projekteve të realizuara në vitin 2020 (te cilat ende nuk janë vendosur në dispozicion) ju kërkojmë edhe një here në shkresën bashkëngjitur që të na vihen në dispozicion dosjet e plota fizike të projekteve të aplikuara/realizuara nga Akademia e Shkencave përgjatë periudhës 2019-2023.”

- Në kthimin e përgjigjes nga ana e Grupit të Auditimit të Performancës mbi projektet shkencore, ndaj çështjeve të shtruara në shkresën e Kryesisë së ASHSH me nr. 896/37 prot., datë **21.05.2024** është theksuar dhe fakti se ¹⁵

“Nga shqyrtimi paraprak i grupit të auditimit në prezencë të Kancelarit të ASHSH-së dhe koordinatores së projekteve është konstatuar se *vetëm dosjet e dy projekteve (ArkeoBylis dhe Hg Vlora) kanë një listë inventari, ndërsa pjesa tjetër janë të pa inventarizuara sa i përket dokumentacionit që ato përmbajnë.* Në vijimësi, grupi i auditimit do të shqyrtojë dhe konsultojë në mënyrë të detajuar të gjitha dokumentet e vëna në dispozicion në dosjet fizike të 14 projekteve të dorëzuara më datë 21.05.2024. Pas këtij procesi do t’ju informojmë mbi situatën e dokumentacionit të dorëzuar në këto dosje. Gjithashtu, në takimet e zhvilluara, grupi i auditimit është informuar nga Sekretari Shkencor Akademisë së Shkencave mbi një projekt/studim me objekt kurrikulat e matematikës dhe fizikës në arsimin parauniversitar. Ky projekt/studim nuk i është vënë në dispozicion grupit të auditimit dhe nuk gjendet në “data base” e listës së projekteve të dërguara nga ASHSH grupit të auditimit. Sa më sipër, kërkujmë nga ana juaj vënien në dispozicion të 25 dosjeve fizike të projekteve të sipër listuara brenda datës 23.05.2024”.

- Ndërsa në e-mailin e dërguar nga ana e grupit të auditimit me dt. **4.6.2024** për Sekretarin Shkencor të ASHSH: është përcjellë bashkëngjitur Pyetësori nr.2 me disa pyetje informuese si dhe me kërkesën për vendosjen e dokumentacioneve në dispozicion. Audituesit kanë kërkuar të konfirmohet lista e projekteve të realizuara nga ASHSH përgjatë periudhës 2019-2023 etj.

Edhe pas disa takimeve zyrtare të zhvilluara në mjediset e ASHSH dhe KLSH¹⁶, ku u dakordësua vijimi i kryerjes së angazhimit të auditimit nga audituesit e autorizuar të KLSH-së, sërish nga ana e ASHSH është vonuar vënia në dispozicion e të gjithë dokumentacionit administrativ, teknik, financiar etj., të kërkuar, sipas afateve ligjore, që lidhen me fushën e planifikimit, aprovimit, zbatimit, kontrollit e monitorimit të projekteve kërkimore shkencore. Ka parregullsi në inventarizimin e tyre dhe vënien e listës dhe dosjeve të plota në funksion të grupit të auditimit.

- Edhe në qëndrimin më të fundit të shtatorit 2024 nga ana e ASHSH¹⁷, sërish janë ngritur pretendime të ndryshme joligjore, të tilla si:

¹⁵ - Email i grupit të auditimit dt. 23.5.2024 për Sekretarin Shkencor të ASHSH

¹⁶ -Takimi me përfaqësuesit e ASHSH në KLSH me date 19.01.2024

¹⁷ -shkresa e ASHSH me nr. 433/5 datë 25.09.2024 “Mbi kontrollin në Akademinë e Shkencave”,

“Kontrolli i performancës së aktivitetit shkencor lidhej drejtpërdrejt me kontrollin e vetë veprimtarisë e të përgjegjësisë së Asamblesë si organ kolegjal e të njëjësive të kërkim-studimit, të cilat ligji i njej si institucione e struktura autonome, veçanërisht në hartimin e programit shkencor, zgjedhjen e metodikes e vlerësimit të tyre e për pasojë, iu takonte atyre të vlerësojnë nëse një kontroll i tillë, që kryhej për herë të parë prekte autonominë e tyre të garantuar nga Kushtetuta, neni 57/7, 58/1 e Ligji për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë.”

Mosvënia në dispozicion e disa informatave dhe të dhënave me karakter financiar dhe administrativ, me pretendimin e shkeljes së lirisë dhe autonomisë akademike, gjatë fazës studimore, ka krijuar pengesa dhe kufizime në fushëveprimin e auditimit nga zyrtarët përgjegjës të ASHSH, gjë që ka kërkuar më shumë kohë për grupin e auditimit për hartimin e programit të auditimit, kjo edhe për shkak të natyrës dhe kompleksitetit të informacioneve të kërkuara nga grupi i auditimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” është përcaktuar shprehimisht (citur):

Neni 26 “Aksesi në dokumentet zyrtare”:

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë për të pasur akses në të gjitha dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të të dhënave si dhe në çdo informacion apo dokumentacion tjetër të subjekteve të audituara të parashikuar në këtë ligj, që mund të përbëjë sekret shtetëror apo konfidencial, dhe që konsiderohen të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore.

2. Të gjitha subjektet e audituara janë të detyruara t’i sigurojnë Kontrollit të Lartë të Shtetit akses në dokumentet zyrtare sipas paragrafit të mësipërm.

Dhe neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”:

dh) të pyesë dhe të marrë përgjigje, me shkrim ose me gojë, nga subjektet e audituara ose punonjësit e tyre, brenda 1 jave nga data e paraqitjes së një kërkesë paraprake;


e) në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, t’u kërkojë subjekteve të audituara që t’i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej tij.

3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e politikave dhe aktiviteteve të Akademisë së Shkencave, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ky institucion mund të ballafaqojë në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën SWOT duke marrë në konsideratë risqet e katër fushave në të cilat shtrihet kjo analizë e respektivisht termi SWOT është një akronim për (*Strengths, Weakness, Opportunities and Threats*) Fuqi, Dobësi, Mundësi dhe Kërcënime. Analiza SWOT është një mjet i rëndësishëm që ndihmon në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në funksionimin e një institucioni apo procesi të caktuar. Ajo mundëson gjendjen aktuale të subjekteve nën auditim, për të diagnostikuar me saktësi problemet. Gjatë përdorimit të kësaj analize është e rëndësishme që faktorët që ndikojnë në funksionimin e procesit për të cilën kjo analizë kryhet, jo vetëm të identifikohen por edhe të vlerësohen aty ku është e mundur. Kjo analizë rrisht ka karakter paraprak dhe në vazhdimësi të auditimit, nëse do të jetë e nevojshme, do të kryhet një rivlerësim dhe/ose përditësim i risqeve të identifikuar. Duke iu referuar kësaj analize, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimtarisë së Akademisë së Shkencave, për të adresuar dhe ndarë faktorët e riskut sipas përkatësisë së tyre, brenda dhe jashtë kontrollit menaxherial.


Fig.3 Analiza SWOT



3.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “Projektet kërkimore-shkencore të realizuara nga Akademia e Shkencave, në nxitjen e përparimit shkencor, teknologjike dhe inovacionit, për të mirën e vendit” ka pasur objektivi kryesor vlerësimin e procesit administrativ të ASH sa i përket aplikimit, shqyrtimit dhe miratimit të projekteve dhe kërkimeve shkencore të financuara prej saj. Në këtë mënyrë është synuar të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektiv mbi nismat dhe iniciativat e ndërmarra nga ASH me qëllim lehtësimin dhe qartësimin e procedurave administrative në realizimin e projekteve dhe kërkimeve shkencore. Me anë të këtij objektivi kemi konkluduar se deri në çfarë mase ka qenë efektive veprimtaria e Akademisë së Shkencave sa i përket aspektit të veprimtarisë administrative të saj për periudhën 2019-2023.

3.3 Pyetjet e auditimit



3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka pasur si fushëveprimi analizimin dhe dhënien e një opinionimi mbi procedurën administrative të realizimit të projekteve dhe kërkimeve shkencore për periudhën objekt auditimi 2019-2023. Në kuadër të këtij auditimi është diskutuar me përfaqësues të ndryshëm të Akademisë së Shkencave për të mbledhur informacion sa më të saktë mbi mënyrën se si planifikohen projektet dhe punimet shkencore, si vlerësohen dhe shqyrtohen nga ato nga strukturat e ASH-së, si respektohen kriteret e përcaktuara të këtij procesi, dhe sa transparent është i gjithë procesi i realizimit të projekteve e kërkimeve shkencore. Përgjatë fazës studimore por edhe fazës së terrenit janë parë me kujdes dosjet fizike të projekteve e kërkimeve shkencore për të siguruar evidenca të duhura në rast të devijimit të tyre nga kriteret e përcaktuara. Theksojmë se grupi i auditimit nuk ka pasur objekt vlerësimin dhe interpretimin lidhur me cilësinë e kërkimeve shkencore në vetvete, por vetëm procesin administrativ të aplikimit, shqyrtimit, përzgjedhjes dhe miratimit të tyre.

4. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE

Pyetja kryesore: A KA SIGURUAR AKADEMIA E SHKENCAVE MENAXHIM TË PËRSHTATSHËM TË PROJEKTEVE DHE KËRKIMEVE SHKENCORE?

Mesazhi i auditimit

Akademia e Shkencave të Shqipërisë nuk ka siguruar një menaxhim të përshtatshëm të veprimtarisë lidhur me projektet e kërkimit shkencor. Akademia e Shkencave të Shqipërisë nuk ka hartuar një plan strategjik zhvillimor institucional, i cili do të duhej të shpaloste qartë misionin dhe vizionin e tij, të mundësonte përparësitë strategjike, menaxhimin e burimeve, vlerësimin e performancës si dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Akademia e Shkencave të Shqipërisë nuk ka siguruar një menaxhim të duhur të dokumentimit të veprimtarisë lidhur me projektet e kërkimit shkencor duke qenë se mungon një rregullore e qartë për mënyrën e organizimit, orientimit dhe përcaktimit të kriterëve që duhet të përmbushin projektet e propozuara. Gjithashtu rezulton se nuk janë përmirësuar metodikat dhe udhëzuesit mbi programimin, shpalljen e thirrjes për projekte, realizimin, financimin, kontrollin e brendshëm dhe transparencën mbi monitorimin e projekteve kërkimore – shkencore.

4.1 A ka rezultuar i përshtatshëm kuadri rregullator i Akademisë së Shkencave lidhur me projektet dhe kërkimin shkencor?

Akademia e Shkencave të Shqipërisë nuk ka hartuar planin strategjik institucional.

Plani strategjik i zhvillimit të institucionit është dokumenti ku përcaktohen objektivat e institucionit apo të njësive përbërëse të tij, si dhe mjetet e mënyrat e realizimit të tyre.¹⁸ Hartimi, monitorimi, raportimi dhe menaxhimi i dokumenteve strategjike në përgjithësi është një proces kompleks, që përsëritet dhe interaktiv. Plani apo dokumenti strategjik vendos mbi nevojën për ndërhyrje, identifikon problemet, përcakton objektivat e politikave, planifikon aktivitetet për arritjen e këtyre objektivave (përfshirë llogaritjen e kostove të tyre dhe identifikimin e burimeve të financimit) dhe përcakton një kornizë matjeje (me synime) për të vlerësuar progresin. Hartimi i dokumentit strategjik kalon në disa hapa kryesore si më poshtë:

¹⁸ Ligj nr. 80/2015 Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 6

- Analiza e problemeve - Analiza e gjendjes aktuale (arritjet, sfidat dhe mundësitë), mundësisht bazuar edhe në mësimet e nxjerra nga raportet e mëparshme të monitorimit dhe vlerësimit të reformave, nëse ka.
- Përcaktimi i objektivave – Identifikimi dhe përcaktimi i fushave kryesore të politikave që duhet të adresohen përmes dokumentit strategjik, duke u përqendruar në problemet e zgjidhura të identifikuar në hapin e mëparshëm.
- Përcaktimi i treguesve me vlerat bazë, piketat dhe synimet – Zhvillimi i mënyrave për të matur arritjen e objektivave të përcaktuara si dhe përcaktimi i synimeve të matshme që shprehin nivelin e pritur të performancës.
- Planifikimi i veprimeve – Identifikimi i aktiviteteve kyçe (bashkë me afatet kohore të tyre dhe përgjegjësitë e zbatimit) të dizajnuara për të arritur objektivat dhe për të çuar në ndryshimin e dëshiruar.¹⁹

Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione homologe ndërkombëtare të saj. Një ndër këto institucione është edhe Akademia e Shkencave e Turqisë. Akademia e Shkencave e Turqisë ka hartuar një plan strategjik në të cilin shpalos misionin dhe vizionin e saj lidhur me veprimtarinë dhe zhvillimit institucional.²⁰ Në këtë dokument strategjik krahas përshkrimit të përgatitjes së planit strategjik, situatës aktuale dhe vizionit për të ardhmen, përshkruhen indikatorët apo treguesit kyç të performancës. Treguesit e performancës bëjnë të mundur ndjekjen dhe vlerësimin nëse objektiva apo qëllime të caktuara janë arritur nga institucioni apo jo. Në mungesë të këtyre treguesve është e vështirë për këdo që të bëjë një vlerësim objektiv të performancës së një institucioni mbi fusha apo drejtime të caktuara. Vetë ligji i Akademisë së Shkencave e parashikon hartimin e një plani strategjik të tillë.²¹ Grupi i auditimit gjatë intervistave, takimeve dhe pyetësorëve dërguar përfaqësuesve të Akademisë së Shkencave ka adresuar dhe ka pyetur nëse ASH ka hartuar një dokument strategjik të tillë. Mungesën e një plani strategjik Akademia e Shkencave e ka justifikuar me përgatitjen e raporteve vjetore të veprimtarisë së saj, platforma për kandidim për funksionin e Kryetarit të ASHSH si edhe një dokument tjetër shkresor të titulluar “Parashtresë përmbledhëse për raportin e analizës vjetore 2021 dhe prioritetet e reformës në vitin 2022”.²² Pavarësisht nga qëndrimi dhe bindja e Akademisë së Shkencave se këto dokumente shkresorë luajnë rolin e një plani strategjik institucional, nuk mundet kurrsesi që ato të plotësojnë mungesën e një plani të tillë, aq më tepër kur një dokument që të quhet i tillë duhet të plotësojë disa nga kriteret kryesore të përshkruara më sipër si objektiva të qartë, të matshëm, të arritshëm si dhe tregues të qartë për matjen e tyre.

Akademia e Shkencave të Shqipërisë nuk ka hartuar një rregullore të qartë mbi formën dhe përmbajtjen e aplikimit të projekteve shkencore

Grupi i auditimit ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e realizimit të projekteve shkencore lidhur me kriteret e përcaktuara për aplikimin e projekteve si dhe ndjekjen e monitorimin e tyre. Nga diskutimet dhe intervistat me përfaqësuesit e Akademisë së Shkencave është pohuar se deri në vitin 2023 nuk ka pasur një rregullore mbi formën apo formatin që aplikimet për projekte ose punime shkencore duhet të respektonin. Më tej, po sipas përgjigjeve zyrtare të përfaqësuesve të Akademisë së

¹⁹ Manual për planifikimin, hartimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre të veprimit, fq 10. <https://kryeministri.rks.gov.net/wp-content/uploads/2022/05/MANUAL-PER-PLANIFIKIMIN-HARTIMIN-DHE-MONITORIMIN-E-DOKUMENTEVE-STRATEGJIKE-DHE-PLANEVE-TE-TYRE-TE-VEPRIMIT.pdf>

²⁰ <https://www.tuba.gov.tr/files/stratejik/2019-2023-Tuba-Stratejik-Plan.pdf>

²¹ Ligj nr. 53/2019 Për Akademinë e shkencave në republikën e Shqipërisë, neni 7 pika 5, neni 22 pika 4 a.

²² Email nga ASH date 14.06.2024, ora 11.22

Shkencave,²³ është pohuar se Udhëzimi nr. 1 datë 27.02.2023 i miratuar nga Kryesia e Akademisë së Shkencave “Për përcaktimin e modaliteteve dhe miratimin e shpenzimeve të projekteve, sipas Statutit dhe Ligjit për Akademinë e Shkencave” kryen funksionin e Udhëzuesit për mënyrën se si propozohen, vlerësohen dhe miratohen projektet nga njësitë e kërkim-studimit. Për të qenë korrekt më poshtë kemi cituar të plotë të gjithë Udhëzimin nr.1 datë 27.02.2023.

1. Drejtuesit e Njësive të kërkim-studimit, Qendrave kërkimore janë përgjegjës për planifikimin, hartimin, formulimin e kërkesave dhe plotësimin e formularëve për projektet e propozuara prej tyre, për realizimin e programit të tyre konform modelit të dokumentacionit të dërguar nga Qendra e Projekteve dhe e Koordinimit të Kërkimit Shkencor (QPKKSH). Për projekte të veçanta të propozuar nga komisionet, këtë përgjegjësi e ushtron drejtuesi i projektit. Kërkesa e drejtohet Kryesisë së Akademisë së Shkencave në formën e një projekt propozimi.
2. Projekt-propozimi i kalon me shënimet për ndjekje strukturave përkatëse (QPKKSH, Seksionit përkatës, QBAE, Sektorit të Buxhetit dhe financës) për kryerjen e ekspertizës përmbajtësore dhe analitike të tij.
3. Pasi strukturat e mësipërme në bashkëpunim të ngushtë me njëra-tjetrën dhe kërkuesit e projekt-propozimit të kenë bërë plotësimet, korrigjimet dhe vlerësimet e nevojshme, ja dërgojnë projekt-propozimet e rishikuara Kryesisë dhe Kryetarit për miratim.
4. Miratimi i projektit nga Kryetari i ASH-së përmbyll fazën e përgatitjen dhe projekti përfshihet në programin vjetor të vitit pasardhës të ASH-së, në të cilin përcaktohen fondet limit për njësitë, qendrat, Institutet e për çdo projekt.
5. Gjatë zbatimit të projektit, kryerjen e shpenzimeve tashmë të miratuara, drejtuesit e Njësive të kërkim-studimit, drejtuesit e projekteve i drejtohen me shkresë kërkesë Kancelarit dhe për dijeni Kryetarit. Kancelari kryen veprimet konform ligjeve dhe rregullave në fuqi duke ju përmbajtur projektit të miratuar.
6. Shpenzimet që do të kryhen mbi bazën e produktit, listës paraprake të raportuar, shoqëruar me dokumentacionin argumentues.
7. Në rastet kur specifikimet teknike për shërbime dhe mallra të parashikuar në projekt duhet të ndryshohen nga ato të miratuara, drejtuesit e Njësive të kërkim-studimit, Qendrave kërkimore shkencore, drejtuesit e projekteve i drejtohen me shkresë kërkesë Kryesisë dhe Kryetarit të ASH-së.
8. Raportimi për çdo projekt bëhet më vete çdo 3 muaj, ku jepet një informacion i shkurtër sipas formatit të dërguar nga QPKKSH dhe mund të jetë progresiv/vjetor ose përfundimtar 20 ditë nga mbyllja e projektit.
9. QPKKSH është përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e projekteve në tërësi si dhe mbi bazën e raporteve nga drejtuesit e projekteve përgatit në vijimësi raporte për Kryesinë dhe Kryetarin mbi ecurinë e projekteve. Njësitë e kërkim-studimit përgjigjen dhe ndjekin zbatimin e projekteve të tyre.

Për të vlerësuar objektivisht qartësinë dhe cilësinë e Udhëzimit nr. 1 datë 27.02.2023 lidhur me modalitetet dhe kriteret që duhet të respektojnë aplikimet për projekte shkencore kemi përdorur si praktikë të mirë Rregulloren për projektet shkencore të hartuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës.

Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës ka hartuar dhe miratuar një rregullore për projektet shkencore në mbështetje të Ligjit nr. 05/L-038 “Për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Me anë të kësaj rregulloreje përcaktohet mënyra e organizimit dhe e punës në projektet shkencore,

²³ Email nga ASH date 16.04.2024, ora 15.22

të drejtat dhe detyrimet e organeve kompetente të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe të pjesëmarrësve në këto projekte. Rëndësi të veçantë paraqet përcaktimi i kriterëve që duhet të përmbajnë projektet e aplikuar sipas kësaj rregulloreje. Konkretisht, projektet duhet të përmbajnë:

- 1.1 Emërtimin dhe arsyeshmërinë shkencore.
- 1.2 Bartësin e projektit.
- 1.3 Strukturën organizative të projektit.
- 1.4 Numrin e personave të angazhuar në projekt.
- 1.5 Përshkrimin gjithëpërfshirës shkencor të projektit.
- 1.6 Kohëzgjatjen e projektit.
- 1.7 Kompetencën shkencore të hulumtuesve pjesëmarrës dhe institucioneve partnere, nëse ka.
- 1.8 Planin e hulumtimit.
- 1.9 Rezultatet e pritshme të projektit dhe përshtatshmërinë e tyre.
- 1.10 Planin e përgjithshëm buxhetor dhe arsyeshmërinë e fondeve të kërkuara.

2. Dosja e propozimit të projektit duhet të jetë e plotë dhe të përmbajë:

- 2.1 Formularin e plotësuar për aplikim, pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
- 2.2 Të dhënat e institucionit partner vendës dhe ndërkombëtar për aplikim në projekte të përbashkëta.
- 2.3 Deklaratën e personit juridik të institucionit partner, nëse ka.
- 2.4 CV-të e pjesëmarrësve në projekt.

Krahas kriterëve të mësipërme lidhur me përmbajtjen e aplikimit të projekteve në këtë rregullore është parashikuar dhe përcaktuar edhe forma e monitorimit apo raportimit të projekteve. Kështu, konkretisht neni 4 i kësaj rregulloreje ka përcaktuar se:

1. Puna në projekte përmbillet me raportin përfundimtar të cilin e harton bartësi i projektit.
 - 1.1 Pjesë përbërëse e raportit përfundimtar janë deklarata e bartësit të projektit dhe deklaratat e të angazhuarve në projekt.
 - 1.2 Deklarata e bartësit të projektit duhet të përmbajë mënyrën e realizimit dhe shkallën e angazhimit të pjesëmarrësve në projekt.
 - 1.3 Deklarata e të angazhuarve duhet të përmbajë kontributin e tyre në projekt.
2. Raporti përfundimtar përfshin rezultat e arritura të hulumtimeve, prezantimet në konferenca, publikimet në revista ose në botime të veçanta.
3. Për projektet disavjeçare paraqiten raporte vjetore të punës.
4. Në raste të caktuara, për projekte mund të paraqiten edhe raporte gjashtë mujore.
5. Bartësi i projektit e paraqet raportin e punës në seksionin e Akademisë.

Në përfundim të kësaj rregulloreje përcaktohet edhe forma e aplikimit për projektet shkencore.²⁴

Nga krahasimi i këtyre dy dokumenteve (ai i ASHSH dhe ai ASHAK) të përshkuara më sipër vërehet qartë se Udhëzimi nr. 1 datë 27.02.2023 nuk ka përcaktuar kriterë të qarta lidhur me çështjet që mbulon Rregullorja e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës pikat 1.1-1.10. Udhëzimi nr. 1 datë 27.02.2023 i hartuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë fokusohet kryesisht në modalitetet që kanë të bëjnë me miratimin e shpenzimeve të projekteve se sa me kriteret që duhet të përmbajnë dhe respektojnë projektet gjatë aplikimit të tyre. Për këtë mjafton të vërehet me kujdes emërtimi që ka Udhëzimi nr. 1 datë 27.02.2023 i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Nga ana tjetër, Rregullorja për projektet shkencore e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës është

²⁴ Rregullore për projektet shkencore e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, neni 7.

më e qartë në aspekt jo vetëm të kriterëve që projektet e propozuara duhet të respektojnë, por edhe monitorimit dhe raportimit në vazhdimësi të tyre.

Akademia e Shkencave të Shqipërisë nuk ka parashikuar dhe nuk realizon thirrje për aplikime për projekte e kërkime shkencore, për studiues që nuk janë pjesë e strukturave të brendshme të saj.

Grupi i auditimit është fokusuar në një tjetër çështje lidhur me projektet kërkimore shkencore dhe që konkretisht ka të bëjë me thirrje për aplikime për studiues e kërkues edhe nga jashtë strukturave të Akademisë së Shkencave lidhur me evente shkencore, aktivitete, simpoziume apo punime shkencore. Në dokumentet e brendshme rregullatore të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nuk parashikohet thirrja për aplikime për projekte apo punime shkencore për studiues nga jashtë strukturave të Akademisë. Thënë ndryshe, ASH mbështet projekte e punime shkencore vetëm të studiuesve apo kërkuesve shkencorë që janë pjesë e strukturave të brendshme të saj. Kjo evidentohet edhe në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në të cilën nuk ka asnjë rast ku Akademia të ketë bërë thirrje për pjesëmarrje nga studiues e kërkues të jashtëm për aktivitete të ndryshme. Gjithashtu, nga intervistat e zhvilluara me përfaqësues të Akademisë por edhe nga praktikantët e dosjeve fizike të shqyrtuara nga grupi i auditimit nuk është evidentuar thirrje për aplikime për projekte/kërkime shkencore për studiues e kërkues të jashtëm. Ndryshe nga kjo praktikë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë rezultojnë ajo e Akademisë së Shkencave të Turqisë. Në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave të Turqisë evidentohen lehtësisht thirrje për aplikime për konferenca, simpoziume e punime shkencore për studiues të jashtëm.²⁵ Në gjykimin tonë kjo është një praktikë e mirë e një institucioni homolog të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Hapja e një institucioni si Akademia e Shkencave dhe përfshirja e studiuesve, ekspertëve dhe kërkuesve të jashtëm do të nxiste më tej promovimin dhe zhvillimin e debatit shkencor. Kjo nuk duhet kuptuar si ndryshim total i qasjes së Akademisë së shkencave të Shqipërisë lidhur me mënyrën e realizimit të projekteve e kërkimeve shkencore por thjesht si një mundësi shtesë për të promovuar dhe dëgjuar edhe zërin e ekspertëve dhe studiuesve që për arsye të ndryshme nuk janë pjesë e strukturave të brendshme të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

1.Gjetje nga auditimi:

Akademia e Shkencave e Shqipërisë nuk ka hartuar planin strategjik të shoqëruar me plan veprimi dhe tregues të matshëm ku, krahas shpalosjes së vizionit të saj mbi zhvillimin e projekteve dhe kërkimeve shkencore, mungojnë objektivat, qëllimet dhe treguesit e matjes së performancës së tyre. Ligji për Akademinë e Shkencave parashikon hartimin e një dokumenti të tillë si shumë të domosdoshëm për mbështetjen e projekteve shkencore dhe jo vetëm.

Institucione të tjera homologe të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë kanë realizuar ndër vite planet strategjike institucionale. Mungesa e një plani strategjik e të detajuar me objektiva konkrete mbi zhvillimin e institucionit nuk garanton vlerësimin objektiv të performancës nga ana e strukturave drejtuese dhe të Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

2.Gjetje nga auditimi:

Akademia e Shkencave të Shqipërisë nuk ka një rregullore të qartë e të plotë mbi kriteret teknike që duhet të përmbajnë projektet e propozuara për aplikim. Udhëzimi nr. 1, datë 27.02.2023, miratuar nga Kryesia e Akademisë së Shkencave “Për përcaktimin e modaliteteve dhe miratimin e shpenzimeve të projekteve, sipas Statutit dhe Ligjit për Akademinë e Shkencave” nuk përmban

²⁵ <https://www.tuba.gov.tr/en/announces>

kritere teknike që duhet të respektojnë projektet e propozuara. Ky Udhëzim, nga vetë emërtimi dhe nga përmbajtja e tij, përcakton modalitetet lidhur me shpenzimet e projekteve, por jo me formatin e aplikimit të tyre. Një ndër praktikat e mira të referuara lidhur me këtë aspekt është edhe rregullorja për projektet shkencore e hartuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, e cila përveç se identifikon qartësisht se çfarë duhet të përmbajnë projektet e propozuara, përcakton edhe aspekte lidhur me monitorimin e raportimin e projekteve të miratuara.

3.Gjetje nga auditimi:

Akademia e Shkencave të Shqipërisë nuk ka parashikuar në dokumentet e brendshme rregullatore përfshirjen apo pjesëmarrjen e studiuesve të jashtëm në projekte e kërkime shkencore. Të gjitha projektet dhe kërkimet shkencore kryhen nga studiues/kërkues që janë pjesë e strukturave të brendshme të Akademisë së Shkencave. Nga shqyrtimi i dosjeve fizike, faqes zyrtare të Akademisë së Shkencave, por edhe nga intervistat e zhvilluara me stafin e këtij institucioni nuk vërehen thirrje për aplikime për projekte e kërkime shkencore për studiues të jashtëm, referuar praktikave të mira.

Konkluzion 1

Kuadri rregullator i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë vuan mungesën e një plani strategjik zhvillimor institucional i cili do të duhej të shpaloste qartë misionin dhe vizionin e këtij institucioni lider në fushën e shkencave në Shqipëri. Kështu, krahas mungesës së përcaktimit të objektivave të qartë e konkretë lidhur me zhvillimin dhe rritjen e ndikimit të studimeve e punimeve shkencore, mungon gjithashtu një rregullore e qartë për mënyrën e organizimit, orientimit dhe përcaktimit të kritereve që duhet të përmbushin projektet e propozuara. Së fundmi, Akademia e Shkencave të Shqipërisë ndryshe nga institucionet homologe ndërkombëtare të saj është më e mbyllur në drejtim të realizimit të projekteve, punimeve e simpoziumeve shkencore duke qenë se në këto marrin pjesë vetëm studiues e kërkues të strukturave të brendshme të Akademisë.

1.1 Rekomandimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë (ASHSH) të hartojë planin strategjik të zhvillimit institucional në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të miratuar të veprimit për zbatimin e saj, ku, krahas vizionit të ASHSH-së për të ardhmen, të përcaktohen në mënyrë të qartë objektivat e matshme e të arritshme, si dhe treguesit kryesorë kyç për vlerësimin dhe arritjen e tyre.

Brenda datës 30.06.2025

2.1 Rekomandimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë të marrë masa dhe të hartojë një rregullore për projektet e punimet shkencore ku të përcaktojë qartë kriteret që duhet të plotësojnë projektet e propozuara në përputhje me praktika të mira të institucioneve homologe si Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës etj.

Brenda datës 30.06.2025

3.1 Rekomandimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë të konsiderojë hapjen dhe përfshirjen e studiuesve dhe kërkuesve të jashtëm, nëpërmjet thirrjeve apo shpalljeve publike në faqen zyrtare të saj lidhur me realizimin e projekteve, punimeve dhe simpoziumeve shkencore që do të zhvillojë në të ardhmen, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së një niveli sa më të kualifikuar të tyre, rritjen e profesionalizmit dhe ndikimit të tyre në zhvillimin e vendit.

Në vijimësi

4.2 A është siguruar një menaxhim i duhur i dokumentimit të veprimtarisë së projekteve dhe kërkimeve shkencore?

Me miratimin e Ligjit nr. 53/2019 “Për akademinë e shkencave në Republikën e Shqipërisë”, u krijua një hapësirë ligjore për ngritjen e njësive dhe qendrave të përkohshme të kërkimit dhe riorganizimin e buxhetit, në mënyrë të atillë që dy përbërësve kryesorë të mëparshëm të veprimtarisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, botimeve dhe konferencave, t’u shtoheshin dhe projektet, që janë dukuri e re në zhvillimin e progresin e saj. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” dhe të Statutit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, miratuar nga Asambleja e ASH me Vendimin nr. 22, datë 18.10.2019, i ndryshuar, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u ngritën njësitë e kërkim-studimit²⁶, si më poshtë:

I. Njësia e kërkim-studimit në fushën e gjeofizikës dhe sizmologjisë

Kjo njësi ishte e para që u ngrit në bazë të Ligjit nr. 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë dhe të Statutit, me detyrë kryesore përcaktimin e masave parandaluese dhe hartimin e akteve (manualit) për futjen e Eurokodeve-8, për sigurimin e standardeve në projektimin e strukturave ndërtimore të qëndrueshme ndaj tërmeteve. Kjo njësi u ngrit për të realizuar një detyrë konkrete, që lidhej me emergjencën e krijuar nga tërmeti i vitit 2019, menjëherë pas tij, më 12 dhjetor 2019, meqenëse rezultonte se ende në fuqi ishte harta e vjetër e rajonalizimit sizmik të vendit, miratuar me VKM në vitin 1980, dhe kishte lindur nevoja e rinovimit të saj. Njësia u drejtua nga prof. Shyqyri Aliaj, një nga profesorët më të njohur të kësaj fushe, bashkautor i hartës së re sizmike dhe i botimit të vetëm monografik për sizmologjinë në Shqipëri (2008). Njësia hartoi manualin shoqëruar për futjen e kodeve evropiane si detyrim ligjor për ndërtimet e qëndrueshme ndaj tërmeteve dhe, së bashku me hartën e re, iu dërguan për miratim Këshillit të Ministrave. Njësia organizoi disa simpoziume ndërkombëtare për prezantimin dhe diskutimin e punës së saj; si dhe një konferencë ndërkombëtare me pjesëmarrjen e mbi 100 specialistëve të fushës, nga rajoni e Europa. Me kryerjen e studimit, hartimin e manualit dhe përditësimin e Eurokodeve-8 dhe të hartës së re sizmologjike, kjo njësi e mbaroi detyrën e vet. Aktualisht, për vetë rëndësinë që kanë shkencat e gjeofizikës dhe të sizmologjisë, është ngritur një njësi e re, që sapo ka filluar aktivitetin.

II. Njësia e bioteknologjisë dhe gjenetikës

Kjo njësi është ngritur për të koordinuar e organizuar veprimtarinë kërkimore-shkencore në fushat e bioshkencës, bioteknologjisë e gjenetikës. Njësia punon në tre drejtime kryesore: biomjekësi, gjenetikë e bioteknologji. Drejtimi shkencor kryhet nga akademikët G.S, I.M e E.K. Qëllimi kryesor i krijimit të saj ishte evidentimi i gjendjes së kërkimit shkencor në këto fusha pa traditë në Shqipëri e Kosovë; përgatitja e kushteve dhe përcaktimi i masave për të kaluar në ngritjen e një qendre reale të përhershme të kërkimit në nivel instituti në këto disiplina të së ardhmes, për të plotësuar një boshllëk në sistemin e kërkimit shkencor. Asambleja ka miratuar kalimin e kësaj njësie në qendër të përhershme që në vitin 2022. Ky vendim është përsëritur më vonë dhe i është dërguar Këshillit të Ministrave bashkë me projektvendimin për themelimin e saj, që pritet të miratohet. Që me krijimin e saj, me 28.2.2020, kjo njësi ndërmoi studimin për shkallën e imunitetit të fituar ndaj virusit Covid-19 në popullsinë e vendit. Ideja për nisjen e këtij studimi lindi nga grupi Në ndjekje të pandemisë, në përbërje të të cilit u përfshinë anëtarë të komisioneve të mjekësisë, biologjisë dhe matematikë-informatikës. Njësia lindi si nevojë për t’iu përgjigjur një situatë emergjente, në kushtet e luftës me

²⁶ Dokumenti “Përshkrim i shkurtër i njësive/ qendrave që funksionojnë pranë ASHSH dhe funksioneve e detyrave të tyre”, dërguar elektronikisht nga Sekretari Shkencor i ASHSH, z. Sh.S, nëpërmjet e-mail të datës 19.04.2024.

të panjohurën; për të kërkuar e publikuar prirjet e pandemisë përmes statistikimit të rezultateve të testimin në popullatë. Për të realizuar këtë studim u bë pjesë e njësisë dhe u vu në shërbim të saj ish-laboratori i imunologjisë dhe personeli i tij ndihmës-tekniko-shkencor (prej tre vetësh). Që atëherë njësia punon në mjediset e ish- laboratorit pranë QSUT. Njësia ka afruar si bashkëpunëtorë të saj kërkuesit e kësaj fushe kudo që ushtrojnë aktivitetin e tyre pranë institucioneve të arsimit të lartë, në Shqipëri e Kosovë; ajo ka evidentuar kapacitetet logjistike e intelektuale; ka organizuar e organizon veprimtari të ndryshme shkencore, si dhe ideon e nxit aplikimin për projekte shkencore pranë institucioneve brenda e jashtë vendit. Njësia prej dy vjetësh punon për krijimin e bankës së AND-së së popullsisë së vendit, që do të përbëjë mbështetje për studime të thelluara (për njohjen e karakteristikave antropogjenetike të popullsisë, që i shërbejnë albanologjisë); ashtu dhe për zbatimet në mjekësi për transplantet e sëmundjet me bazë gjenetike; si dhe të kriobankës së informacionit gjenetik për bimësinë autoktone (cryobank). Këto projekte të njësisë kanë krijuar kushtet për ngritjen e saj në nivelin e qendrës së përhershme.

III. Qendra e botimeve albanologjike e enciklopedike

Kjo është një njësi e veçantë për nga misioni, e ngritur si strukturë ndihmëse dhe koordinuese për projektet shkencore madhore në albanologji, prej fazës së konceptimit dhe gjatë gjithë procesit të realizimit të tyre. Njësia administron bazën e të dhënave që janë mbledhur e krijuar për tre projektet shkencore në zbatim, veçanërisht për Fjalorin e madh të shqipes dhe Enciklopedinë shqiptare, që hartohen për herë të parë në Shqipëri; ajo ka përgatitur programet digjitale dhe ka krijuar kushtet për zbatimin e projekteve mbështetur në teknologjitë e reja të programimit teknik dhe të qasjes online; si dhe ndjek punët organizative e administrative. Me bashkimin e instituteve të albanologjisë pranë ASHSH, mbështetur në VKM nr. 821 datë 28.12.2023, QBAE u ngrit në nivelin e njësie të përhershme, është pjesë e organikës së Akademisë; dhe nga tre-katër punonjës që kishte deri më tani u rikonfirmua me dy sektorë në përbërje dhe një personel prej 9 vetësh, që drejtohet nga prof. M.K (ndërsa dy sektorët, i leksikografisë dhe i enciklopedisë, drejtohen nga akad. V.M e dr. A.L). Ndryshimi është që ajo tashmë ka edhe rol aktiv shkencor, pasi sektorët do të ndjekin në të ardhmen problematikat që lidhen me botimet leksikografike e ato enciklopedike dhe mbarëvajtjen e punës për Fjalorin e madh të shqipes dhe të Enciklopedisë shqiptare pas botimit të tyre (përditësimi, përgatitja e enciklopedive tematike dhe e fjalorëve terminologjikë).

IV. Njësia e nanoshkencës dhe nanoteknologjisë NanoAlb

Kjo njësi u themelua në kushtet e mungesës së nanoshkencës e nanoteknologjisë si disiplinë kërkimore dhe universitare. Ajo ka për detyrë organizimin e drejtimin e kërkimit shkencor në fushën e nanoshkencës e 4 nanoteknologjisë. Qëllimi e synimi kryesor i saj është përgatitja e kushteve dhe përcaktimi i masave për të kaluar në ngritjen e një qendre kërkimore në nivel rajonal në këtë fushë të rëndësishme të së ardhmes. Njësia drejtohet nga ak. A.M profesor e drejtues në institutin e nanoteknologjisë në Barcelonë. Dy profesorë të UT janë të atashuar pranë njësisë NanoAlb, me rolin e koordinuesit të veprimtarisë. Njësia ka bordin e vet shkencor. Pranë saj aktualisht funksionojnë 26 grupe kërkimore (Shqipëri, Kosovë e Maqedoni e Veriut). Angazhimi i njësisë është drejtimi e koordinimi i veprimtarisë së gjithë këtij rrjeti të krijuar. Për këtë njësia zhvillon takime periodike pune e prej tre vitesh përgatit e zhvillon një prej konferencave ndërkombëtare më të rëndësishme në këtë fushë, në nivel evropian, me pjesëmarrjen e mbi 200 shkencëtarëve të fushës, midis tyre edhe nobelistë. Për të nxitur kërkimin shkencor e veçanërisht për të përgatitur personelin akademik që nevojitet për krijimin e një qendre rajonale, njësia dhe grupet pranë saj ideojnë e përzgjedhin çdo dy vjet 5-6 projekte shkencore, që financohen nga ASHSH, krahas aplikimeve që bëjnë pranë institucioneve të tjera si AKKSHI e institucionet evropiane.

V. Njësia Arkeo-Bylis

Kjo njësi u ngrit për të zbatuar metodat gjeofizike në kërkimet arkeologjike, me qëllim vlerësimin e efektivitetit e stabilizimin e tyre në këto kërkime. Njësia drejtohet nga prof. dr. N.C dhe ka një bord drejtues prej 7 anëtarësh. Kjo njësi, ashtu si ajo e sizmologjisë, u ngrit për të realizuar një detyrë që iu caktua; një projekt shkencor konkret. Pas kryerjes së kësaj detyre, në tri faza kërkimi, rezultati më i rëndësishëm ishte zbulimi i tempullit të Augustit në Bylis, qyteti më i rëndësishëm i Ilirisë në paleokrishterim, që kërkohet prej 20 vjetësh. Njësia ishte e përkohshme dhe është mbyllur.

VI. Njësia e inteligjencës artificiale (IA)

Kjo njësi drejtohet nga dy akademikët N.F. e A.D. Roli i saj është ndjekja e zhvillimeve e sfidave shkencore në këtë fushë; koordinimi i veprimtarisë midis njësive që punojnë në këtë drejtim; vlerësimi i kurrikulave të formimit të specialistëve të lartë aktualisht; ideimi e organizimi i aktiviteteve shkencore e nxitja për aplikime për projekte. Njësia deri më tani nuk ka propozuar a zbatuar ndonjë projekt të financuar nga ASHSH.

VII. Njësia pasuritë ujore

Kjo njësi është ngritur kohët e fundit. Qëllimi kryesor i saj është shqyrtimi i problematikës që lidhet me trajtimin e këtij shqetësimi madhor si nga shkencore, dhe nga aspekte të politikëbërjes dhe ato menaxheriale, me synim koordinimin e punës midis këtyre faktorëve. Njësia ka marrë kontakt me strukturat shkencore e administrative dhe pas kësaj ka hartuar një raport të plotë për adresimin e problemeve e të ideve për ndërmarrjen e projekteve e iniciativave të përbashkëta me rekomandime që do t'u bëhen të njohura institucioneve bashkëpunuese.

VIII. Njësia e energjive të rinovueshme

Kjo njësi e përkohshme u ngrit për të analizuar gjendjen e përgjithshme energjetike dhe raportet mes tyre në vendin tonë; perspektivat e sfidat; veçanërisht ajo u përqendrua në hartimin e një strategjie të përbashkët Shqipëri-Kosovë për sistemin energjetik, bazuar mbi një panoramë të gjendjes aktuale, dokument i cili ka përfunduar.

IX. Njësia e kërkim-studimit për arbëreshë, arvanitë dhe arbneshë

Kjo njësi u krijua me nismë e propozim të kolegëve akademikë arbëreshë F.A. dhe M.M. Qëllimi kryesor i saj është promovimi i trashëgimisë dhe identitetit arbëresh dhe të ngulimeve historike të tjera, të studiuara prej një shekulli nga dijetarë të huaj por të njohur pak në Shqipëri. Kjo nismë u parapri nga zhvillimi bashkërisht i disa veprimtarive shkencore, ndër të tjera i konferencës ndërkombëtare *Një rilindje arbëreshe para Rilindjes Kombëtare*, që konkludoi në nevojën e ripërdizimit të historisë. Njësia është mbështetur për botimin për herë të parë të veprës së plotë të Santorit (në kuadër të planit të botimeve të ASHSH); për përgatitjen dhe dorëzimin e dosjes *Moti i Madh* për regjistrimin e trashëgimisë arbëreshe në programet e UNESCO-s (2001-2024); për organizimin e *Ditës Arbëreshe* në kuadër të *Kuvendit të Diasporës* (2023); për projektin e arbërishtes së shkruar e të folur (*corpus* me 32 milionë njësi - fjalë, forma dhe kuptime); për botimin e dorëshkrimit-zbulim të Marin Barletit për *Rrethimin e Shkodrës (Barlezio ritrovato)*. Njësia nga ana e saj bashkëpunon për tre projektet madhore në albanologji.

X. Njësitë / institutet kombëtare të fizikës e matematikës

Këto dy njësi janë të veçanta: në mungesë të instituteve të vërteta në këto dy shkenca fundamentale janë ngritur dy institute virtuale, në përbërje të të cilëve janë tërë matematikanët e fizicienët në

Shqipëri e jashtë vendit. Qëllimi e roli i tyre është vendosja e një komunikimi midis kolegëve, për të evidentuar e adresuar problematikat në këto dy disiplina, si për kërkimin shkencor ashtu dhe për mësimdhënien. Njësitë kanë organizuar disa konferenca shkencore dhe dy shkolla verore të nivelit të kohës, të organizuara nga anëtarja e jashtme F.C (USA) dhe akad. M.H Institutet kanë ideuar e ndjekur punën për dy studime të rëndësishme mbi problemet që kanë programet para universitare të matematikës e fizikës në shkolla. Studimet kanë përfunduar.

XI. Qendra për komunikim dhe përhapje të informacionit shkencor (QKPISH)

Është njësi shërbimi e themeluar sipas marrëveshjes me Institutin e Informacionit Shkencor të Mariborit (IZUM, Slloveni), që ka në pronësi intelektuale sistemin *Cobis*, njëherësh edhe platformë, program dhe bazë të dhënash. Bibliotekat shkencore dhe universitare në Shqipëri mbështeten në këtë program për katalogimin dhe bibliografitë shkencore që nga viti 2015. *Cobiss.net* është program i informatizimit shkencor në gjithë Ballkanin. Baza e të dhënave është nën mbrojtjen e UNESCO-s. Në Shqipëri 42 biblioteka janë të regjistruara në *Cobiss.net*. Deri më tani programi është ofruar falas, duke përfshirë përditësimin e softuerit, mirëmbajtjen, garantimin e të dhënave, navigimin në bazën e tyre, kualifikimin e personelit në biblioteka, ofrimin e shërbimit me karta digjitale etj. Prej fillimit të këtij viti pajtimi në këtë program, që përfshin *Cobiss.al*, *Cobib.al* dhe *E-cris.al*, të tria gjuhë teknike për informacionin shkencor akademik dhe universitar, është me një kuotë mujore prej 20 euro për bibliotekë. ASHSH deri më 2024 kishte lidhshirin për koordinimin e veprimtarisë së bibliotekave shkencore dhe publike me programin dhe pronarin e tij. Me ngritjen e QKPISH ajo është përfaqësuese zyrtare e akredituar e sistemit dhe programit. Këtë rol ajo e luan nëpërmjet QKPISH, që është qendër shërbimi e koordinimi. Aktualisht po nënshkruhen marrëveshjet me universitetet, që njohin këtë rol të ASHSH dhe pranojnë pagimin e kuotizimit. Hapi i dytë do të jetë nënshkrimi i marrëveshjeve me bashkitë e qyteteve që kanë bibliotekat e tyre të regjistruara në *Cobiss.al*. Kuotizimi nënkupton vazhdimin e anëtarësisë, përditësimin falas të programit, mirëmbajtjen e rrjetit, kualifikimin e personelit, qasjen *on line*, aksesin e hapur, propozimin e lëndës së përzgjedhur për platformat *Scopus* dhe *Web os Science*. Koordinatorin paguhet që prej fillimit nga IZUM. Një nga punonjëset bibliografe të ASHSH bën të njëjtën detyrë pranë QKPISH, por tashmë jo me skeda tradicionale, por me skedim digjital. Sot për sot *Cobiss.net* është platforma më e madhe e informacionit shkencor për Shqipërinë dhe Ballkanin, ura më e rëndësishme e ndërkomunikimit. Disa vite më parë në këtë program u regjistrua edhe ASHAK-u.

XII. Qendra e projekteve dhe koordinimit të kërkimit shkencor

Kjo qendër (QPKKSH) është një strukturë shërbimi në administratën e ASHSH, pjesë e organikës së saj, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 115/2023 datë 2.11.2023. Detyrat e kësaj njësie janë të përshkruara në rregulloren e brendshme të administratës së ASHSH. Përgjegjësia kryesore e saj është të asistojë trupën akademike dhe bashkëpunëtorët e njësisë/qendrave pranë ASHSH për të përshtatur përmbajtjen e projekteve shkencore me gjuhën teknike të aplikimit, të cilën një brez relativisht i avancuar në moshë nuk e zotëron efektivisht. Rezultatet më të vlerësuara të QPKKSH janë shfaqur në procesin e aplikimeve të akademikëve dhe bashkëpunëtorëve në kuadër të projekteve të AKKSHI-t. Prej vitit të kaluar kemi 4-5 projekte të fituara nga buxheti i saj. QPKKSH ka për detyrë të mbajë regjistrin e projekteve, të asistojë aplikuesit për preventivimin e kostove për projektet që marrin buxhet nga ASHSH, të mbajë lidhjet midis Akademisë dhe bashkëpunëtorëve jashtë vendit.

Përgjatë periudhës së auditimit 2019-2023, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion²⁷, aktiviteti i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në raport me projektet²⁸ e kërkimit shkencor konsiston në:

- projekte me financim nga AShSh;
- projekte me financim nga AKKSHI në kuadër të thirrjeve përkatëse;
- projekte me bashkëfinancim nga programi i BE-së Interreg-Adrion;
- projekte të tjera biletarale me institucione të huaja.

Bazuar në sa më sipër, grupi i auditimit ka kërkuar vënien në dispozicion të praktikave të plota të administruara nga Akademia e Shkencave mbi projektet e kërkimit shkencor të realizuara nga Akademia e Shkencave.

Nga korrespondenca me Akademinë e Shkencave²⁹, është saktësuar se projektet e miratuar dhe të financuar nga AShSh gjatë periudhës së auditimit janë gjithsej 14, përkatësisht 3 projekte nga Qendra e botimeve enciklopedike dhe albanologjike, 3 projekte nga Njësia e bioteknologjisë, 6 projekte nga njësia NanoAlb, 1 projekt nga Njësia “ArkeoBylis” dhe 1 projekt nga Njësia “Pasuritë ujore”.

Grupi i auditimit ka kërkuar konfirmim të listës së projekteve të realizuara nga AShSh³⁰, përgjatë periudhës 2019-2023, duke bashkëlidhur listën me 40 projekte me status “miratuar/ përfunduar”, bazuar në 99 projektet e listuar nga Akademia e Shkencave, ku pjesa tjetër ishin ende me status “pa miratuar” ose “në proces”.

Në përgjigje të sa më sipër, Kryesia e AShSh, në vijim të shkresës së datës 11.06.2024³¹, ka vënë në dispozicion vetëm 14 projekte të realizuara dhe financuara nga AShSh, listuar si më poshtë:

Nr.	Titulli i projektit	Drejtuesi i projektit dhe stafi	Njësia/komisioni/seksioni	Periudha	Statusi	Buxheti
1	Vlerësimi i shpërndarjes së Hg në sedimentet e Gjirit të Vlorës dhe përcaktimi i Hg në peshq, midhje HgVlora	B.B. A.Sh. M.V. N.B. P.K.	Komisioni i Fizikës dhe Kimisë	2023-2024	Miratuar Vijon në 2024	1,373,790 591,790 për vitin 2023 782,000 për vitin 2024
2	Projekti për kërkimet arkeologjike përmes metodave fotogrametrike dhe gjeofizike në Bylis / gërmime metoda gjeofizike i agorasë së Bylisit- ArkeoBylis	Prof. N.C.	Njësia kërkimore e përkohshme e arkeologjisë së zbatuar "ArkeoBylis"	2021-2023	Përfunduar 2023-faza 3 2022-faza 2 2021-faza 1	2,821,434 V3 - 957,000 V2 - 912,614 V1 - 951,820
3	Studimi seroepi-demiologjik i gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-COV-2 ne popullatën shqiptare SEROIMUNE SEROPREVALENCA COV-19	Prof. dr. G.S. Prof. asoc. A.Y.	Komisioni i mjekësisë	2020-2022	Miratuar VKA 33 dt. 7.5.2020 Përfunduar 2022-faza 4 2021-faza 3 2020-faza 1+2	24,185,992 16,227,779 6,411,264 1,546,949

²⁷ Dokumenti “Projektet në ASHSH 2020-2024”, dërguar elektronikisht nga Sekretari Shkencor i ASHSH, z. Sh.S. nëpërmjet e-mail të datës 26.04.2024.

²⁸ Pasqyruar në mënyrë të detajuar në Aneksin 1 “Tabela e projekteve të Akademisë së Shkencave”.

²⁹ E-mail i datës 15.05.2024, me subjekt “Vijim komunikimi”, nga Sekretari Shkencor i ASHSH, z.Sh.S.

³⁰ E-mail i datës 04.06.2024, me subjekt “Kërkesë për dok dhe info mbi auditimin e projekteve shkencore nga KLSH”, dërguar drejt Sekretarit Shkencor të ASHSH, z.Sh.S.

³¹ Dokumenti “Reagim për pyetësin e datës 11.06.2024 të grupit të auditit të KLSH”, dërguar elektronikisht nga Sekretari Shkencor i ASHSH, z. Sh.S. nëpërmjet e-mail të datës 14.06.2024.

4	Projektimi dhe validimi i sensorit imunitar për matjet e niveleve të ferritinës në gjak në pacientët COVID-19 duke përdorur elektroda me bazë karboni të modifikuara me nanostruktura IMOFERRICEN	Prof. asoc. V.A. Prof. dr. M.V. Prof. asoc. C.FMsc G.H	Qendra kërkimore Nanoteknologji NanoAlb	2020-2021	Përfunduar	7,000 EUR
5	Nanoveshje me veti antivirale e sipërfaqes me bazë çimento. NANOVIR	Prof. asoc.A.K. Prof. dr. P.M. Prof. dr.S.D. Prof. asoc. I.B. Prof. asoc. A.R.	Qendra kërkimore Nanoteknologji NanoAlb	2020-2021	Përfunduar	15,200 EUR
6	Prodhimi i membranave nanofibroze me zeolite të inkuorporuara për aplikime në filtrimin e ujit ZEiNANOF	Dr. A.H. Prof. asoc. I.K. Prof. E.B. Prof. P.M. Prof. asoc. A.R Prof. B.B.	Qendra kërkimore Nanoteknologjisë NanoAlb	2020-2021	Përfunduar	13,930 EUR
7	Bio-plastikë me bazë niseshteje modifikuar kimikisht me komponime të oksidit të grafenit të dizajnuara si filma paketimi ushqimor me veti antibakteriale Bio-mGO	Prof. asoc. A.B Prof. dr. F.P Prof. asoc. S.A Prof. dr. P.M. Dr. A.Gj. Prof. asoc. A.R Dr. A.N.H. Prof. A.O. Prof. S.U.	Qendra kërkimore Nanoteknologjisë NanoAlb	2020-2021	Përfunduar	1,389 EUR
8	Përdorimi i materialit të karbonit të nanostrukturuar në projektimin e sensorit elektrokimik për zbulimin e mbetjeve të antibiotikëve në mjedis NCMES	Dr. A.V. Dr. F.S. Dr. M.V. Dr. N.B. Dr. E.M.	Qendra kërkimore Nanoteknologjisë NanoAlb	2020-2021	Përfunduar	5,000 EUR
9	Drejt krijimit të Njësisë së Biosensorëve pranë Grupit të Bioteknologjive Molekulare, NanoAlb-Përdorimi i biosensorëve me qelizat të plota dhe elektrokimike për të matur toksicitetin e ujit dhe tokës në bregdetin shqiptar BIOSENSTOXIC	A.B L.B Prof. dr. R.M	Qendra kërkimore Nanoteknologjisë NanoAlb	2022-2024	Në proces Përfundon maj 2024	2,097,908
10	Nanosensor për certifikimin e verërave vendase dhe të importuara bazuar në antioksidantët e tyre totalë CERTËINE	K.XH. A.B. M.C. O.Z.	Qendra kërkimore Nanoteknologjisë NanoAlb	2022-2024	Në proces Përfundon maj 2024	2,086,320
11	Zhvillimi i një sensori të ri elektrokimik për kontrollin e cilësisë së mjaltit Eksperimentim në gjetjen e modifikuesit dhe mënyrës së modifikimit HMF-Sens	L.B M.V R.M.	Qendra kërkimore Nanoteknologjisë NanoAlb	2022-2024	Në proces Përfundon Maj 2024	1,758,611
12	Studimi i bashkëveprimit nanobionanopjesëzave dhe nanomaterialeve të modifikuara me organizmat e gjallë dhe qelizat e tyre duke përdorur eksperimente in-vivo dhe modelet kompjuterike NANOBIOTOX	L.V. K.SH. C.F. M.P. I.L.	Qendra kërkimore Nanoteknologjisë NanoAlb	2022-2024	Në proces Përfundon maj 2024	1,712,310
13	Përgatitja dhe karakterizimi i nanofibrave elektrofibra të pastër PVA dhe matricës PVA/MMT për të kapsuluar një vaj esencial të bimës mjekësore shqiptare për aplikime biomjekësore PvaNANOMat	Prof. dr. P.M. A.H. I.K. A.N.H. A.A.R. B.B.	Qendra kërkimore Nanoteknologjisë NanoAlb	2022-2024	Në proces Përfundon Maj 2024	1,393,090
14	Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset	Akad. E.K. Prof. asoc. dr. V.S	Qendra Bioteknologji & Gjenetikë	2022-2023	Vijon 2023-faza 2 2022-faza 1	2,323,798 f.1 - 867,600

sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësisimit dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës (Projekt Pilot në Rrjet) VITROCERT 1				f.2 - 1,456,198
---	--	--	--	-----------------

Burimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë

Mbi procedurën e miratimit dhe monitorimit të zbatimit të projekteve të kërkimit shkencor në Akademinë e Shkencave

Grupi i auditimit ka kërkuar vënien në dispozicion të aktit rregullator ku specifikohet procedura e aplikimit, miratimit e monitorimit të projekteve në AShSh, dhe nga Akademia e Shkencave është vënë në dispozicion Udhëzimi nr. 1, datë 27.02.2023, i miratuar nga kryesia e Akademisë së Shkencave “Për përcaktimin e modaliteteve dhe miratim të shpenzimeve të projekteve, sipas statutit dhe Ligjit Për Akademinë e Shkencave”, si dhe dokumenti “Tipologjia e projekteve shkencore dhe mënyra e aplikimit”³². Për sa më sipër, për periudhën përpara miratimit të Udhëzimit nga Akademia e Shkencave, nuk ka pasur një procedurë të shkruar për hapat që ndiqet për miratimin dhe monitorimin e projekteve të financuar nga AShSh.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Qendra e Projekteve dhe Koordinimit të Kërkimit Shkencor pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, si njësia përgjegjëse për nxitjen dhe orientimin e koordinimit të veprimtarisë studimore e kërkimore të ASH dhe të projekteve në të cilat AShSh është drejtuese ose pjesëmarrëse, mbi 14 projektet e miratuara dhe të realizuara nga AShSh, ka rezultuar, si më poshtë:

Projekti nr. 1. HG VLORA 2023

Dokumentacioni fizik pjesë e praktikës së këtij projekti konsiston në:

- Skeda “Aplikim Projekti” të datës 26.01.2023, e pa protokolluar, nënshkruar nga aplikanti, bashkëlidhur buxheti i projektit;
- Vendimi nr. 14, datë 11.04.2023 “Për miratimin e projekteve shkencore të Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës, Komisionit të Inxhinierisë dhe Komisionit të Fizikës dhe Kimisë pranë ASH për periudhën 2023-2024”, bashkëlidhur lista me 5 projekte, me fond total 25,120,357 lekë.
- Skeda “Raportim Projekti”, i pa protokolluar dhe pa datë, pa përcaktuar emrat e hartuesve të dokumentit dhe pa nënshkrimet përkatëse.

Projekti nr. 2. ARKEOBYLIS

Dokumentacioni fizik pjesë e praktikës së këtij projekti konsiston në:

Faza 1

- Vendimi nr. 52, datë 05.08.2021 “Për krijimin e njësisë kërkimore të përkohshme të arkeologjisë së zbatuar “Arkeobylis”;
- Projekti i paraqitur nga aplikanti, i pa protokolluar dhe i panënshkruar;
- Relacion i pa protokolluar “Për vendimin e Kryesisë së ASHSh “Për krijimin e Njësisë së Arkeologjisë së Aplikuar (ARAP)”, bashkëlidhur dokumenti “Informacion mbi mbledhjen e Komisionit të Përhershëm të Histori-Arkeologjisë, Grupit të punës për projektin e botimit “Historia e Shqiptarëve” dhe Bordit të Njësisë ArkeoBylis”, i nënshkruar nga Prof. N.C;

³² Dokumenti “Tipologjia e projekteve shkencore dhe mënyra e aplikimit”, dërguar elektronikisht nga Sekretari Shkencor i ASHSH, z.SH.S, nëpërmjet e-mail të datës 19.04.2024.

- Raport “Mbi punimet elektrometrike të kryera në ndihmë të kërkimeve arkeologjike në Bylis, me kërkesë të AShSh, njësia ArkeoBylis”, i pa protokolluar, i përgatitur nga Prof. Dr. P.A, Dr. A. Ki, Dr. J.P, i panëshkruar.

Faza 2

- Skedë “Aplikim projekti”, i pa protokolluar, pa datë dhe i panëshkruar;
- Vendimi nr. 64, datë 31.10.2022 “Për miratimin e projektit për kërkimet gjeofizike në Bylis”.

Faza 3

- Skedë “Aplikim projekti”, i paprotokolluar, datë 06.07.2023, i nënshkruar nga drejtuesi i projektit Prof. N. C(bashkëlidhur buxheti i projektit);
- Vendimi nr. 48, datë 11.09.2023 “Për zgjatjen e afatit të funksionimit të njësisë kërkimore për të zbatuar ArkeoBylis”;
- Vendimi nr. 54, datë 18.09.2023 “Për miratimin e projektit për kërkimet gjeofizike në Bylis”;
- Informacion mbi zhvillimin e ekspeditës arkeologjike Bylis 2023, i pa protokolluar, datë 30.10.2023;
- Raport për realizimin e projektit ArkeoBylis 2023, i nënshkruar nga drejtuesi i ekspeditës Prof. N. Ceka dhe drejtuesi i projektit Dr. O. C.

Dokumentacion tjetër në dosje:

- Informacion për KLSH mbi projektin ArkeoBylis nr. 465, datë 29.03.2024, i përgatitur nga Prof. N. C.
- Projekt “Për zbatimin e metodave gjeofizike në kërkimet arkeologjike”, prill 2022, pa nr. protokolli, pa datë, si dhe i panëshkruar nga personat hartues.
- Shkresë “Për projektin e Njësisë ArkeoBylis 2023”, pa nr. protokolli, datë 18.09.2023, e nënshkruar nga Prof. Dr. I. K.
- Shkresë “Për projektin e Njësisë ArkeoBylis – Kërkesë drejtuar KKTKM”, e pa protokolluar, datë 18.09.2023, e nënshkruar nga Prof. Dr. I.K.
- Shkresa nr. 3872/3 prot., datë 21.09.2023 “Kthim përgjigje” nga Ministria e Kulturës.
- E-mail datë 17.01.2024 i Prof. Dr. N.C.
- Informacion në lidhje me studimin e kryer me objektin Parku Arkeologjik Bylis, pa datë, i paprotokolluar, i përgatitur nga Dr. J. P.
- Dorëzim Raporti mbi kërkimet gjeofizike dhe topografike në Bylis, datë 12.12.2022;
- Ofertë mbi kostot e punimeve elektrometrike, viti 2022, e pa protokolluar, datë 17.10.2022.

Projekti nr. 3. SEROPREVALENCA COV-19

Dokumentacioni fizik pjesë e praktikës së këtij projekti konsiston në:

- Vendimi nr. 20, datë 28.02.2020 “Ngritjen e njësisë së kërkim – Studimit në fushën e bioshkencës, bioteknologjisë dhe gjenetikës”, bashkëlidhur ka një Plan Veprimi për krijimin e Njësisë së Bioteknologjisë dhe Gjenetikës gjatë vitit 2020;
- Protokolli i projektit kërkimor “Studimi i seroprevalencës së virusit SARS – CoV – 2” në popullatën shqiptare, i pa protokolluar, pa datë, i panëshkruar nga Drejtuesi Shkencor Akad. G. S.;
- Raport mbi Studimin Pilot të Seroprevalencës SARS – CoV – 2 në dhuruesit e gjakut dhe vlerësimin e performancës së testit serologjik, i pa protokolluar, datë 25.06.2020, i panëshkruar nga Akad. G. S. dhe A. Y.
- Platforma e veprimtarisë së grupit të punës për përgatitjen e forumit shkencor për “Pandemia e shkaktuar nga Covid – 19” datë 04.08.2020;
- Raport mbi Studimin e Seroprevalencës së antitropave anti SARS – CoV – 2 në popullatën e Qytetit të Tiranës, nr. 483/1, datë 21.09.2020;

- Program Aktiviteti nr. 535, datë 05.10.2020 “Pandemia e shkaktuar nga Covid – 19 dhe përballimi i saj në Shqipërisë dhe në Botë”;
- VKM nr. 838, datë 28.10.2020 “Një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Akademinë e Shkencave”, me 4,600,000 lekë për mbulimin e shpenzimeve për projektet studimore dhe kërkimore lidhur me Covid – 19;
- Projekt – propozim nr. 783/2, datë 04.11.2020 “Për studimin e fazës së tretë të studimit të seroprevalencës së antitropave anti SARS – CoV – 2 si dhe përgjigjes imunitare ndaj këtij virusi në popullatën shqiptare”;
- Mbi zhvillimin e forumit shkencor me temë “Pandemia e shkaktuar nga Covid – 19 dhe përballimi i saj në Shqipëri dhe në botë”;
- Shkresa nr. 602, prot., datë 17.11.2020 “Për kalimin e ish–laboratorit të imunologjisë pranë ASH”, ASH i drejtohet Ministrisë së Shëndetësisë;
- Raport mbi fazën e tretë të studimit nr. 42, datë 18.01.2021 – Faza 3;
- Shkresa nr. ext, prot., datë 30.04.2021 “Mbi projekt – planin e aktivitetit një – vjeçar të qendrës së Imunologjisë dhe Imunogjenetikës pranë QSUT në kuadër të Njesisë Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës të ASHSh dhe propozim për personelin e kualifikuar që nevojitet të punësohet”, bashkëlidhur kërkesa për staf, Projekt – plan, pa nr. protokolli, datë 23.04.2021 “Projekt – plan i aktivitetit një vjeçar të Qendrës së Imunologjisë dhe Imungjenteikës pranë QSUT në kuadër të Njesisë kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës të ASHSH”;
- Projekt – plan i aktivitetit një vjeçar pa datë, i pa protokolluar dhe i panëshkruar;
- Vendimi i Këshillit të Etikës nr. 145, datë 24.02.2021, ka miratuar studimin;
- Shkresa nr. 465/1, datë 08.03.2021 “Kthim përgjigje”, për kalimin në përdorim të laboratorit të QSUNT;
- Paraqitje e të dhënave paraprake mbi: “Studimi seroepidemiologjik i gjendjes imunitare ndaj virusit SARS – CoV – 2 në popullatën shqiptare”;
- Relacion, datë 25.10.2021 mbi ngritjen e qendrës kërkimore shkencore bioteknologji-gjentetikë pranë Akademisë së Shkencave, të Shqipërisë, i paprotokolluar dhe i panëshkruar;
- Shkresa nr. 451 prot., datë 20.06.2022 “Mbi realizimin e Fazës 4 të studimit të seroprevalencës SARS – CoV – 2 në popullatën shqiptare”, ku janë përcjellë specififikimet teknike të kитеve ELISA;
- Relacion lidhur me aktivitetin e grupit kërkimor mbi Covid – 19 i qendrës kërkimore të bioteknologjisë dhe gjenetikës gjatë 2022, pa nr. protokolli, datë 15.12.2022, i panëshkruar.

“SARS COV-2”

- Artikull shkencor në anglisht, “Rapid increase of SARS-CoV-2 seroprevalence during the second half of the COVID-19 pandemic year 2020 in the adult urban Albanian pollution. G.S., A.Y.M.K-P., Z.Y., E.SH, J.D-P. F.C..
- Konkluzione dhe rekomandime të Grupit të Punës të Forumit Shkencor “Pandemia e shkaktuar nga COVID-19 dhe përballimi i saj në Shqipëri dhe në botë” datë 28.10.2020 e përpiluar nga Komiteti Organizator dhe Shkencor i Forumit me përbërje Akad.G.S., Akad. I.M, Prof. Dr. A.Y, Prof. Dr.Dh.B, Prof. Dr.A.A., Prof. Dr.K.Xh, Akad.A.A, Prof. Dr.N.Ç, Akad. Asoc.A.C, Akad. K.B.
- Ky dokument është pa nr. protokolli dhe e pa nënshkruar nga asnjë prej autorëve të Komitetit Organizator dhe Shkencor i Forumit.
- Prezantim (në ppt) “Reaksioni imunitar i organizmit ndaj infeksionit me virusin SARS-CoV-2, karakteristikat e përgjigjes imunitare individuale si dhe të grup popullatave ndaj këtij virusi. Autorë G.S, A.Y.

- “Reaksioni imunitar i organizmit ndaj infeksionit me virusin SARS-CoV-2, karakteristikat e përgjigjes imunitare individuale si dhe të grup popullatave ndaj këtij virusi. G.S, A.Y.

Shkresa pune

- Procesverbal i marrjes në dorëzim të materialeve të konsumit, si dhe i instruktimit të personelit për realizimin e projektit kërkimor “*Studimi i seroprevalencës së virusit SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare*), i pa protokolluar dhe i panënshkruar.
- Procesverbal mbi mbledhjen e Komisionit të Mjekësisë, datë 30.07.2020, ora 13.30, e organizuar online, nënshkruar nga A.B me detyrë Sekretare teknike e Komisionit të Mjekësisë.
- Komisioni i Shëndetësisë, AShSh dërgon shkresën e datës 28.07.2020, të pa protokolluar dhe të panënshkruar, mbi shpërblimin e punonjësve që morën pjesë në studimin pilot të seroprevalencës SARS-CoV-2 në popullatën e Tiranës, drejtuar Degës së Financës në ASHSH.
- Komisioni i Shëndetësisë, AShSh dërgon shkresën e datës 22.07.2020, të paprotokolluar, nënshkruar nga Akad. G.S, mbi shpërblimin e punonjësve që morën pjesë në studimin pilot të seroprevalencës SARS-CoV-2 në popullatën e Tiranës, drejtuar Kryetarit të ASHSh.
- Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike i ASHSH. Kërkesë prokurimi reagente dhe mjete konsumi për Fazën e parë të Projektit të Seroprevalencës COVID-19, 2021. Kjo shkresë është protokolluar në ASHSh me nr. 348 prot., datë 18.05.2021. Shkresa përmban kërkesën e Komisionit të Shëndetësisë drejtuar Seksionit i Shkencave Natyrore dhe Teknike i ASHSh si dhe preventivin e shpenzimeve të financimit të projektit seroepidemiologjik SARS-COV-2, Viti 2021, Faza 1.
- Komisioni i Shëndetësisë, AShSh. Kërkesë për reagente dhe mjete konsumi si dhe specififikimet teknike për fazën 3/1 të studimit të Seroprevalencës COVID-19, 2021. Kjo shkresë është protokolluar në ASHSh me nr. 348/2 prot., datë 21.05.2021. Shkresa përmban kërkesën e Komisionit të Shëndetësisë drejtuar Kryetarit të ASHSH, si dhe tabelën me kërkesat dhe specififikimet teknike të projektit seroepidemiologjik SARS-COV-2, Faza 3/1, Maj 2021.
- Komisioni i Mjekësisë, AShSh. Qendra Kërkimore e Imunologjisë dhe Imunogjenetikës pranë Njësisë së Bioteknologjisë dhe Gjenetikës të ASHSH. Tiranë 23.09.2021. Kërkesë për vazhdimin e studimit “Faza III/2 e studimit të seroprevalencës së antitropave anti SARS-CoV-2 si dhe e përgjigjes imunitare ndaj këtij virusi në popullatën shqiptare”. Kjo shkresë është protokolluar në ASHSh me nr. 603 prot. datë 27.09.2021. Kjo shkresë është plotësuar edhe me Aneksin 1 me reagentet, kitet dhe mjetet e konsumit të nevojshme për vazhdimin e studimit të seroprevalencës së së antitropave anti SARS-CoV-2 si dhe e përgjigjes imunitare ndaj këtij virusi në popullatën shqiptare”.
- Komisioni i Shëndetësisë, AShSh dërgon shkresën nr. 603/3 prot., datë 25.11.2021 mbi vazhdimin e Fazës III/2 të studimit të efektit të vaksinave të ndryshme në seroprevalencën SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare drejtuar Kryetarit të ASHSh.
- Komisioni i Shëndetësisë, AShSh dërgon shkresën nr. 726 prot., datë 18.11.2021 mbi shpërblimin e punonjësve që morën pjesë në studimin e Fazës së tretë (Qershor – Gusht 2021) të seroprevalencës SARS-CoV-2 në popullatën e Tiranës drejtuar Kryetarit të ASHSH.
- Akademia e Shkencave. Procesverbal Akt marrje në dorëzim “reagentë dhe materiale konsumi”, faza 3/1 e studimit të seroprevalencës COVID-19. Ky dokument mban datën 13.01.2022. Nuk është i protokolluar dhe as i nënshkruar nga autorët e tij. Pavarësisht se quhet akt marrje në dorëzim nuk ka 2 palë që duhet të ketë në raste të tilla, një palë që dërgon materialet dhe pala tjetër që i merr në dorëzim.
- Komisioni i Mjekësisë, Seksioni i Shkencave Teknike dhe të Natyrës, AShSh ka dërguar shkresën nr. 451 prot., datë 20.06.2022 mbi realizimin e Fazës IV të studimit të seroprevalencës SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare. Shkresa përmban 2 tabela me specifikime teknike për prokurimin e reagenteve.

- Komisioni i Mjekësisë, Seksioni i Shkencave Teknike dhe të Natyrës, AShSh ka dërguar shkresën nr. 451/1 prot., datë 24.06.2022 për një ndryshim në nevojat tona në kite reagentë të nevojshëm për realizimin e Fazës IV të studimit të seroprevalencës SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare. Shkresa përmban 2 tabela me specifikime teknike për prokurimin e reagenteve.
- Ministria e Arsimit dhe Sportit. Përcillet ftesa për trajnim nga Organizata për Kërkime Hapësinore e Indisë me nr. 4141/1 prot. datë 17.06.2022.
- Shkresa nr. 70 prot., datë 31.01.2023, nëpërmjet së cilës dërgohet Raporti i Punës të Qendrës Kërkimore të Imunologjisë dhe Imunogjenetikës në kuadrin e Njesisë së Bioteknologjisë dhe Gjenetikës për periudhën 01.01.2023-31.01.2023.

Projektet nr. 4-8. 5 projekte (IMOFERRICEN, NANOVIR, ZEiNANOF, Bio-mGO, NCMES)

Krijimi i njësisë NanoAlb

Nëpërmjet Vendimit nr. 43, datë 18.12.2019, Kryesia e Akademisë së Shkencave ka vendosur ngritjen e njësisë së kërkim-studimit në fushën e Nano-shkencës dhe Nano-teknologjisë.

Vlerësimi dhe miratimi i projekteve

Nëpërmjet shkresës protokolluar në Akademinë e Shkencave nr. 388 prot., datë 16.06.2020, Kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike bën me dije Kryesinë e Akademisë së Shkencave mbi vlerësimin e projekt-propozimeve të ardhura në përgjigje të thirrjes së brendshme për projekte të njësisë NanoAlb. Në shkresë citohet se, në kuadër të veprimtarisë së saj, njësia kërkimore NanoAlb bëri një thirrje për projekte të lidhura me aplikimin e nanoteknologjisë me problemin aktual të Covid-19. Kësaj thirrje iu përgjigjën 5 grupe kërkimore. Vlerësimi i këtyre propozimeve u kërkua të bëhet nga kërkues shqiptarë e të huaj, u kërkua nga Komisionet e Inxhinierisë, Fizikë – Kimisë dhe Mjekësisë të propozohen emra për vlerësues. Koordinatorin e njësisë A.M. vlerësoi të pesta projektet, ndërsa vlerësuesit e tjerë vetëm nga një projekt. *Në dosje nuk administrohet (i) thirrja për aplikim dhe (ii) mënyra e përzgjedhjes së vlerësuesve për secilin prej projekteve.*

5 projekte

Referuar Pasqyrës nr. 2 të shkresës, për miratimin e projektit “**IMOFERRICEN**”, vlerësuesit kanë qenë A.M., F.U dhe S.B. *Në dokumentacionin e vënë në dispozicion, nuk bën pjesë formulari i vlerësimit i plotësuar nga vlerësuesja S.B.*

Referuar Pasqyrës nr. 2 të shkresës, për miratimin e projektit “**NANOVIR**”, vlerësuesit kanë qenë A.M, Dh.H, Y.E . *Në dokumentacionin e vënë në dispozicion, nuk bën pjesë formulari i vlerësimit i plotësuar nga vlerësuesi Y.E.*

Referuar Pasqyrës nr. 2 të shkresës, për miratimin e projektit “**ZEiNANOF**”, vlerësuesit kanë qenë A.M, D.R, V.P. *Në dokumentacionin e vënë në dispozicion, nuk bën pjesë formulari i vlerësimit i plotësuar nga vlerësuesi D.R.*

Referuar Pasqyrës nr. 2 të shkresës, për miratimin e projektit “**Bio-mGO**”, vlerësuesit kanë qenë A.M, L.D. *Në dokumentacionin e vënë në dispozicion, nuk bën pjesë formulari i vlerësimit i plotësuar nga vlerësuesja L.D.*

Referuar Pasqyrës nr. 2 të shkresës, për miratimin e projektit “**NCMES**”, vlerësuesit kanë qenë A.M, S.Y.O. *Nga formularët e vlerësimit të vënë në dispozicion, ka rezultuar se S.O vlerësuar negativisht financimin e këtij projekti, që nuk pasqyrohet në Pasqyrën nr. 3 të shkresës.*

Në dosje administrohen formularët e aplikimit për 5 projektet e mësipërme. *Dosjet nuk kanë kartelë hyrëse në protokollin e Akademisë së Shkencave, si dhe janë në gjuhën angleze. Nga këto dokumente nuk mund të identifikohet dërguesi apo data e dërgimit/ mbërritjes në Akademinë e Shkencave.*

Nëpërmjet Vendimit nr. 49, datë 14.07.2020, Kryesia e Akademisë së Shkencave ka miratuar projektet shkencore të njësisë NanoAlb, në kuadër të kërkimeve për përballimin e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, duke bashkëlidhur listën e projekteve, si më poshtë:

Nr.	Emri i projektit	Akronimi	Aplikues	Buxheti (në euro)
1	Projektimi dhe vlerësimi i sensorëve të imunitetit për nivelet e ferritinës në gjak në pacientët e infektuar nga COVID-19 duke përdorur elektroda karboni me mikrostrukturë të ndryshuar	IMOFERRICEN	Prof. Asoc.V.A, UT Prof. Dr. M.V, UT Prof. Asoc. C.F, M, IT MSc. G.H, A. Diagnostic	7,000
2	Mikro-mbështjellja e sipërfaqeve të bazuara në çimento me veti antivirale	NANOVIR	Prof. Asoc A.K Prof. Dr. P.M, UPT Prof. Dr. S.D, UT Prof. Asoc. I.B UT Prof. Asoc. A.R Tetovë, RMV	15,200
3	Prodhimi i membranave mikrofibroze me zeolit të inkuorporuar për zbatime në filtrimin e ujërave	ZEiNANOF	Dr.A.H, Univ. Epoka Prof. Asoc.I.K, UPT Prof. E.B, UPT Prof. P.M, UPT Prof. Asoc. A.R. Tetovë, RMV Prof.B.B.G.D, Stip, RMV	13,930
4	Bioplastikat e bazuara në amidon me përbërës oksidë të modifikuara të grafenit për materiale paketimi me veti antibakteriale	Bio-mGO	Prof. Asoc A.B., Univ. i Prishtinës Prof. Dr. F.P., Univ. i Prishtinës Prof. Dr. P.MUPT Dr. A.GJ, UPT Prof. Asoc. A.R, Tetovë, RMV Dr. A.H Univ. Epoka Prof. A.O, Turqi Prof. S.U, Turqi	1,389
5	Përdorimi i materialeve me mikrostruktura për projektimin e sensorëve elektrokimikë për diktimin e mbetjeve të antibiotikëve në mjedis	NCMES	Dr. A.V, Univ. i Prishtinës Dr. F.S., Univ. i Prishtinës Dr. M.V UT Dr. N.B, UT Dr. E.M, Austri	5,000

Burimi: ASHSH

Buxhetet e projekteve

Nëpërmjet shkresës protokolluar në ASH me nr. 494 prot., datë 28.08.2020, Kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike ka paraqitur draft-buxhetet dhe grafikët e punës të detajuara të projekteve NanoAlb, drejtuar Sektorit të Financës, për dijeni Kryesisë së Akademisë së Shkencave, si më poshtë:

Për projektin “**NANOVIR**”, Drejtuesi i NanoAlb dhe Drejtuesi i projektit kanë përllogaritur buxhetin e nevojshëm, në vlerat 7,000 EUR për vitin 2020 dhe 8,200 EUR për vitin 2021.

Për projektin “**NCMES**”, Drejtuesi i NanoAlb dhe Drejtuesi i projektit kanë përllogaritur buxhetin e nevojshëm, në vlerën 5,000 EUR.

Për projektin “**IMOFERRICEN**”, Drejtuesi i NanoAlb dhe Drejtuesi i projektit kanë përllogaritur buxhetin e nevojshëm, në vlerat 2,800 EUR për vitin 2020 dhe 4,200 EUR për vitin 2021.

Për projektin “**ZEiNANOF**”, Drejtuesi i NanoAlb dhe Drejtuesi i projektit kanë përllogaritur buxhetin e nevojshëm, në vlerat 12,330 EUR për vitin 2020 dhe 1,600 EUR për vitin 2021.

Në këtë shkresë nuk rezulton të ketë një përllogaritje të buxhetit për projektin “**Bio-mGO**”.

Raportimi

Në dosje administrohet dokumenti i emërtuar “Raportimi i (dhjetor 2020)” për projektin “Bio-mGO”. Dokumenti nuk rezulton të ketë praktikë hyrëse në Akademinë e Shkencave, dhe nuk mund të identifikohet dërguesi dhe data e dërgimit.

Në dosje administrohet dokumenti i raportimit të parë për projektin “NCMES”. Dokumenti nuk rezulton të ketë praktikë hyrëse në Akademinë e Shkencave dhe nuk mund të identifikohet dërguesi, por citohet se data e raportimit është data 14.12.2020.

Në dosje administrohet dokumenti i raportimit të parë për projektin “**NANOVIR**”, në gjuhën angleze, të sigluar elektronikisht nga Drejtuesi i projektit Prof. Asoc. A.K. Dokumenti nuk rezulton të ketë praktikë hyrëse në Akademinë e Shkencave.

Në dosje administrohet dokumenti i raportimit të parë për projektin “**ZEiNANOF**”, në gjuhën angleze. Dokumenti nuk rezulton të ketë praktikë hyrëse në Akademinë e Shkencave dhe nuk mund të identifikohet dërguesi dhe data e dërgimit.

Në dosje administrohet dokumenti i raportimit të dytë për projektin “**NCMES**”. Dokumenti nuk rezulton të ketë praktikë hyrëse në Akademinë e Shkencave dhe nuk mund të identifikohet dërguesi, por citohet se data e raportimit është data 07.05.2021.

Në dosje administrohet dokumenti i raportimit të dytë për projektin “**IMOFERRICEN**”, i nënshkruar nga Prof. Dr. V.A. Dokumenti nuk rezulton të ketë praktikë hyrëse në Akademinë e Shkencave dhe nuk mund të identifikohet data e dërgimit.

Në dosje administrohet dokumenti i raportimit të dytë për projektin “**ZEiNANOF**”, në gjuhën angleze. Dokumenti nuk rezulton të ketë praktikë hyrëse në Akademinë e Shkencave, dhe nuk mund të identifikohet dërguesi dhe data e dërgimit.

Në dosje administrohet dokumenti i emërtuar “Raportimi II (maj 2021)” për projektin “**Bio-mGO**”. Dokumenti nuk rezulton të ketë praktikë hyrëse në Akademinë e Shkencave dhe nuk mund të identifikohet dërguesi dhe data e dërgimit.

Në dosje administrohet dokumenti i raportimit të dytë për projektin “**NANOVIR**”. Dokumenti nuk rezulton të ketë praktikë hyrëse në Akademinë e Shkencave dhe nuk mund të identifikohet dërguesi, por citohet se data e dërgimit është 04.05.2021.

Kërkesat për rialokim fondesh për vitin 2021(*)

(*) Projektet kanë qenë në vijimësi dhe është kërkuar rihapje fondi për shkak të kalimit në vitin tjetër buxhetor, pra nuk konsiston në rritje të shpenzimeve.

Nëpërmjet shkresës protokolluar në Akademinë e Shkencave me nr. 604 prot., datë 20.11.2020, Kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike ka kërkuar shtimin e buxhetit për projektin “**Bio-mGO**”, për të kryer blerjen e dy pajisjeve, me kosto totale 12,000 EUR.

Nëpërmjet shkresës protokolluar në Akademinë e Shkencave me nr. 387 prot., datë 02.06.2021, koordinatori i projektit “**NCMES**” bën me dije se deri tani janë shpenzuar 2,900 EUR nga totali prej 5,000 EUR i akorduar, duke kërkuar ndryshimin e destinacionit të pjesës së mbetur prej 2,100 EUR nga mbështetje financiare të mobilitetit të stafit, në blerjen e mjeteve laboratorike, duke bashkëlidhur listën e detajuar.

Nëpërmjet shkresës protokolluar në Akademinë e Shkencave me nr. 388 prot., datë 02.06.2021, Kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike dërgon drejt Kryesisë së Akademisë së Shkencave kërkesën për blerje pajisje analizash për vazhdimësinë e projektit “**NANOVIR**”, duke kërkuar të shikohet mundësia e vazhimit të financimit të projektit për vitin 2021, duke bashkëlidhur dokumentin e emërtuar “Specifikime teknike për rialokimin e buxhetit”, të sigluar elektronikisht nga drejtuesi i projektit A. K. ku bëhet me dije se nga fondi i akorduar prej 15,200 EUR, grupi i punës ka shpenzuar vetëm 2,700 EUR dhe kërkon rialokimin e 12,500 EUR për vitin 2021.

Nëpërmjet shkresës protokolluar në Akademinë e Shkencave me nr. 366 prot., datë 25.05.2021, Kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike dërgon drejt Kryesisë së Akademisë së Shkencave kërkesën për blerje pajisje analizash për vazhdimësinë e projektit “**IMOFERRICEN**”, duke kërkuar të shikohet mundësia e vazhimit të financimit të projektit, duke bashkëlidhur dokumentin e sigluar elektronikisht nga drejtuesi i projektit V.A, me vlerë totale 7,000 EUR.

Nëpërmjet shkresës protokolluar në Akademinë e Shkencave nr. 497 prot., datë 15.07.2021, znj. M.V për Njësinë NanoAlb i drejtohet Kryetarit të Akademisë së Shkencave, duke bërë me dije se njësia NanoAlb do të organizojë prezantim mbi ecurinë e projekteve për periudhën 1-vjeçare.

Raportet përfundimtare

Në dosje administrohet Raporti përfundimtar i projektit “**IMOFERRICEN**”, me fond prej 7,000 EUR. Mbi realizimin e buxhetit për këtë projekt, drejtuesi i projektit shprehet se kanë mbetur për t’u shpenzuar edhe 2,000 EUR, fond i parashikuar për publikimet e rezultateve të projektit (2 artikuj në revista të lidhura me fushën e nanosensorëve, brenda majit 2022). Dokumenti nuk rezulton të ketë praktikë hyrëse në Akademinë e Shkencave, por është nënshkruar nga Drejtuesi i projektit V.A në datën 20.01.2022.

Në dosje administrohet Raporti përfundimtar i projektit “**NCMES**”, me fond prej 5,000 EUR. Mbi realizimin e buxhetit për këtë projekt, drejtuesi i projektit shprehet se të gjitha fondet janë shpenzuar sipas parashikimit. Konkluzionet janë prezantuar në konferencën “*Trends in Nanotechnology International Conference (TNT2021)*”, zhvilluar në datat 4-8 tetor 2021, me titull “*Application of Nano-sized Materials to develop Electrochemical Sensor for Azithromycin detection in the Environmental and Biological Samples*”, si dhe është publikuar një punim shkencor me titull “*Additional Studies on the Electrochemical Behaviour of Three Macrolides on PT and Carbon-based Electrodes*”, në *Electroanalysis*, Korrik 2021 (<https://doi.org/10.1002/elan.202100183>). (ky artikull shkencor ka autorët A.V, L.S, dhe F.S. Dokumenti nuk rezulton të ketë praktikë hyrëse në Akademinë e Shkencave, por rezulton i sigluar elektronikisht nga koordinatori e projektit A.V, në datën 28.01.2022.

Në dosje administrohet Raporti përfundimtar i projektit “**ZEiNANOF**”, me fond prej 13,930 EUR. Mbi realizimin e buxhetit, drejtuesi i projektit shprehet se nuk është shpenzuar fondi prej 240 EUR për pajisje (2 mixer dhe 2 separator), 330 EUR për shpenzime udhëtimi nga dhe prej Munellës, 600 EUR kosto udhëtimi drejt dhe nga Shqipëria, si dhe 1,000 EUR për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe publikim artikujsh (në total 2,170 EUR). Në seksionin “Konkluzione” citohet se projekti mendohet të përfundojë për 4 muaj, së bashku me një ose dy artikuj shkencorë. Dokumenti nuk rezulton të ketë praktikë hyrëse në Akademinë e Shkencave dhe nuk mund të identifikohet dërguesi, por citohet se i përket datës 25.01.2022.

Në dosje administrohet Raporti përfundimtar i projektit “**Bio-mGO**”, me fond prej 1,360 EUR. Mbi realizimin e buxhetit, drejtuesi i projektit shprehet se nuk është shpenzuar fondi i përlllogaritur prej 80 EUR për shërbime postare, 315 EUR për shpenzime të takimit me partnerë, 300 EUR për shpenzime pjesëmarrje në konferencë (në total 695 EUR). Në seksionin “Arritje të tjera” citohet se mbi këtë projekt janë në pjesë përfundimi 2 tema masteri në fushën e kimisë, planifikohen të prezantohen së paku 2 kumtesa në Kongrese Ndërkombëtare (ISCMP), si dhe rezultatet e projektit planifikohen të publikohen në 1 artikull në revistë në fushën e materialeve. Dokumenti nuk rezulton të ketë praktikë hyrëse në Akademinë e Shkencave, rezulton të jetë nënshkruar nga drejtuesi i projektit A.B., në datë 25.01.2022.

Në dosje administrohet Raporti përfundimtar i projektit “**NANOVIR**”, me fond prej 15,200 EUR. Mbi realizimin e buxhetit, drejtuesi i projektit shprehet se buxheti i nevojshëm për punën në vijim, detajohet në zërat, si 1998 EUR për testet e vetive antivirale, 25 EUR për përpunim të dhënash, 1,600 EUR për testet SEM dhe 2,000 EUR për testet BET dhe BJH. Në seksionin “Arritje të tjera”, drejtuesi i projektit liston publikimet, si më poshtë:

KA., TV., Gj S., A. A. “*Parameters affecting synthesis of X and A zeolites from coal fly ash*”. *European Journal of Environment and Earth Sciences* (<https://ej-geo.com>).

G. S., K.A., T. V., S. D., B.C. “*Siliceous Fly Ash Utilization Conditions for Zeolite Synthesis*”, publikuar në 25 shkurt 2021 nga *MDPI Proceedings Environmental Sciences Proceedings* (<https://doi.org/10.3390/iecms2021-09359>).

G.i S., K.A., T. V., S.D., B. C. “*Siliceous Fly Ash Utilization Conditions for Zeolite Synthesis*”, Konferenca II Ndërkombëtare Elektronike mbi Shkencën Minerale, datat 1-15 mars 2021, Bazel, Zvicër.

Publikime

Në dosje administrohen të veçuara publikimet, si më poshtë:

Për projektin “NCMES” – V.A., S. L., S.F. “*Additional studies on the Electrochemical behaviour of three macrolides on PT and Carbon-based Electrodes*”.

(<https://doi.org/10.1002/elan.202100183>).

S.F., L. F., C. A., M.E., V.A. “*Preparation of an efficient and selective voltametric sensor based on screen printed carbon ink electrode modified with TiO₂ nanoparticles for Azithromycin quantification*”, (2023).

(<https://doi.org/10.1016/j.rechem.2023.101123>).

Për projektin “IMOFERRICEN” – V. M., B.N., C. S., A.V., V.L., H.G., F. C. “*Development of Ferritin Electrochemical Immunosensor based on CPE modification*” (2023). Journal of Hygienic Engineering and Design UDC 616.153.96-097.

Për projektin “NANOVIR” – D. S., K. A., G. S. “*Synthesis of various metal-doped Titanium dioxide photocatalysts supported on zeolite and non-graphite sheets*”. Revue Roumaine de Chimie (duke u rishikuar);

Konferenca:

D. S., K. A., G. S., B. R. “*UV-induced photodegradation of Rhodamine B Dye using TiO₂-based Nanocomposites*”, edicioni I i Konferencës Ndërkombëtare të NanoBalkan, në datat 16-20 tetor, Tiranë;

D.S., K. A., G. S. “*Assessment of Synthetic Approaches for Titanium Dioxide based nanoparticles in photocatalysis*”, Konferenca Ndërkombëtare e Kimisë Fizike, në datat 25-27 shtator 2023, Bukuresht, Rumani.

Projektet nr. 9-13. 5 projekte (BIOSENSTOXIC, CERTWINE, HMF-SENS, NANOBITOXS, PVANANOMAT)

Dokumentacioni fizik pjesë e praktikës së këtyre projekteve konsiston në:

- Vendimi nr. 31, datë 27.05.2022 “*Për miratimin e projekteve shkencore të Nanoteknologjisë Nanoalb pranë ASH për periudhën 2022-2023*”, ku miratohen projektet e qendrës Nanoalb sipas shtojcës (bashkëlidhur nuk ka shtojcë);
- Relacioni nr. 358/1, datë 24.05.2022 “*Mbi vlerësimin e projekteve të Nanoalb për vitin 2022*”, bashkëlidhur tabela e projekteve me buxhetin përkatës të kërkuar dhe aplikuesit, vlerësimi, abstrakt për çdo projekt, tabela përmbledhëse e buxhetit total.
- Me shkresën nr. 438, datë 13.06.2022 “*Dërgohen specifikimet e materialeve të projekteve NanoAlb*” Prof. M. V. ka dërguar specifikimet për pajisjet e 5 projekteve.
- Thirrja e dytë për projektet që lidhen me Covid – 19 dhe aplikime të tjera në nanoteknologji, dokument i paprotokolluar, pa datë dhe i pamiruar.
- 5 formularët e aplikimit, të paprotokolluar, bashkëlidhur kanë formatin e vlerësimit.
- Memorandum mirëkuptimi i firmosur.
- Skedë Raportim Projekti, për 5 projektet 2022, i paprotokolluar dhe pa datë;
- Skedë Raportim Projekti, për 5 projekte 2023, i paprotokolluar dhe pa datë;
- Raportim i projekteve 2022, datë 11.01.2023, i paprotokolluar dhe i panëshkruar;
- Artikuj shkencor botimesh.

Projekti nr. 14. Projekti “Vitrocet”

Dokumentacioni fizik pjesë e praktikës së këtij projekti konsiston në:

- VKM nr. 298, date 15.05.2024 “Për ngritjen e Njesisë së Kërkim-Studimit me aktivitet afatgjatë Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe gjenetikës pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë”.
- Vendimi nr. 14 datë 11.04.2023 i Kryesisë së Akademisë së Shkencave me nr. 309 prot. datë 11.04.2023 “Për miratimin e projekteve shkencore të Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës, Komisionit të Inxhinierisë dhe Komisionit të Fizikës dhe Kimisë pranë ASH për periudhën 2023-2024”;
- Skedë Raportim Projekti (datë 30.09.2023), pa praktikë hyrëse në ASHSH, e paprotokolluar, me titull Vitrocet: Përzgjedhja e materialit të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësimit dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës (Projekt Pilot në Rrjet).
- Skedë Aplikim Projekti, pa praktikë hyrëse në ASHSH, e paprotokolluar, me titull Vitrocet: Përzgjedhja e materialit bumore të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësimit dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës (Projekt Pilot në Rrjet). Skeda është nënshkruar vetëm nga aplikuesi dhe drejtuesi i projektit. Projekt-buxheti në fund të skedës së aplikimit të projektit është nënshkruar vetëm nga aplikuesi i projektit, por nuk është nënshkruar nga Koordinatori i projekteve, Përgjegjësi i Financave dhe nga Kryetari i ASH.
- Skedë Raportim Projekti, datë 30.12.2022, pa praktikë hyrëse në ASHSH, e paprotokolluar, e panënshkruar nga drejtuesi i projektit, me titull Vitrocet: Përzgjedhja e materialit bumore të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësimit dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës (Projekt Pilot në Rrjet).
- Raport i datës 12.12.2023 pa praktikë hyrëse në ASHSH, e paprotokolluar, e panënshkruar nga drejtuesi i projektit, për realizimin e projektit me titull Vitrocet: Përzgjedhja e materialit bumore të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësimit dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës (Projekt Pilot në Rrjet).

Akademia e Shkencave të Shqipërisë nuk ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit për procedurën e ndjekur në lidhje me projektet shkencore.

Gjurma e auditimit, sipas përcaktimeve të nenit 16, pika 2, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pikës 3.3 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njesisë apo ndërmjet vetë njesisë dhe institucioneve të jashtme. Informacioni i marrë nga gjurma e auditimit i jep mundësinë audituesit të përcaktojë radhën e ngjarjeve që ndodhin brenda procesit. *Procedurat për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit*, sipas përcaktimit në pikën 3.3 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, duhet të vendosen për të mbështetur kryerjen e operacioneve dhe kontrollimin e proceseve në njësinë publike. Dokumentimi përfshin hartimin e provave të shkruara për vendimet e marra, ngjarjet e ndodhura, veprimet dhe transaksionet e kryera, etj. Dokumentimi duhet të jetë i plotë, i saktë dhe në kohën e duhur. Procedurat e dokumentimit duhet të mundësojnë ndjekjen e çdo dokumenti, veprimi apo procesi në njësi, ku të tregohet saktësisht se kush ka kryer

çfarë, kur dhe ku, qëllimin dhe llojin e aktit/ dokumentit që është lëshuar me këtë rast. Titullari duhet gjithashtu të garantojë se të dhënat nga dokumente apo burime të ndryshme krahasohen për t'u siguruar për përputhshmërinë e tyre.

Gjurma e auditimit informon mbi:

- Përshkrimin e qartë të ecurisë së operacionit;
- Gjurmimin e operacionit prej fillimit në fund;
- Të gjithë dokumentet që janë marrë ose janë gjeneruar gjatë procesit;
- Aktivitetet e rëndësishme të kontrollit, që garantojnë ecurinë e duhur të operacionit;
- Kush e merr një vendim të caktuar gjatë ecurisë së operacionit;
- Sistemet e IT-së që mbështesin operacionin;
- Kush mban përgjegjësinë finale për procesin – veçanërisht në rastet kur në kryerjen e një operacioni marrin pjesë disa njësi organizative.

4.Gjetje nga auditimi:

Akademia e Shkencave të Shqipërisë nuk ka hartuar dhe miratuar gjurmën standarde të auditimit mbi procedurën e ndjekjes së ciklit të plotë për projektet e kërkimit shkencor. Kjo, pasi nga ana e ASHSH-së, për periudhën 3-vjeçare (2020 - 2022) ka munguar disiplinimi sipas një akti nënligjor / rregullator, i mënyrës dhe procedurave të hartimit, miratimit, kontrollit, financimit e monitorimit të këtyre projekteve. Gjithashtu, edhe pas hartimit dhe miratimit të Udhëzimit nr. 1, datë 27.02.2023, mungesa e një gjurme dokumentare standarde e të detyrueshme për t'u plotësuar për çdo fazë të projektit, ka sjellë diferencime në dokumentimin dhe në ndjekjen e projekteve të ndryshme. Nga auditimi i 14 projekteve, grupi i auditimit ka konstatuar mungesën e uniformitetit në dokumentimin e procedurave të ndjekura nga ASHSH, që nga përzgjedhja e deri në ndjekjen e zbatimit të projekteve, si më poshtë:

- **Mbi thirrjet për aplikim:** Vetëm në praktikën e 5 projekteve (*numërtuar nr. 9-13*) (BIOSENSTOXIC, CERTWINE, HMF-SENS, NANOBITOXs, PVANANOMAT), administrohej dokumenti “*Thirrja e dytë për projektet që lidhen me Covid-19 dhe aplikime të tjera në nanoteknologji*”, i pa protokolluar, pa datë dhe pa të dhënat e nevojshme për të siguruar që kjo thirrje është miratuar dhe/ose publikuar. Sa i përket projekteve të tjerë, në asnjë prej praktikave nuk rezulton të jetë dokumentuar thirrja për aplikim, si dhe nuk është dokumentuar *publikimi* i thirrjeve për aplikime, për të synuar shtrirjen e aplikimeve edhe jashtë strukturave/nënstrukturave, pjesë të Akademisë së Shkencave.
- **Mbi procesin e aplikimit:** Në çdo rast, skedat e tyre, të administruara në dosjet respektive nuk kanë praktikë hyrëse në ASHSH dhe nuk rezultojnë të protokolluara, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 19, të Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, pasi dokumentet që vijnë nga subjekte të tjera duhet të evidentohen në regjistrin e korrespondencës. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin një numër rendor të veçantë, ku dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi, apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të, evidentohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.
- **Mbi procesin e miratimit të projekteve:** Në 10 nga 14 projektet e mësipërme (2 praktikat me nga 5 projekte secila, *numërtuar nr. 4-13*) rezulton të jetë dokumentuar vlerësimi nga njësitë brenda ASHSH-së, si pjesë e procesit përpara vendimmarrjes përfundimtare mbi miratimin e projekteve shkencore. Në asnjë nga praktikat nuk është dokumentuar përzgjedhja paraprake

e Kryesisë mbi projektet që duhet të mbështeten me buxhet gjatë vitit, për t'iu paraqitur më tej Asamblesë për miratim.

- ***Mbi raportimet e kryera në fazën e realizimit të projekteve:*** Raportimet nga drejtuesit e projekteve janë forma e vetme e monitorimit të zbatimit të këtyre projekteve nga ana e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, mbi të cilat nuk janë kryer aktivitete kontrolli shtesë. Skedat e raportimit nuk kanë kartelë hyrëse në ASHSH dhe nuk rezultojnë të protokolluara, duke mos garantuar elementet e gjurmës së auditimit të tyre në kuadër të projekteve, si dhe në kundërshtim me nenin 19 të Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

5.Gjetje nga auditimi:

Akademia e Shkencave të Shqipërisë nuk ka siguruar zbatimin e normave të shërbimit arkivor për projektet kërkimore-shkencore të audituara. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion ka rezultuar se, në praktikën e projekteve kërkimore-shkencore, një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit që nga faza e aplikimit e deri në raportimet përfundimtare të ecuresë së projekteve nuk kanë praktikë hyrëse në ASHSH, janë të pa protokolluara dhe në disa raste pa datë, duke pamundësuar përcaktimin e kronologjisë së ngjarjeve, si dhe ecurinë e këtij procesi nga fillimi deri në fund.

Konkluzion 2

Akademia e Shkencave të Shqipërisë nuk ka siguruar një menaxhim të duhur të dokumentimit të veprimtarisë lidhur me projektet e kërkimit shkencor. Fillimisht, mungesa e një akti rregullator ku të përcaktohej procedura, e më tej hartimi e miratimi i Udhëzimit nr. 1, datë 27.02.2023, i cili përcakton në mënyrë tejet të përgjithshme hapat që ndiqen në këtë procedurë, ka krijuar mundësinë e diferencimeve në ndjekjen e ecuresë së projekteve të kërkimit shkencor. Gjithashtu, mosrespektimi i normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, duke mos evidencuar në regjistrin e korrespondencës dhe duke mos numërtuar sipas përcaktimeve ligjore të gjithë dokumentet e krijuara nga vetë institucioni dhe ato të ardhura nga zbatuesit e projekteve, ka pamundësuar ndjekjen dhe gjurmimin e përshtatshëm të kronologjisë së veprimeve dhe proceseve.

4.1 Rekomandimi:

Akademia e Shkencave të Shqipërisë të hartojë dhe miratojë gjurmën standarde të auditimit për projektet e kërkimeve shkencore, duke garantuar standardizimin dhe uniformitetin në kryerjen dhe dokumentimin e secilës prej fazave të praktikave të projekteve të kërkimit shkencor, që nga planifikimi e publikimi i thirrjeve, e deri te raportimet përfundimtare e vlerësimi i rezultateve dhe arritjes së objektivave fillestare, si dhe të evidentojë të gjithë dokumentacionin përbërës të gjeneruar sipas praktikave në regjistrin e korrespondencës me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës, me qëllim dokumentimin dhe inventarizimin e rregullt të praktikave.

Në vijimësi

4.3 A ka mundësuar Akademia e Shkencave zbatim të qartë dhe të duhur të menaxhimit financiar për projektet dhe kërkimet shkencore?

Akademia është institucion publik buxhetor, përfaqësuesi më i lartë i shkencës e i kërkimit shkencor në vend, që vepron përmes një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh. Akademia është institucion autonom në fushën e kërkimit, që e mbështet veprimtarinë e saj në prova shkencore dhe në dobi të vendit. Hartimi i projekt Buxhetit dhe zbatimi i tij nga ASHSH për vitin 2019-2023 është bazuar në

kërkesat e Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimin e Përhershëm të Ministrisë së Financave nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; si dhe ligjet për zbatimin e buxhetit për çdo vit. Buxheti i Akademisë si për çdo vit kalon në procesin e planifikimit dhe miratimit të fondeve si gjithë institucionet buxhetore. Fondet e alokuara dhe shpenzuara për periudhën 2019 – 2023 janë:

në mijë lekë

	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Buxheti total	108.243,00	195.552,00	217.084,00	143.937,00	212.847,00
Realizimi i buxhetit	99.850,00	94.925,00	123.988,00	143.230,00	196.759,00
%	90	49	57	100	92
Fonde për kërkim shkencor (realizimi)	0,00	4.206,00	17.752,08	38.374	67.383,80
%	0	4	14	27	34

Burimi: Të dhëna nga ASHSH

Në këtë tabelë, në krahasim të buxhetit të çdo produkti, paraqitet edhe vlera e realizimit të fondeve të Kërkimit Shkencor për këto vite (shpenzime operative dhe pajisje) dhe përqindja që këto fonde zënë ndaj totalit të produktit ku janë planifikuar dhe buxhetuar. Nga sa shikohet edhe në tabelë për vitin 2019 nuk ka fonde të realizuar për kërkimin shkencor. Për vitet 2020 dhe 2021, fondet e kërkimit shkencor janë planifikuar, buxhetuar dhe realizuar në kodin e produktit 92201AA³³.

Për vitet 2022 dhe 2023 janë planifikuar, buxhetuar dhe realizuar në kodin e produktit 92201AB³⁴. Në buxhetin e ASHSH nuk ka zë specifik buxhetor “Kërkimi shkencor dhe projektet”, por këto fonde janë kërkuar dhe buxhetuar në kodet e produkteve 92201AA dhe 92201AB. Sipas tabelës së mësipërme fondi total për kërkimin shkencor për periudhën 2019-2023 është 127,716 mijë lekë.³⁵ Në këtë vlerë përfshihet edhe financimi i tre projekteve madhore (“Histori e shqiptarëve”, “Fjalor i madh i shqipes”, “Enciklopedia Shqiptare”) të cilat janë financuar nga buxheti i shtetit me fonde të dedikuara. Nga të dhënat e siguruar nga Akademia e Shkencave, grupi i auditimit identifikoi vetëm vlerat e buxhetuara sipas zërave 92201AA dhe 92201AB për periudhën 2019 - 2023:

në mijë lekë

	Produktet	92201AA	92201AB	Shuma
2019	Buxheti sipas produkteve	70,843	5,400	76,243
	Realizimi produktit	63,505	4,577	68,082
	Realizimi i Produktit ne %	90	85	89.2
	Fondi i realizuar (projekte)	0	0	0
	Realizim Projekti kundrejt totalit te produktit ne %	0.0%	0	0
2020	Buxheti sipas produkteve	174,152	2,900	177,052
	Realizimi produktit	73,912	2,670	76,582
	Realizimi i Produktit ne %	42	92	43.2
	Fondi i realizuar (projekte)	4,206	0	4,206
	Realizim Projekti kundrejt totalit te produktit ne %	5.7%	0%	2.3%

³³ Produkte për K-Zh me impakt në zhvillimin KZhT &I, bazë e të aplikuara në Shqipëri e Kosovë, e më gjerë. Përhapje e dijeve nëpërmjet dokumenteve drejtuar palëve të interesuara për probleme të K-Zh Ministrive të linjës, Universiteteve, Qendrave transferimit të teknologjive, etj.

³⁴ Totali i fondeve të kartave të eventeve për politikën shkencore dhe qeverisje (qendrore /vendore) të KSHT&I me impakt në K-Zh dhe prodhim (veprimtari shkencore + projekte).

³⁵ Të dhënat janë përpunuar nga grupi i auditimit, marrë nga Akademia e Shkencave, dërguar me emailin e datës 20.06.2024, dërguar nga Kancelari i ASHSH në dokumentin ‘plan dhe realizim i projekteve sipas buxheturara’.

2021	Buxheti sipas produkteve	94,484	3,100	97,584
	Realizimi produktit	94,225	1,833	96,058
	Realizimi i Produktit ne %	99.7	59	98.43
	Fondi i realizuar (projekte)	7,363	0	7,363
	Realizim Projekti kundrejt totalit te produktit ne %	7.8%	0	7.5%
2022	Buxheti sipas produkteve	70,007	26,430	96,437
	Realizimi produktit	69,900	26,410	96,310
	Realizimi i Produktit ne %	100	100	100
	Fondi i realizuar (projekte)	0	12,458	12,458
	Realizim Projekti kundrejt totalit te ter realizuar te produktit ne %	0%	47%	13%
2023	Buxheti sipas produkteve	101,847	37,000	138,847
	Realizimi produktit	101,478	35,889	137,367
	Realizimi i Produktit ne %	100	97	98.9
	Fondi i realizuar (projekte)	0	15,581	15,581
	Realizim Projekti kundrejt totalit te produktit ne %	0%	43%	11%

Burimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë

Referuar tabelës së mësipërme, shuma e dy zërave buxhetore (92201AA dhe 92201AB) për projektet e realizuara është rreth 39,608,000 lekë³⁶ e cila përkon me periudhën 2019-2023. Ndërkohë, referuar një tjetër dokumenti të siguruar nga ASHSH,³⁷ shuma e kërkuar dhe e realizuar për të njëjtat zëra buxhetore për vitet 2019-2023 është 48,981,989 lekë. Kjo shumë përbën rreth 20 % të buxhetit të totalit të Produkteve të ASHSH e cila është 239,672,000 Lekë. Projektet kryesore që janë realizuar në Akademinë e Shkencave dhe burimi i financimit të tyre gjatë periudhës 2019-2023 janë:

I. Tre projektet madhore në albanologji, në përputhje me nenin 4, pikat 16 e 17 të Ligjit nr. 53/2019 (... të ndërtojë strategji dhe zbatojë politika për zhvillimin e shkencave të albanologjisë dhe për promovimin e arritjeve të tyre brenda dhe jashtë vendit). Tre projektet janë:

1. Histori e shqiptarëve, në tre vëllime, afërsisht 2000 faqe, botim shqip e anglisht.
2. Fjalor i madh i shqipes, parashikuar me 100 mijë fjalë e 10 mijë njësi frazeologjike.
3. Enciklopedia shqiptare, në 10 vëllime, me 10 mijë faqe, në proces pune.

Tre projektet janë pjesë e protokollit dyvjeçar të bashkëpunimit midis ASHSH e ASHAK. Për Enciklopedinë shqiptare bashkëpunimi është proces më i konsoliduar; për dy projektet e tjera bashkëpunimi është në përputhje me mundësitë e ASHAK-ut.

Marrëveshje për tre projektet janë realizuar edhe me institucione të tjera të albanologjisë në Kosovë.

II. Projekte me financim nga buxheti i ASHSH, janë projektet e realizuara nga Njësia e bioteknologjisë dhe gjenetikës dhe Njësia e nanoshkencës dhe nanoteknologjisë “NanoAlb”; Dy njësitë kanë rol paraprakisht për themelimin e zhvillimin e disiplinave të reja, të cilat tashmë janë bërë pjesë e programeve universitare.

1. Njësia NanoAlb ka punuar për 10 projekte
2. Projektet e njësisë së bioteknologjisë dhe gjenetikës:
 - ADN CellStam

³⁶ Email, datë 20.06.2024, dërguar nga Kancelari i ASHSH, dokumenti në excel ‘Plan dhe realizim i projekteve sipas produkteve të buxhetuara’

³⁷ Email, datë 20.06.2024, dërguar nga Kancelari i ASHSH në dokumentin në word “Relacion sqarues...”

- Vlerësimi i seroprevalencës dhe krijimi i bankës së AND-së
- Ngritja e kriobankës (cryobank) për konservimin e informacionit gjenetik të kumbullës vendëse
- Projekti Cryofruit
- Projekti VitroCert

III. Projekte të ndërmarra në përgjigje të situatave emergjente të krijuara:

- Studimi për sizmologjinë (me shkas nga tërmeti i 26 nëntorit 2019), për parandalimin e rreziqeve të tërmeteve duke zbatuar kritere dhe kushte më të rrepta në ndërtime, që u përmbyll me hartimin dhe propozimin e Eurokodeve-8 si detyrim ligjor për zbatim.

IV. Projekte të tjera:

- Njësia ArkeoBylis.
- Njësia e kërkim-studimit për arbëreshët, arvanitët dhe abreshët.
- Projekti “Pasuritë ujore”; me objekt vlerësimin e shkallës së ndotjes së ujërave të bregdetit të Vlorës prej merkurit, për shkak të derdhjes së mbetjeve industriale (Uzina e Sodës).
- Dy studime për gjendjen në programet shkollore të matematikës dhe fizikës.

Gjithashtu ka edhe disa projekte që janë me bashkëfinancim me AKKSHI.

Grupi i auditimit analizoi 14 projekte të vendosura në dispozicion nga ASHSH nga të cilat rezulton se në aplikimet e tyre, për një pjesë të konsiderueshme nuk ka një preventiv paraprak të nevojës për financim, ku të jenë të parashikuara nevojat si në bazë materiale ashtu edhe në burime njerëzore. Gjithashtu nuk janë shoqëruar me një grafik kohor të shtrirjes së veprimtarisë kërkuese, informacion i cili do të jetë bazë për një planifikim të saktë e të qartë të nevojës për fonde buxhetore sipas periudhave.

Sipas përcaktimeve të nenit 16, pika 2, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pikës 3.3 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, gjurma e auditimit për pjesën e administrimit financiar të projekteve është një instrument menaxhimi, që mundëson nga njëra anë ndjekjen e një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Informacioni i marrë nga gjurma e auditimit i jep mundësinë audituesit të përcaktojë radhën e ngjarjeve që ndodhin brenda procesit.

Grupi i auditimit ka kërkuar vënien në dispozicion të aktit rregullator ku specifikohet mekanizmat e kontrollit që të verifikojë financimet e dyfishta të projekteve konkurruese, si dhe nëse ekzistojnë filtra kontrolli në lidhje me temat apo punimet kërkimore të financuara që të mos jenë kryer me parë nga studiues/kërkues në ndonjë nga institucionet kërkimore e shkencore të vendit dhe rajonit. Nga përgjigjet e subjektit të audituar por edhe të dokumentacionit të vendosur në dispozicion nuk ka një dokument të miratuar për hapat që duhet të ndiqen për miratimin dhe monitorimin e projekteve të financuar nga AShSh.

6. Gjetje nga auditimi:

Për vitin 2019 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë nuk ka pasur fonde të realizuara për kërkimin shkencor. Për periudhën objekt auditimi, në buxhetin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nuk ka një zë specifik buxhetor “Kërkimi shkencor dhe projektet”, por, këto fonde për vitet 2020 dhe

2021 janë kërkuar dhe buxhetuar në kodet e produkteve 92201AA “Veprimari shkencore e zhvilluar” në vlerën 11,569,000 lekë dhe për periudhën 2022 dhe 2023 në kodin 92201AB “Produkte të kartave të eventeve për politikat shkencore dhe qeverisje” në vlerën 28,039,000 lekë. Nga analizimi i treguesve buxhetorë rezultojnë një nivel i ulët i realizimit të produkteve të projekteve, ku pesha specifike e fondeve të përdorura për kërkimin shkencor përfaqëson përkatësisht nivelin 4 % për vitin 2020, 14 % për vitin 2021, 27% për vitin 2022 dhe 34% për vitin 2023.

7. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dosjeve të 14 projekteve të vendosura në dispozicion nga ASHSH, rezultojnë se në aplikime, një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk ka një preventiv paraprak të nevojës për financim, ku të jenë të parashikuara nevojat si në bazë materiale dhe burime njerëzore, të mbështetur kjo edhe në një grafik kohor të shtrirjes së veprimtarisë kërkimore, informacion i cili shërben si bazë për një planifikim të saktë e të qartë buxhetor. *Një mangësi e tillë ka sjellë për pasojë edhe fonde buxhetore të pashfrytëzuara në mënyrë të plotë sipas programimit për projektet që janë financuar nga buxheti i shtetit, pra me nivel të ulët realizimi.*

8. Gjetje nga auditimi:

Lidhur me monitorimin e projekteve, Akademia e Shkencave të Shqipërisë ka operuar me Udhëzimin nr. 1, datë 27.02.2023, miratuar nga Kryesia e ASHSH-së “Për përcaktimin e modaliteteve dhe miratim të shpenzimeve të projekteve, sipas statutit dhe Ligjit Për Akademinë e Shkencave”, si dhe dokumentin “Tipologjia e projekteve shkencore dhe mënyra e aplikimit”³⁸. Për sa më sipër, për periudhën përpara miratimit të këtij Udhëzimi nga Akademia e Shkencave, ka munguar gjurma e miratuar e auditimit për hapat e ndjekur për miratimin dhe monitorimin e projekteve të financuar nga ASHSH. Në këtë udhëzim nuk parashikohet asnjë mekanizëm për kontrollin e financimeve të dyfishta të projekteve konkurruese, pra, i njëjti projekt mund të jetë financuar nga dy burime të ndryshme. Gjithashtu, nuk është parashikuar asnjë filtër në lidhje me projektet kërkimore të financuara nëse janë kryer më parë nga studiues/kërkues në ndonjë nga institucionet kërkimore e shkencore të vendit dhe rajonit. Mungesa e një mekanizmi të tillë nuk garanton shmangien e mbivendosjes së projekteve apo kërkimit shkencor duke sjellë kështu pasojë financiare.

Konkluzion 3

Krahas mos përcaktimit të një zëri buxhetor të dedikuar mbi kërkimin shkencor, rezultojnë se nuk janë përmirësuar metodikat dhe udhëzuesit mbi programin, shpalljen e thirrjes për projekte, realizimin, financimin, kontrollin e brendshëm dhe transparencën e monitorimin e projekteve kërkimore - shkencore.

6.1 Rekomandimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë të marrë masa që gjatë hartimit të buxhetit të planifikojë dhe detajojë zërat specifike të buxhetit bazuar në nevojat konkrete dhe afatgjata të projekteve kërkimore shkencore në projektbuxhetin afatmesëm dhe atë vjetor të institucionit.

Në vijimësi

6.2 Rekomandimi: Asambleja e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe strukturat e drejtimit të saj të analizojnë performancën dhe nivelin e realizimit të treguesve buxhetorë për kërkimin shkencor dhe projektet kërkimore, me qëllimin që të rritet pesha specifike e fondeve të përdorura për kërkimin shkencor.

³⁸ -Dokumenti “Tipologjia e projekteve shkencore dhe mënyra e aplikimit”, dërguar elektronikisht nga Sekretari Shkencor i ASHSH , nëpërmjet e-mail të datës 19.04.2024.

Në vijimësi

7.1 Rekomandimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë të marrë masat për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje të qartë e të plotë mbi të gjithë fazat e proceset e hartimit të një projekt-propozimi të ri dhe miratimit të tij, duke parashikuar edhe preventivimin paraprak të nevojave për financim, i cili do të shërbejë si bazë në planifikimin buxhetor afatshkurtër dhe afatmesëm.

Në vijimësi

8.1 Rekomandimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë të aplikojë filtra kontrolli për të gjitha aplikimet e kryera për projekte kërkimore-shkencore, për t'i kryqëzuar ato me institucione të tjera me qëllim shmangien e mundësive për përfitimin nga dy burime të financimit për të njëjtin projekt shkencor nga ana e studiuesve e kërkuesve shkencorë.

Në vijimësi

8.2 Rekomandimi:

Akademia e Shkencave të Shqipërisë të publikojë rezultatet e të gjitha projekteve, me qëllim përdorimin e tyre nga studiues të tjerë për kërkime të mëtejshme. Në këtë kuadër, ASHSH të koordinojë dhe bashkërendojë me Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Universitetet publike e private, si dhe institucionet e tjera në vend, duke përditësuar listat e projekteve kërkimore-shkencore me qëllim shmangien e financimit të projekteve të cilat mund të jenë kryer më parë nga studiues apo kërkues shkencorë.

Në vijimësi

V. TRAJTIMI I OBSERVACIONEVE TË SUBJEKTEVE

Në vijim të Projektraportit të Auditimit të përcjellë në subjektin e auditimit Akademia e Shkencave Tiranë, janë paraqitur observime nga ana e subjektit me shkresën nr. 188 prot, datë 31.01.2025, administruar në KLSH me nr. 416/7 prot., datë 03.02.2025 dhe shkresën nr. 138 prot., datë 31.01.2025, administruar në KLSH me nr. 416/8 prot., datë 05.02.2025, që në fakt kanë të njëjtën përmbajtje me ndryshimin se shkresa e dytë është e shoqëruar me cd. Në thelb, këto shkresa nuk atakojnë gjetjet apo rekomandime të caktuara të trajtuara si pjesë e projekt raportit të auditimit të performancës, por synojnë të atakojnë auditimin, kjo në vijim të një procesi pengues për realizimin e përgjegjësi shtetërore të parashikuara në Planin Vjetor të Auditimeve të KLSH-së si dhe një qëndrimi jo bashkëpunues ndaj audituesve shtetërorë të autorizuar, të ngarkuar për kryerjen e këtij auditimi, në lidhje me vënien në dispozicion sipas afatit ligjor të parashikuar, të dokumentacionit dhe praktikave shkresore të kërkuara. Përmbajtja e shkresave të Kryesisë së ASH është sa vijon:

Pasi jemi njohur me shkresën tuaj me nr. 416/6 prot., të datës 31.12.2024, me anë të së cilës dërgohet materiali me titull "Projekt raport auditimi performance 2024", ku na kërkohet mendimi e reagimet tona në lidhje me të, brenda një muaji pas marrjes në dorëzim (datë 6 janar 2025), mbështetur mbi tërë praktikën e komunikimit me institucionin tuaj e grupet e auditit konstatojmë se:

Nuk është ushtruar asnjë auditim performance me dijen tonë e sipas vlerësimit tonë, në njësitë e kërkim-studimit pranë ASH-së, as formalisht, as sipas ligjit të KLSH për auditimin e performancës, as sipas tematikës së përcaktuar nga ju, me shkresën nr. 416/5, datë 14.10.2024.

1. Nuk është realizuar asnjë auditim performance qoftë dhe formalisht te njësitë pranë Ash-së për vetë faktet se:

- programi i auditit është dërguar me datë 14.10.2024 me anë të shkresës me nr. prot. 416/5, mbërritur pas disa ditësh, pa u prezantuar objektivat e tij në asnjë moment, siç kërkohet nga njoftimi juaj i datës 25.3.2024, e ndërkohë auditit rezultonte i kryer brenda datës 22.10.2024, d.m.th. pa u njohur me programin Asambleja e njësitë e kërkim-studimit, çka e bën atë qartazi një auditim fiktiv.

- nuk është kryer asnjë kontakt, i çdo lloji e forme, me njësitë objekt auditit e drejtuesit e tyre, si ideuese e realizuese të projekteve, si dhe pranë grupit të auditit nuk është atashuar asnjë specialist me njohuritë minimale në kërkimin shkencor, çka e bën të pamundur këtë lloj auditit që kërkon një ekspertizë të nivelit ndërkombëtar në fushat më kryesore të shkencës e dijes.

- grupi i kontrollit është paraqitur e ka punuar pranë ASH-se sipas shkresës suaj të datës 25.03.2024 vetëm gjatë periudhës prill-qershor, gjatë së cilës u mor vetëm me mbledhje të materialeve e të informacionit, me pretendimin se programi i kontrollit do disa muaj të përgatitet e kjo do të na njoftohej.

- pas shqetësimit tonë, shprehur drejtpërdrejtë tek ju, me shkresën nr. prot. 633/1, datë 2.05.2024 e në takim me ju, e me pas me shkresën me nr. prot. 433/5, datë 25.9.2024 "Mbi kontrollin në Akademinë e Shkencave" se pse nuk na bëheshin të njohura si objektivat dhe programi i auditit dhe a do të kryhej ai sipas vendimit të Asamblesë, grupi i auditit shkëputi çdo kontakt me ne dhe nuk u paraqit asnjë ditë në mjediset e ASH-se gjatë gjithë periudhës mes qershori-tetor 2024, duke na pamundësuar respektimin e vendimit të Asamblesë.

- me shkresën tonë me nr. prot. 433/5, datë 25.09.2024 "Mbi kontrollin në Akademinë e Shkencave", drejtuar juve, meqenëse për 6 muaj nuk kish mbyllur auditin e performancës dhe për faktin se auditin e performancës për projektet rezultonte i kryer nga auditët e mëparshme (raporti përfundimtar datë 16.05.2024, fq. 20-23), kërkuam që grupi të tërhiqte dokumentacionin e tij.

2. Auditin e pretenduar është jashtë objektit të një auditin e performancës sipas ligjit të KLSH, çka del qartë nga përmbajtja e projekt raportit dhe përmbledhja ku thuhet qartë se auditin ka pasur për objekt "vlerësimin e procesit administrativ të ASH-së sa i përket aplikimit...", objekt i cili i takon auditit të përputhshmërisë. Për rrjedhojë, në projekt raport nuk ka asnjë fakt, analizë, frazë a pjesë që lidhet me vlerësimin e eficiencës, ekonomikitetit a efektivitetit të projekteve objekt auditimi (neni 3 "përkufizime", pika 4, germa a, b dhe c dhe neni 13 "auditimi i performancës", pika 1, të Ligjit 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së").

3. Auditin e pretenduar nuk është në përputhje me tematikën e auditit (me të vetmen me të cilën janë njohur) urdhëruar nga kryetari i KLSH, sepse sipas tematikës kërkohej të vlerësohej se sa projektet e periudhës 2019-2023 kanë nxitur kërkimin shkencor në Shqipëri. Nga projekt raportin rezulton se nuk është bërë as përpjekja më e vogël për të parë këtë aspekt të performancës së punës së njësive të ASH.

Gjithë sa më sipër ka bërë që:

- projekt raportin jo vetëm mos të bëjë detyrën e vënë prej titullarit, të cilën ritheksojmë se s'mund ta kryente në mungesë të çdo kontakti e konsultimi me njësitë e kërkim-studimit e të asistimit me specialistë të fushës, por edhe të fshehtë qëllimisht një të vërtetë të dukshme: atë që projektet e ASH-së gjatë kësaj periudhe e në vazhdim jo vetëm kanë nxitur, por kanë pararendur e udhëhequr kërkim-studimin në fushat kryesore të shkencave shoqërore albanologjike e ato të shkencave natyrore e teknike, duke arritur rezultate të dukshme madhore të paarritura më parë.

Projektet e kësaj periudhe janë të grupuara në tre drejtime: albanologji, bio-gjenetike e nano-teknologji.

Efektin e të parave ka vlerësimin maksimal të të gjithë komunitetit shkencor e të shoqërisë shqiptare. Tri projektet madhore në albanologji nuk kanë nxitur, por kanë udhëhequr veprimtarinë studimore në albanologji, produktin e tyre janë dhe dy botime unike që bëhen për herë të parë, ndonëse përpjekjet nuk kanë munguar prej 30 vjetësh.

Projektet në bio-gjenetike çuan në ngritjen e njësisë së përhershme të bio-gjenetikës e krijimin pranë saj të bankës së ADN-së së popullatës dhe të krio-bankës. Nëpërmjet tyre mundësohet realizimi i studimeve e analizave që bëhen për herë të parë, veçanërisht në mjekësi për sëmundjet me bazë gjenetike.

Për sa i takon projekteve në nano-teknologji që përbëjnë numrin më të madh, por jo në vlerë financiare, ato kanë çuar në krijimin e njësisë Nano-Alb., e cila nuk është nxitëse por pararendëse e koordinuese e kërkimit shkencor në këtë fushë, në Shqipëri e Kosovë. Kjo njësi është marrë si model në një raport të fundit të Bankës Botërore, hartuar nga dy profesorë të universitetit numër një në botë dhe ky model iu sugjerohet dhe vendeve të tjera (raporti b/ngjitur).

E sigurisht ne në punën tonë të mëtejshme do të marrim për bazë këtë raport te hartuar nga shkencëtarë të paanshëm të nivelit botëror e jo një raport hartuar mbi paragjykime, jashtë fakteve e institucionit, nga punonjës të administratës.

- mos të kuptohet as reforma e kryer nga ASH, as specifikat që ka ajo në misionin e organizimin e saj sipas ligjit të ri.

Në mungesë të kompetencës e dëshirës për të vlerësuar projektet shkencore sipas tematikës së auditit, si nxitëse të veprimtarisë shkencore, projekt raporti merret me çështje organizative, ndonëse ato janë konsumuar në auditet e mëparshme dhe si mangësi a gjetje kryesore quan mungesën e një strategjie e të një udhëzuesi më të plotë për ndjekjen e projekteve nga administrata.

Akademia e Shkencave gjatë periudhës 2019-2023 nuk ka pasur asnjë kërkues shkencor të punësuar e asnjë njësi të përhershme, në këto kushte nuk mund të flitet për strategji të kërkimit. E konceptuar deri atëherë si një Akademi honorifike ajo s'mund të kishte asnjë financim të parashikuar për kërkimin. Reforma e ndërmarrë synonte pikërisht ndryshimin e këtij realiteti, pra kthimin e saj në një qendër kërkimi elitare nëpërmjet ngritjes së njësisive të munguara e atashimit pranë saj të instituteve të albanologjisë, gjë që u realizua me një financim modest.

Tashmë, që prej një viti, janarit të 2024-ës, pranë saj funksionojnë 7 institute e qendra kërkimore, secila prej tyre po përditëson strategjinë e saj e mbi këtë baze po kristalizohe strategjia e ASH-së në tërësi dhe financimi i tyre është zë më vete, siç parashikon ligji i 2019-ës. Pra "mungesa" e strategjisë a financimit nuk është gjetje e një mangësie, por dëshmi e gjendjes para reforme, ato tregojnë ndryshimin e madh që duhet përshëndetur e mbështetur për më tej, sipas vizionit të ASH-së e Asamblesë së saj.

Akademia e Shkencave nuk është financuese projektesh si AKKSHI; ajo ndërmerr, nxit e udhëheq projekte që ideohen nga strukturat e saj, të cilat kanë dy drejtime: ose janë projekte për zgjidhjen e një problemi akut, ose nëpërmjet tyre synohet krijimi i kushteve e përgatitja për ngritjen e njësisive të përhershme, siç ka ndodhur.

ASH, për ideimin, e veçanërisht realizimin e projekteve, ka procedura shumë më të konsoliduara se Akademitë që merren për shembull në projekt raport. Procedurat tek ne rregullohen me ligj, me statut e me rregulloren e përgjithshme, pra ato nuk janë administrative siç është kuptuar nga auditit, por kryhen nga pjesa që përbën drejtimin shkencor të ASH-së që vepron sipas statutit e përbëhet nga: komisionet, njësitë, institutet, qendrat, seksionet, Asambleja. Udhëzuesi i gjetur si i paplotë, është akti më i fundit në këtë zinxhir e ka për qëllim të rregulloje vetëm rrugën që ndjekin propozimet e vendimet e Asamblesë, njësisive a të kryesisë për hartimin, programimin e financimin e projekteve shkencore në strukturat e administratës.

Në tërësi gjetjet e rekomandimet e projekt raportit përfshirë sa më sipër janë përsëritje e atyre të auditeve të mëparshme, të përsëritura në mënyrë më sipërfaqësore e për to janë bërë

tashmë sqarimet, pranimet a vërejtjet nga ana jone, si dhe janë përcaktuar qëndrimet e reflektimet tona.

Siç ju kemi vënë në dijeni me shkresën e datës 2.05.2024, ne si kryesi nuk kemi qenë të autorizuar as nga Asambleja, as nga Bordi i drejtorëve për të qenë pjesëmarrës në një audit performance, pa u njohur qartazi me objektin e tij, për rrjedhojë, ky është një vlerësim yni brenda mandatit të marrë nga Asambleja, e cila do të informohet në mbledhjen më të parë e qëndrimin e vlerësimin përfundimtar do të japë ajo si organi më i lartë.

Pas shqyrtimit të këtyre objeksioneve të Kryesisë së ASHSH, Audituesit e KLSH hedhin poshtë si të bazuara dhe jo ligjore, gjithë cilësimet apo etiketimet e që konsiderojnë projekt raportin apo auditimin e ushtruar, (citur):

- “qartazi fiktiv” , (faqe nr.1 e shkresës së ASH dërguar me nr.138, datë 31.01.2025);
- se “projekt raporti jo vetëm nuk ka kryer detyrën e vënë prej titullarit, “por **edhe të fshehtë qëllimisht një të vërtetë të dukshme**, atë që projektet e ASHK-së gjatë kësaj periudhe e në vazhdim jo vetëm kanë nxitur, por edhe kanë udhëhequr kërkim-studimin në fushat kryesore të shkencave shoqërore albanologjike e ato të shkencave natyrore e teknike, duke arritur rezultate të dukshme madhore të pa arritura më parë”, (faqe nr.2 e shkresës së ASH dërguar me nr.138, datë 31.01.2025);
- “...një raport i hartuar me paragjykime nga punonjës të administratës”, (faqe nr.3 e shkresës së ASH dërguar me nr.138, datë 31.01.2025);
- “...mungesë e kompetencës dhe dëshirës për të vlerësuar projektet shkencore sipas tematikës së auditit...” , (faqe nr.3 e shkresës së ASH dërguar me nr.138, datë 31.01.2025);
- etj.

Grupi i Auditimit ka analizuar objeksionet mbi rekomandimet, të cilat në mënyrë të përciptë e sipërfaqësore janë përmendur në shkresën e Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe i ka vlerësuar ato në përputhje me përcaktimet e Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 07, datë 17.01.2024, dhe paraqet qëndrimet si më poshtë vijon:

➤ *I.Akademia e Shkencave (ASH):*

-Për rekomandimin nr.1.1, **në lidhje me mungesën e planeve strategjike në fushën e kërkimit shkencor** (faqe 22, të Projektraportit të Auditimit), ku është rekomanduar që: “Akademia e Shkencave të Shqipërisë të hartojë një **plan strategjik institucional** ku krahas vizionit të saj për të ardhmen të përcaktojë qartë objektiva të matshëm e të arritshëm si dhe treguesit kryesorë kyç për vlerësimin dhe arritjen e këtyre objektivave”, ASH shprehet se “mungesa e strategjisë a financimit **nuk është gjetje e një mangësie, por dëshmi e gjendjes para reformës**, ata tregojnë ndryshimin e madh që duhet përshëndetur e mbështetur më tej sipas vizionit të ASH-së e Asamblesë së saj.”.

Më tej sipas ASH, “*projekt raportisi mangësi a gjetje kryesore quan mungesën e një strategjie e të një udhëzuesi më të plotë për ndjekjen e projekteve nga administrata.*”

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:

Referuar observacionit të paraqitur sqarojmë se, ASH është kryesuese e listës së institucioneve përgjegjëse për **hartimin dhe zbatimin e politikave në lidhje me kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin**, kjo jo vetëm në zbatim të përcaktimeve të ligjit organik të ASSHS, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 710, datë 1.12.2017 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, 2017-2022”), por edhe në strategjinë kombëtare për zhvillimin

shkencor, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 542, datë 20.9.2023 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”³⁹. (*Fletorja Zyrtare nr. 139/2023, faqe 15829 dhe 15830*):

“Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH) është institucioni publik më i lartë që përfaqëson e mbart vlerat më të mira të shkencës, të kërkimit shkencor, të krijimtarisë dhe të debatit e bashkëveprimit të mendimit shkencor në vend, përmes një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh e krijuesish. ***Në të njëjtën kohë, ASHSH-ja propozon fusha të reja kërkimore e studimore, në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit dhe u ofron institucioneve shtetërore ekspertizën e nevojshme për zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme për vendin.*** Akademia e Shkencave të Shqipërisë është institucion qendror shkencor kombëtar. Akademia duhet të: i. të kryejë kërkime shkencore fundamentale dhe aplikative në fusha të ndryshme të shkencave sociale, humanitare, natyrore e albanologjike; ii. të kujdeset për të hapur fusha të reja të kërkimeve shkencore, në përputhje me nevojat e vendit; iii. t’u parashtrijë organeve shtetërore çështje të rëndësishme për gjendjen e kërkimit shkencor e të zhvillimit teknologjik në fusha të ndryshme, për rrugët e zhvillimit të shkencës e të kulturës; iv. të punojë për përfshirjen sa më të frytshme të shkencës shqiptare në shkencën botërore“.- (*Ligji nr. 7893, datë 22.12.1994, “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, neni 18*).

Gjithashtu, edhe në nenin 8/8 të Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, është përcaktuar ***përgjegjësia dhe kompetenca kryesore e titullarit të njësive publike*** në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm publik, në lidhje me (cituar): “hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, ***të planeve strategjike*** e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan- veprimeve për arritjen e objektivave”.

Mungesa e planit strategjik me objektiva konkrete të miratuar nga Asambleja mbi zhvillimin e institucionit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, nuk garanton një vlerësim objektiv të performancës së këtij institucioni.

Për sa më sipër, observacioni vetëm konfirmon mungesën e një dokumenti fundamental në fushën e kërkimit shkencor siç është ***plani strategjik institucional dhe lidhjen e objektivave të tij specifike me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së***, për pasojë observacioni nuk merret në konsideratë dhe rekomandimi vijon të pasqyrohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit të Performancës.

Mënyra e të shprehurit që “projekt raporti ***mangësi a gjetje kryesore quan mungesën e një strategjie e të një udhëzuesi më të plotë për ndjekjen e projekteve nga administrata***” tregon për një relativizim dhe mungesë koncepti, pasi mungesa e kriterëve dhe normave që orientojnë dhe udhëheqin proceset dhe procedurat e kërkimit shkencor në të gjithë fazat e rrjedhjes së procesit (workflow) ka qenë për periudhën 2019, 2020, 2021 dhe 2022. Edhe një udhëzues /akt nënligjor i hartuar në shkurt të vitit 2023 konsiderohet i pa plotë dhe i mangët. Kjo është një gjetje e rëndësishme, që duhet të verë në lëvizje Asamblenë e ASH dhe nuk mund të konsiderohet me shpërfillje si “një dokument për tu ndjekur nga administrata”, por një si një akt nënligjor që disiplinon dhe mirërregullon në mënyrë të studiuar e përfundimtare veprimtarinë e kërkimit shkencor në ASHSSH, duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e çdo hallke e strukture, me qëllim që ky proces vendimmarrës tu nënshtrohet analizave e miratimeve në kohë nga Asambleja e ASHSH.

³⁹ - <https://upt.edu.al/permbajtja/uploads/2023/11/Vendim-i-Keshillit-te-Ministrave-nr.-542-date-20.9.2023-Per-miratimin-e-Strategjise-Kombetare-per-Kerkimin-Shkencor-Teknologjine-dhe-Inovacionin-2023%E2%80%932030-dhe-te-planit-te-veprimit-per-zbatimin.pdf>

➤ **II. Akademia e Shkencave (ASH):**

Në pikën nr. 2 të shkresës së observacioneve të Kryesisë së ASH, pretendohet se, “*Auditi i pretenduar është jashtë objektit të një auditi performance sipas ligjit të KLSH, çka del qartë nga përmbajtja e projekt raportit dhe përmbledhja ku thuhet qartë se auditi ka pasur për objekt "vlerësimin e procesit administrativ të ASH-së sa i përket aplikimit..."*, objekt i cili i takon auditit të përputhshmërisë. Për rrjedhojë, në projekt raport nuk ka asnjë fakt, analizë, frazë a pjesë që lidhet me vlerësimin e eficiencës, ekonomikitetit a efektivitetit të projekteve objekt auditimi” si dhe më tej

“*Në mungesë të kompetencës e dëshirës për të vlerësuar projektet shkencore sipas tematikës së auditit, si nxitëse të veprimtarisë shkencore, projekt raporti merret me çështje organizative, ndonëse ato janë konsumuar ne auditet e mëparshme dhe si mangësi a gjetje kryesore quan mungesën e një strategjie e të një udhëzuesi me to plote per ndjekjen e projekteve nga administrata.*”

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:

Lidhur me pretendimin e ASHSH, ju bëjmë me dije se, Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kreu II, Neni 13. 1, ka shprehur qartë se “Në auditimet e performancës, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të vlerësojë nëse programet, **organizimi i punës dhe proceseve, veprimtaritë dhe sistemet e menaxhimit të subjekteve të sektorit publik operojnë në përputhje me parimet e ekonomikitetit, eficiencës dhe efektivitetit**”. Në këtë kuadër, organizimi i proceseve sipas normave e rregullave të shpallura, ndikojnë në mënyrë direkte në eficiencën dhe efikasitetin e kërkimit shkencor, të krijimtarisë dhe debatit e bashkëveprimit të mendimit shkencor në një bashkësi të zgjedhur shkencëtarësh e krijuesish, si dhe në përdormimin me dobi, kursim dhe frytshmëri të fondeve publike në administrim të ASHSH.

Sikurse specifikohet edhe në ISSAI 300-399 “Parimet e Auditimit të Performancës”, “Deklaratat Profesionale të Kornizës INTOSAI” (IFPP), Kapitulli 3, pika 9-10 “*Definition of performance auditing*”; ISSAI 3000-3899 “Standardet e Auditimit të Performancës”, Auditimi i performancës, përfshin (ndër të tjera): dhënien e një vlerësimi të pavarur, objektiv dhe të besueshëm, nëse *nismat qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat funksionojnë në përputhje me parimet e ekonomikitetit, eficiencës dhe/ose efektivitetit*;

Kështu që, analizuar sa më sipër, vlerësimi i proceseve të organizimit të brendshëm, administrativ, strukturor, financiar, etj., janë komponentë me rëndësi në auditimin e performancës, që zërthehen përmes kryerjes së testeve thelbësore dhe procedurave analitike për vlerësimin e risqeve të brendshëm etj.

➤ **III. Akademia e Shkencave (ASH):**

Vonesa në hartimin e programit të auditimit dhe nuk janë prezantuar objektivat e auditimit.

-*grupi i kontrollit është paraqitur e ka punuar pranë ASH-se sipas shkresës suaj të datës 25.03.2024 vetëm gjatë periudhës prill-qershor, gjatë së cilës u mor vetëm me mbledhje të materialeve e të informacionit, me pretendimin se programi i kontrollit do disa muaj të përgatitet e kjo do të na njoftohej.*

- *programi i auditit është dërguar me datë 14.10.2024 me anë të shkresës me nr. prot. 416/5, mbërritur pas disa ditësh, pa u prezantuar objektivat e tij në asnjë moment, siç kërkohet nga njoftimi juaj i datës 25.3.2024, e ndërkohë auditi rezultonte i kryer brenda datës 22.10.2024, d.m.th. pa u njohur me programin Asambleja e njësitë e kërkim-studimit*

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:

“Manuali i Auditimit të performancës“, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr .196, datë 26.11.2021, ka përcaktuar në Kreun III, paragrafi 3.1, “Qëllimi i Fazës Studimore “:

Pasi Kryetari ka miratuar Planin Vjetor të Auditimeve, janë krijuar dhe miratuar grupet e auditimit, audituesit fillojnë fazën tjetër të auditimit-Planifikimin Operacional-Fazën Studimore, pra fillon puna për projektimin e auditimit specifik. Qëllimi i fazës studimore është që të fitohen njohuri të mjaftueshme mbi temën e auditimit dhe të konfirmohet që auditimi mund të kryhet në përputhje me parimet e Auditimit të Performancës. Audituesit mbledhin informacion për të përcaktuar fushëveprimin e auditimit, objektivat e auditimit, fushat që do të kërkojnë një studim më të thelluar, kriteret e vlerësimit dhe metodologjinë analizuese. Në fund të kësaj faze, grupi i auditimit planifikon një auditim me qëllim dhënien e rekomandimeve të papërshtatshme.

3.1.2 Përmbajtja e programit auditues

Programi i detajuar i një auditimi, që do të shpjerë natyrshëm dhe cilësisht drejt një Raporti të Auditimit të Performancës, duhet të përmbajë minimalisht seksionet vijuese: • Përshkrimin e fushës që do të auditojmë; • Risqet e aktiviteteve të subjektit etj.

Përgjatë gjenerimit të nen pyetjeve që detajojnë analizën e çështjes madhore, grupi i auditimit duhet të mbajë në konsideratë metodologjinë dhe kriteret audituese që nevojiten për t’iu përgjigjur pyetjeve.

3.14 Rezultati i planifikimit të auditimit të performancës

Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se rezultati i fazës studimore duhet të përfundojë me hartimin e Programit të Auditimit të Performancës që: • Ka kryer një analizë të mirë të risqeve që cenojnë ekonomicitetin, eficiencën dhe efektivitetin; • Ka përcaktuar objektiva të qarta duke hartuar pyetje auditimi që mbulojnë fushat e vlerësuara me risk; • Ka përpunuar kriteret e auditimit dhe ka identifikuar evidencat dhe teknikat analitike të nevojshme për t’iu përgjigjur pyetjeve të auditimit; • Ka vlerësuar riskun e auditimit; • Ka përcaktuar afatet dhe burimet e auditimit. • Jep informacion komunikimin dhe mënyrën e publikimit të raportit.

Në takimin prezantues të zhvilluar në mjediset e ASH midis grupit të auditimit dhe drejtuesve të ASH si dhe në disa takime të mëvonshme janë prezantuar objektivat e auditimit të performancës. Nuk është në detyrat e grupit të auditimit njohja e Asamblesë me programin e auditimit, por e drejtuesit të ASH, referuar përcaktimeve të nenit të statutit dhe të ligjit organik. Neni 13, i Ligjit nr. 53/2019 datë 18.07.2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 69/2023, datë 21.7.2023, ka përcaktuar se Kryetari i ASH “drejton dhe organizon punën e veprimtarinë e Akademisë e të Kryesisë; përfaqëson Akademinë në marrëdhënie me të tretët dhe nënshkruan në emër të saj; raporton në Asamble për aktivitetin e përgjithshëm; ç) raporton në Kryesi për aktivitetin semestral; drejton mbledhjet e Asamblesë; dh) nënshkruan vendimet e Kryesisë dhe të Asamblesë; e) zbaton detyrat e përcaktuara në statut.”

➤ IV. Akademia e Shkencave (ASH):

ASH pretendon për mungesë të çdo kontakti e konsultimi me specialistë të fushës apo njësitë e kërkim-studimit, duke u shprehur se:

- projekt raporti jo vetëm mos të bëjë detyrën e vënë prej titullarit, të cilën ritheksojmë se s'mund ta kryente në mungesë të çdo kontakti e konsultimi me njësitë e kërkim-studimit e të asistimit me specialistë të fushës,

- nuk është kryer asnjë kontakt, i çdo lloji e forme, me njësitë objekt auditit e drejtuesit e tyre, si ideuese e realizuese të projekteve, si dhe pranë grupit të auditit nuk është atashuar asnjë specialist

me njohuritë minimale në kërkimin shkencor, çka e bën të pamundur këtë lloj auditi që kërkon një ekspertizë të nivelit ndërkombëtar në fushat më kryesore të shkencës e dijes.

- grupi i kontrollit është paraqitur e ka punuar pranë ASH-se sipas shkresës suaj të datës 25.03.2024 vetëm gjatë periudhës prill-qershor, gjatë së cilës u mor vetëm me mbledhje të materialeve e të informacionit, etj.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:

Observacioni i Kryesisë së Akademisë së Shkencave ka njaft të pavërteta në lidhje me sa pretendohet që grupi i auditimit të KLSH nuk ka kryer asnjë kontakt me njësitë apo strukturat e ASH, por sjellim në vëmendje të gjitha takimet, kërkesat zyrtare dhe ato të paraqitura në takimet e disaherëshme të zhvilluara me Kryetarin e ASH z.S.GJ dhe Nënkyetarin z.V.T; me personin e caktuar nga ASH si pikë kontakti në komunikimin me grupin e auditimit të KLSH , z.SH.S , me kancelarin z. R.K. si dhe përfaqësues të tjerë të ASH, ku kemi theksuar në mënyrë të vazhdueshme kërkesën për vënien në dispozicion të mos kthimin e përgjigjeve, mos ballafaqimin ne takime etj., sipas dokumenteve/e-maileve të mbajtura nga grupi i auditimit.

Lidhur me sa pretendohet nga Kryesia e ASHSH se, “*Grupi i auditimit të KLSH është marrë vetëm me mbledhje të materialeve e të informacionit,*” sqarojmë se ky është një pretendim jashtë kompetencës së tyre dhe i pa vërtetë, pasi procedurat e auditimit kanë kaluar përmes identifikimit, analizës, debatit e diskutimit të draft-konkluzioneve dhe gjetjeve respektive.

Gjithashtu, Audituesit e autorizuar të KLSH hedhin poshtë si të pavërtetë pretendimin që grupi i auditimit të KLSH nuk ka kryer asnjë kontakt me njësitë apo strukturat e ASH, dhe në vijim janë referuar takimet e zhvilluara pas periudhës Korrik 2024 dhe korrespondenca zyrtare të mbajtura me zyrtarë të ASHSH në funksion të përmbushjes së programit të miratuar të auditimit, ku mund të përmendim:

Grupi i auditimit rithekson faktin se, gjatë gjithë këtij procesi, *drejtuesit e ASHSH kanë penguar dhe vonuar vendosjen në dispozicion të grupit të auditimit sipas afatit ligjor, të dokumentacionit të kërkuar, fakt i cili është prezantuar si në takimet e zhvilluara me drejtuesit e ASHSH, ashtu edhe në korrespondencën zyrtare të mbajtur me subjektin,* ku mund të përmendim e-mailet e dërguara, sipas periudhave, dhe referuar më poshtë:

- E-mail i datës 08.04.2024, që grupi i auditimit u ka drejtuar Kancelarit z.R.K dhe Sekretarit Shkencor z.Sh.S , me lëndë “*Kërkesë për vendosje dokumentacioni në dispozicion*”, ku është kërkuar sa vijon:

Në vijim të komunikimit për mbarëvajtjen e auditimit, bashkëlidhur do të gjeni kërkesën për vendosjen e dokumentacionit në dispozicion. Ju lutemi, kujdesuni që informacioni të përcillet brenda afateve zyrtare (një javë kalendarike) të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Kreu 2, neni 15, pika dh, e. Për mbarëvajtjen e auditimit lutemi që të dhënat e mësipërme t’i paraqiten grupit të auditimit në formë elektronike brenda dt. 15.04.2024.

- E-mail i datës 16.04.2024, që grupi i auditimit i ka drejtuar z. Sh.S me lëndë “*Njoftim mbi mos vendosjen në dispozicion të dokumenteve të kërkuar në email-in e datës 08.04.2024*” me këtë përmbajtje:

Në cilësinë e pikës së kontaktit, ju bëjmë me dije se grupi i auditimit me anë të email-it zyrtar me datë 08.04.2024 ka paraqitur kërkesën për vendosjen në dispozicion të dokumenteve dhe informacioneve të nevojshme për fillimin e auditimit në bazë të Njoftimit për Projektin e Auditimit me nr. 416 prot., datë 25.03.2024. Deri më sot, grupit të auditimit i janë vendosur në dispozicion vetëm Analizat Vjetore të Veprimtarisë së ASH dhe baza ligjore, ndërkohe që për pikat e tjera (buxheti, donacione, përshkrim për Qendrat Kerkimore Shkencore, info për numrin e projekteve, procedurën e aplikimit/pranimit të tyre etj.), nuk na keni vendosur asgjë ne dispozicion. Për sa më sipër, ju informojmë se keni tejkaluar afatin ligjor (një javë kalendarike) i përcaktuar në Ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kreu 2, neni 15, pika "dh" dhe "e", çka ju ngarkon me përgjegjësi ligjore.

Ne takimin e datës 09.04.2024 me znj. A.DH dhe znj. A.B. u dakordësua që brenda datës 09.04.2024 do të na vendosej në dispozicion:

1- Udhëzimi i Brendshëm që rregullon procedurën e aplikimit.

2- Data base e projekteve të aplikuara/miratuara, shoqëruar me vlerën e financimit të tyre, autorësinë, statusin, etj.

3- Dosjet fizike të projekteve, të cilat duhej të vendoseshin në dispozicion brenda datës 16.04.2024. Sot më datë 16.04.2024 ora 10.00, grupi i auditimit u paraqit në ambientet e ASH dhe kërkoi takim me Sekretarin Shkencor të ASH z. SH.S.(*në cilësinë e pikës së kontaktit*) dhe znj. A.B dhe znj. A.DH siç u dakordësua në takimin paraardhës të datës 09.04.2024. Pas komunikimit nepermjet Kancelarit, ju dhe zonjat e sipër përmendura nuk u paraqitët në takim me grupin e auditimit.

Do ju kërkonim edhe një herë që, në respektim të Ligjit nr. 154/12 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Kreu 2, neni 15, pika dh, e, të vendosni në depoziton dokumentet e kërkuara me email-in e datës 08.04.2024 deri nesër, në orën 09.00, kur grupi i auditimit do të paraqitet përsëri për takim me ju në Akademinë e Shkencave.

- E -mail i datës **03.05.2024** që grupi i auditimit i ka drejtuar z.Sh.Sinani, me lëndë "**Kërkesë për vënien në dispozicion të dosjeve fizike të projekteve të ASH**", me këtë përmbajtje:

Në kuadër të auditimit të performancës mbi projektet kërkimore-shkencore të realizuara nga Akademia e Shkencave dhe në vijim të takimit më të fundit në të cilin kërkuam të na viheshin në dispozicion dosjet fizike të 6 projekteve të realizuara ne vitin 2020, (të cilat ende nuk janë vendosur në dispozicion), ju kërkojmë edhe një herë në shkresën bashkëngjitur që të na vihen në dispozicion dosjet e plota fizike të projekteve të aplikuara / realizuara nga Akademia e Shkencave përgjatë periudhës 2019-2023.

- E -mail i datës **22.5.2024** që grupi i auditimit i ka drejtuar z.Sh.S me lëndë "**Kthim përgjigje ndaj shkresës së Kryesisë së ASHSH**" me këtë përmbajtje:

Bashkëngjitur gjeni kthim përgjigjen e Grupit të Auditimit të Performancës mbi projektet shkencore ndaj shkresës së Kryesisë së ASHSH me nr. 896/37 prot., datë 21.05.2024.

Në përmbajtje të shkresë dërguar *në attach* është theksuar ndër të tjera:

...Në takimet e zhvilluara, grupi i auditimit është informuar nga Sekretari Shkencor i Akademisë së Shkencave mbi një projekt/studim me objekt kurrikulat e matematikës dhe fizikës në arsimin para universitar. Ky projekt/studim nuk i është vënë në dispozicion grupit të auditimit dhe nuk gjendet në "data base" e listës së projekteve të dërguara nga ASHSH grupit të auditimit.

Nga shqyrtimi paraprak i grupit të auditimit në prezencë të Kancelarit të ASHSH-së dhe koordinatores së projekteve është konstatuar se vetëm dosjet e dy projekteve (ArkeoBylis dhe Hg Vlora) kanë një listë inventari, ndërsa pjesa tjetër janë të pa inventarizuara sa i përket dokumentacionit që ato përmbajnë. Në vijimësi, grupi i auditimit do të shqyrtojë dhe konsultojë në

mënyrë të detajuar të gjitha dokumentet e vëna në dispozicion në dosjet fizike të 14 projekteve të dorëzuara më datë 21.05.2024. Pas këtij procesi do t'ju informojmë mbi situatën e dokumentacionit të dorëzuar në këto dosje.

Sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj vënien në dispozicion të 25 dosjeve fizike të projekteve të sipër listuara, brenda datës 23.05.2024.

- E-mail i datës **04.06.2024**, që grupi i auditimit i ka drejtuar z.Sh.Sinani, ***“Kërkesë për dokumentacion dhe info mbi auditimin e projekteve shkencore nga KLSH”***, me këtë përmbajtje:

Bashkëngjitur gjeni Pyetësin nr.2 me disa pyetje për të cilat do të donim përgjigje dhe vendosjen e dokumentacioneve në dispozicion nga ana juaj.

Gjithashtu, ju lutemi të konfirmoni listën e projekteve të realizuara nga ASH përgjate periudhës 2019-2023. Lutemi në respektimin e afateve ligjore për kthimin e përgjigjeve.

ANEKS I: Tabela e projekteve të Akademisë së Shkencave⁴⁰

Përmbledhja

I.	Projektet madhore të albanologjisë me financim nga Akademia.....	57
II.	Projekte me financim nga Akademia 2020 – 2022.....	57
III.	Projekte me financim nga Akademia gjatë 2023 (përfshi ato në vijim nga 2022).....	59
IV.	Projekte me financim nga AKKShI në kuadër të thirrjes PKKZh 2022 – 2023 ose bilaterale.....	61
V.	Projekte me financim nga AKKShI në kuadër të thirrjes PKKZh 2023-2024.....	62
VI.	Projekte me financim nga AKKShI në kuadër të thirrjes PIKZh 2023-2024.....	64
VII.	Projekte me financim nga AKKShI 2023-2024 në kuadër të thirrjes bilaterale me Kosovën ..	64
VIII.	Projekte me (bashkë)financim nga programi i BE-së Interreg-Adrion (2023 – 2026).....	65
IX.	Projekt propozime për financim nga ASHSh gjatë vitit 2024.....	65
X.	Projekte të mbështetura nga Akademia për vitin 2024.....	67
XI.	Projekte COST (në pritje).....	67
XII.	Projekte bilaterale me jashtë	68
XIII.	Projekt-ide në kuadër të bashkëpunimit me ASHAK-un, Akademinë e Shkencave dhe Arteve të MZ (CANU), me Akademinë e Shkencave Bujqësore dhe Pjore të Rumanisë (AASFR) dhe skemat COST	68

I. Projektet madhore të albanologjisë me financim nga Akademia

Nr.	Titulli i projektit	Drejtuari i projektit dhe stafi	Njësia/komisioni/seksioni	Periudha	Status	Buxheti (lekë)	Shënim
1	Enciklopedia shqiptare (në 10 vëllime)	Redaksia qendrore Redaksia vendore	QBAE / QBEA	Vazhdim nga vitet e mëparshëm 2023-2028	Në proces: Stabilizim i fjalësit dhe i autorëve	20,000,000	40,227,000 lekë për vitin 2024
2	Fjalori i madh i gjuhës shqipe	J. TH V. M	QBAE / QBEA	Vazhdim nga vitet e mëparshëm	2021-2024 Në përmbyllje Përfundon më 2024	17,000,000	7,926,000 lekë për vitin 2024
3	Historia e shqiptarëve (në 3 tre vëllime)	N. C P. Xh P. M	QBAE / QBEA	Vazhdim nga vitet e mëparshëm	2021-2024 Në përmbyllje Dorëzuar për redaktim	12,000,000	11,027,000 lekë për vitin 2024

Burimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë

II. Projekte me financim nga Akademia 2020 – 2022

Nr.	Titulli i projektit	Drejtuari i projektit dhe stafi	Njësia/komisioni/seksioni	Periudha	Status	Buxheti (lekë)	Shënim
4	Udhëzuesi kombëtar për adoptimin e Eurokodeve	Prof. SH.A Dr. M.B Ing. S.A	SshNT	2020-2021	Përfunduar	500,000	
5	Studimi i ndryshimeve mjedisore me imazhet satelitore	Akad. N.F Prof. H.H.	SshNT	2020-2022	Përfunduar	70,000	Në kuadër të protokollit me me ASHAK
6	Studimi seroepidemiologjik i gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-COV-2 ne popullatën shqiptare	Prof. dr. G.S Prof. asoc. A.Y	Komisioni i mjekësisë	2020-2022	Miraturar VKA 33 dt. 7.5.2020 Përfunduar	total 24,185,992 16,227,779 6,411,264	Përgjigjja imunitare (seroprevalenca) e popullsisë shqiptare ndaj

⁴⁰ Dokumenti “Projektet në ASHSH 2020-2024”, dërguar elektronikisht nga Sekretari Shkencor i ASHSH, z. SH.S, nëpërmjet e-mail të datës 26.04.2024.

	SEROIMUNE				2022-faza 4 2021-faza 3 2020-faza 1+2	1,546,949	pandemisë se infeksionit Covid-19 Rezultatet vijnë
7	Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësimi dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës (projekt pilot në rrjet)	Akad. E.K Prof. asoc. dr. V.S Prof. J.M MscL.XH Prof. A.B Prof. M.C Dr. E.P Dr. R.S Msc. A.R	Qendra kërkimore bioteknologji & gjenetikë	2022-2024	Vijon 2023-faza 2 2022-faza 1	1,456,198 867,600	500,923 lekë për vitin 2024
8	Identifikimi i polimorfizmit D/1 te gjenit ACE në një grup prej 100 individësh te shëndetshëm te popullates shqiptare Banka gjenetike	Akad. I.Mi Prof. G.Z	Njësia bioteknologji & gjenetikë	2020-2022	Miraturar VKA 33 dt. 7.5.2020	Nuk është realizuar për shkak të ndarjes nga jeta të prof. Grigor Zoraqit	
9	Projektimi dhe validimi i sensorit imunitar për matjet e niveleve të ferritinës në gjak në pacientët COVID-19 duke përdorur elektroda me bazë karboni të modifikuara me nanostruktura IMOFERRICEN	Prof. asoc. V.A Prof. dr. M.V Prof. asoc. C.F Msc G.H	Qendra kërkimore Nanoteknologji NanoAlb	2020-2021	Përfunduar	7,000 EUR	
10	Nanoveshje me veti antivirale e sipërfaqes me bazë çimento. NANOVIR	Prof. asoc. A.K Prof. dr. P.M Prof. dr. S.D Prof. asoc. I.B Prof. asoc. A.R	Qendra kërkimore Nanoteknologji NanoAlb	2020-2021	Përfunduar	15,200 EUR	
11	Prodhimi i membranave nanofibroze me zeolite të inkuorporuara për aplikime në filtrimin e ujit ZEINANOF	Dr. A.H. Prof. asoc. I.K Prof. E.B Prof. P.M Prof. asoc. A.R Prof. B.B.	Qendra kërkimore Nanoteknologjisë NanoAlb	2020-2021	Përfunduar	13,930 EUR	
12	Bio-plastikë me bazë niseshiteje modifikuar kimikisht me komponime të oksidit të grafenit të dizajnuara si filma paketimi ushqimor me veti antibakteriale Bio-mGO	Prof. asoc. A.B Prof. dr. F.P Prof. asoc. S.A Prof. dr. P.M Dr. A.GJ Prof. asoc. A.R Dr. A.N-H Prof. A.O Prof. S.U	Qendra kërkimore Nanoteknologjisë NanoAlb	2020-2021	Përfunduar	1,389 EUR	
13	Përdorimi i materialit të karbonit të nanostrukturuar në projektimin e sensorit elektrokimik për zbulimin e mbetjeve të antibiotikëve në mjedis NCMES	Dr. A.V. Dr. F.S. Dr. M.V Dr. N.B Dr. E.M	Qendra kërkimore Nanoteknologjisë NanoAlb	2020-2021	Përfunduar	5,000 EUR	

III. Projekte me financim nga Akademia gjatë 2023 (përfshi ato në vijim nga 2022)

Nr.	Titulli i projektit	Drejtuesi i projektit dhe staffi	Njësia/komisioni/seksioni	Periodha	Status	Buxheti (lekë)	Shënim
14	Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësimit dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës (Projekt Pilot në Rrjet) VITROCERT 1	Akad. E.K Prof. asoc. dr. V.S	Qendra Bioteknologji & Gjenetikë	2022-2023	Vijon 2023-faza 2 2022-faza 1	867,600 1,456,198	500,923 Lekë për vitin 2024
15	Ngritja e Kriobankës, e para në Shqipëri për konservimin e materialit gjenetik të specieve dru frutore autoktone në Laboratorin e ri të Qendrës CRYOFRUIT	Akad. E.K Prof. asoc. V.S	Qendra kërkimore Bioteknologji & Gjenetikë	2023-2024	Miraturar Vijon në 2024	1,232,280 për vitin 2023 (parashikimi total 7,585,608)	4.800.000 Lekë për vitin 2024
16	Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësimit dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës (Projekt Pilot në Rrjet) VITROCERT 2-2023	Akad. E.K Prof. asoc. V.S Prof. J.M Msc. L.XH Prof. A.B Prof. M.C Dr. E.P	Qendra kërkimore bioteknologji dhe gjenetikë	2022-2024	Miraturar Vijon në 2024	1,456,198 për vitin 2023	
17	Ngritja e një banke kombëtare të ADN në popullatën shqiptare për studime gjenetike në këtë popullate dhe organizimi i një regjistri kombëtar dhuruesish të qelizave staminale për nevojat e transplantit të këtyre qelizave në Shqipëri ADN CELLSTAM	Akad. G.S. Akad. I.M Prof. Z.Y Prof. asoc. I.Q Stafi laboratorik	Qendra kërkimore bioteknologji dhe gjenetikë	2023-2024	Miraturar Vijon në 2024	13,501,927 lekë për vitin 2023	9.500.000 lekë për vitin 2024
18	Përgatitja dhe karakterizimi i nanofibrave elektrofibra të pastër PVA dhe matricës PVA/MMT për të kapsuluar një vaj esencial të bimës mjekësore shqiptare për aplikime biomjekësore PvaNANOMat	Prof. dr. P.M A.H I.K A.N-Hi A.A-R B.B.	Qendra kërkimore Nanoteknologjisë NanoAlb	2022-2024	Në proces Përfundon Maj 2024	1,393,090	
19	Zhvillimi i një sensori të ri elektrokimik për	L.B M.V	Qendra kërkimore	2022-2024	Në proces	1,758,611	

	kontrollin e cilësisë së mjalitit Eksperimentim në gjetjen e modifikuesit dhe mënyrës së modifikimit HMF-Sens	R.NM	Nanoteknologjisë NanoAlb		Përfundon Maj 2024		
20	Studimi i bashkëveprimit nanobionanopjesëzave dhe nanomaterialeve të modifikuara me organizmat e gjallë dhe qelizat e tyre duke përdorur eksperimente in-vivo dhe modelet kompjuterike NANOBIOTOX	L.V K.Sh C.F M.P I.L	Qendra kërkimore Nanoteknologjisë NanoAlb	2022-2024	Në proces Përfundon maj 2024	1,712,310	
21	Nanosensor për certifikimin e verërave vendase dhe të importuara bazuar në antioksidantët e tyre totalë CERTËINE	K.Xh A.B. M. C. O. Z.	Qendra kërkimore Nanoteknologjisë NanoAlb	2022-2024	Në proces Përfundon maj 2024	2,086,320	
22	Drejt krijimit të Njësisë së Biosensorëve pranë Grupit të Bioteknologjive Molekulare, NanoAlb-Përdorimi i biosensorëve me qeliza të plota dhe elektrokimike për të matur toksicitetin e ujit dhe tokës në bregdetin shqiptar BIOSENSTOIXIC	A. B. L. B. Prof. dr. R.M.	Qendra kërkimore Nanoteknologjisë NanoAlb	2022-2024	Në proces Përfundon maj 2024	2,097,908	
23	Vlerësimi i shpërndarjes së Hg në sedimentet e Gjirit të Vlorës dhe përcaktimi i Hg në peshq, midhje HgVlora	B.B. A.SH M.V N.B P.K	Komisioni i Fizikës dhe Kimisë	2023-2024	Miratur Vijon në 2024	591,790 për vitin 2023 782,000 për vitin 2024	
24	Një platformë e përbashkët për energjinë elektrike ne sistemin elektroenergjetik te Shqipërisë dhe Kosovës PPEE-SESHK	Akad.as R.B Prof. M.C	Komisioni i përhershëm i inxhinierisë	2023	Përfunduar	180,270	
25	“Barleti i rigjetur/rizbuluar-Barleti i heshtur”- Përkthimi nga origjinali e botimi italisht i dorëshkrimit të panjohur të autorit / paratekstit të De obsidione Scodrensi të Marin Barletit	M.M F.A	Njësia për arbëreshët, arvanitët e arbneshtët (NjAAA)	2023	Përfunduar	800,000	
26	Projekti për kërkimet arkeologjike përmes metodave fotogrametrike dhe gjeofizike në Bylis / gërmime metoda gjeofizike i agorasë së Bylisit- ArkeoBylis	Prof. N.C	Njësia kërkimore e përkohshme e arkeologjisë së zbatuar "ArkeoBylis"	2021-2023	Përfunduar 2023-faza 3 2022-faza 2 2021-faza 1	V3 - 957,000 V2 - 912,614 V1 - 951,820	Vazhdimi i dokumentimit dhe verifikimi i rezultateve të prospeksionit gjeofizik i agorasë së Bylisit

IV. Projekte me financim nga AKKShI në kuadër të thirrjes PKKZh 2022 – 2023 ose bilaterale

Nr.	Titulli i projektit	Drejtuesi i projektit dhe stafi	Njësia/komisioni/seksioni	Periudha	Status	Buxheti (lekë)	Shënim
27	Vlerësimi zonal dhe kohor i parametrave fizike, fiziko-kimike dhe sizmike të rrjedhjes së shtetësisë dhe modelimi i energjisë gjeotermale në zonën e Elbasanit	RR.O A.Hi E.Ç G.Ç H.R O.Gj E.HXh.k	Komisioni i përhershëm i inxhinierisë Njësia e gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive	2022-2023 nga AKKShI	Përfunduar Gusht 2023	947,572	
28	Përdorimi i metodave bioteknologjike in vitro dhe të biologjisë molekulare në përpjekje për të fituar material mbjellës të kategorisë "baze" të kultivarëve autokton të kumbullës	E.K V.S E.P F.C M.C S.P A.K	Qendra Kërkimore shkencore e bioteknologjisë dhe gjenetikës Komisioni i biologjisë	2022-2023 nga AKKShI	Përfunduar Gusht 2023	2,057,778	
29	Karakterizimi i variabilitetit gjenetik në popullatat njerëzore shqiptare sipas markerëve gjenetike të ADN-se	I.M E.SH Personeli laboratorik	QKZh e bioteknologjisë dhe gjenetikës	2022-2023 nga AKKShI	Përfunduar Gusht 2023	639,335	
30	Zhvillimi i metodave alternative, inovative dhe ekonomike për kontrollin e cilësisë së produkteve ushqimore	M.V L.B N.B S.C R.M	Qendra kërkimore Nanoteknologjisë NanoAlb	2022-2023 nga AKKShI	Përfunduar Gusht 2023	989,039	
31	Modifikimi i sensorëve të printuar me nanomateriale përpërcaktimin e antibiotikëve në ujëra MOSENSNANO Projekt bilateral për mobilitet, në bashkëpunim me TUBITAK Turqi	M.V	Qendra kërkimore Nanoteknologjisë NanoAlb	2022-2024* nga AKKShI	Miratar Kontrata firmosur në Nëntor 2022 Në proces *	1,000,000 për 2 vjet Në proces *(shtyrë prej tërmetit në Turqi në shkurt 2023)	
32	Ruajtja e gjermoplazmës frutore autoktone shqiptare nëpërmjet teknologjisë së farave sintetike dhe konservimi i avancuar në temperatura ultra të ulëta (kriokonservimi në -196°C) CRYOFRUITS Projekt bilateral për mobilitet, në bashkëpunim me CNR	E.K	QKZh e bioteknologjisë dhe gjenetikës	2023-2025 nga AKKShI	Miratar Kontrata firmosur në Korrik 2023	625,000 Në proces *	

V. Projekte me financim nga AKKShI në kuadër të thirrjes PKKZh 2023-2024

(Për projektet Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit në zbatim nga viti 2023 dhe në vijim të 2024, aplikuar gjatë muajit mars 2023, miratuar me kontrata datë 16.08.2023, disa projekte janë në pritje të realizimit të prokurimeve)

Nr.	Titulli i projektit	Drejtuksi i projektit dhe stafi	Njësia/komisioni/seksioni	Periudha	Status	Buxheti total parashikuar nga AKKSHI	Buxheti që do të mbulojë ASHSH
33	Përdorimi i mjeteve molekulare për detektimin e hershëm të infektimit nga Fusarium & Vlerësimin e tolerancës ndaj faktorëve abiotikë në kultivarë lokalë të grurit Triticum aestivum L.	A.B	Komisioni i Biologjisë, Bujqësisë Veterinarisë	2023-2024	miratuar	2,719,815	
34	Depistimi i kancerit pulmonar, sëmundjes koronare dhe sëmundjes pulmonare obstruktive kronike (SPOK) me tomographi LDCT duke përdorur inteligjencën artificiale CanCorSpo-LDCT	N.F	Komisioni Fizike Kimi	2023-2024	pa miratuar	2,968,100	182,000
35	Vlerësimi i Riskut të Stokut të Ndërtesave Betonarme: Fokusimi në ndërtesat e banimit në Shqipëri	H.B	Komisioni i inxhinierisë	2023-2024	pa miratuar	2,192,000	508,004
36	Studim mbi ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të faktorëve të gjenetikë dhe mjedisorë si klima dhe vegjetacioni në prodhimtarinë dhe qëndrueshmërinë ndaj sëmundjeve racave autoktone të deleve në rrethin e Korçës	N.G	Komisioni i Biologjisë, Bujqësisë Veterinarisë	2023-2024	pa miratuar	2,993,137	564,000
37	Studimi i gjendjes së vend-depozitimit të mbetjeve të Hg në Vlorë dhe vlerësimi i nivelit të Hg në banorët e zonës, dhera, sedimente dhe biotën përreth ish fabrikës	B.B	Komisioni Fizike Kimi	2023-2024	miratuar pa firmosur Fondet u përdorën për NanoBalkan	2,775,500	
38	Plani i menaxhimit të Integruar të Parkut Arkeologjik të Lezhës (Lissus)	N.C	SShSHA		pa miratuar	2,904,644	
39	Energjia diellore- Vlerësimi i potenciali të energjisë diellore në kontekstin e nevojës për energji të ripërtëritshme dhe jeshile në Republikën e Shqipërisë	A.H	Komisioni i inxhinierisë	2023-2024	pa miratuar	2,226,179	466,110
40	Seminari virtual BioMat për zhvillimin e biomatematikës dhe biologjisë komputacionale në Shqipëri dhe themelet e	E.GJ	Komisioni Matematike informatike	2023-2024	miratuar pa firmosur fondet u përdorën për NanoBalkan	1,229,800	

	një bashkëpunimi të integruar kërkimor						
41	Roli i dheneve si portator i Escherichia coli ekskretuese të toksina Shiga, bazuar në strategjinë “Një shëndet”	Xh.K	Komisioni i Biologjisë, Bujqësisë Veterinarisë	2023-2024	miratuar	2,592,265	328,000
42	Vlerësimi ekonomik dhe mundësitë e zhvillimit të turizmit natyror i zonave ligatinore (rast studimor Liqeni i Shkodrës)	A.C	Komisioni i shkencave ekonomike, sociale dhe juridike	2023-2024	miratuar	2,436,000	158,000
43	Vlerësimi inovativ i rolit të biomarkerëve dhe bioindikatorëve në cilësinë e produkteve ushqimore detare	S.D	Komisioni i biologjisë, bujqësisë veterinarisë	2023-2024	miratuar	2,975,500	
44	Përcaktimi i cilësisë së verërave shqiptare në mënyrë të shpejtë dhe të lirë me metodën ex situ	K.Xh	Komisioni i biologjisë, bujqësisë veterinarisë	2023-2024	miratuar	1,910,077	12,000
45	Modelimi i sistemit të integruar të energjisë dhe transportit të energjisë: Roli i energjisë në gaz dhe hidrogjenit në skenarët afatgjatë për Shqipërinë drejt dekarbonizimit të thellë në 2030	P.M	Komisioni i inxhinierisë	2023-2024	miratuar	2,710,040	75,000
46	Studimi i incidencës së virusit Tomato broën rugose fruit virus, sekuencimi i plotë i gjenomës së izolateve Shqiptare duke përdorur nanoteknologjinë MinION në domatet e kultivuara në serra	J.M	Komisioni i biologjisë, bujqësisë veterinarisë	2023-2024	miratuar	2,885,760	
47	Përcaktimi i fosfateve të padeklaruara në ushqime me origjinë shtazore si një mjet i mundshëm drejt parandalimit të mashtrimit	L.V	Komisioni i biologjisë, bujqësisë veterinarisë	2023-2024	miratuar	2,473,100	
48	Studimi i rolit diagnostikues të autoantitropave specifike në sëmundjet e sistemit nervor me mekanizma imune	G.S	Komisioni i mjekësisë	2023-2024	miratuar	2,854,000	
49	Konferenca Ndërkombëtare në Nanoshkencë dhe Nanoteknologji “NanoBalkan 2023”	B.B	Njësia NanoAlb	2023	Miratuar përfunduar	1,029,130	
50	Strengthening innovation capacities in the Balkan region for technology transfer and		SSHNT, ASHAK, Njësia e energjive të ripërtërishme	2024-2025		2.250.000	

	commercialization and knowledge exchange and collaboration through digital infrastructure and connectivity: focus renewable energy						
--	--	--	--	--	--	--	--

Burimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë

VI. Projekte me financim nga AKKShI në kuadër të thirrjes PIKZh 2023-2024

(Për projekte të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor, aplikuar gjatë muajit prill 2023)

Nr.	Titulli i projektit	Drejtuksi i projektit dhe stafi	Njësia/komisioni/seksioni	Periudha	Status	Buxheti total parashikuar nga AKKShI	Buxheti që do të mbulojë ASHSH
51	Përcaktimi i shpejtë dhe i saktë i cilësisë së verërave shqiptare me metoda fiziko-kimike	K.Xh	NanoAlb	2023-2024	pa miratuar	18,570,000	
52	Pajisje kërkimore SEM EDS për përmirësimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Nanoteknologji	P.M	NanoAlb	2023-2024	pa miratuar	38,700,000	

Burimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë

VII. Projekte me financim nga AKKShI 2023-2024 në kuadër të thirrjes bilaterale me Kosovën

(Për projekte bilaterale për aplikime të përbashkëta kërkimore, tekniko-shkencore për periudhë 2-vjeçare, mes Shqipërisë dhe Kosovës, aplikuar gjatë muajit qershor 2023)

Nr.	Titulli i projektit	Drejtuksi i projektit dhe stafi	Njësia/komisioni/seksioni	Periudha	Status	Buxheti total parashikuar nga AKKShI	Buxheti që do të mbulojë ASHSH
53	Pastrimi i ujërave të ndotur me fenole duke përdorur nanomaterialet 2D të karbonit (grafeni dhe oksidi i grafenit) si adsorbentë-Një studim eksperimental dhe teorik	Prof. dr. K.Xh	NanoAlb	2024-2026	Miratuar MarsPrill 2024 Në procedurë dokumentacioni për nënshkrim kontrate	750,790	
54	Riparimi i strukturave të muraturës duke përdorur metodat e aplikimit të FRP (RMS-Repairing the Masonry Structures)	Prof. dr. H.B	Njësia e gjeoshkencës Dhe gjeoinxhinierive	2024-2026	Miratuar MarsPrill 2024 Në procedurë dokumentacioni për nënshkrim kontrate	1,068,500	
55	Vlerësimi i rrezikut sizmik të një sistemi thyerjesh tektonike aktive për një jetë më të sigurt	Prof. asoc. dr. K.S	Njësia e gjeoshkencës Dhe gjeoinxhinierive	2024-2026	Miratuar MarsPrill 2024 Në procedurë dokumentacioni për nënshkrim kontrate	1,068,500	

Burimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë

VIII. Projekte me (bashkë)financim nga programi i BE-së Interreg-Adrion (2023 – 2026)

(85% financohet në kuadër të fondeve IPA dhe 15% nga vetë institucioni si partner përfitues/ zbatues, ndërsa në rastin e partnerit të asociuar, merret rimbursim për kostot e pjesëmarrjes, aplikuar gjatë muajit qershor 2023)

Nr.	Titulli i projektit	Drejtuari i projektit dhe stafi	Njësia/ komisioni/ seksioni	Periudha	Status	Buxheti total parashikuar (EUR)	Buxheti që do të mbulojë ASHSH (EUR)
56	Mbështetja e rrugëve të menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve bujqësore për të përshpejtuar adoptimin e modelit të ekonomisë cikluese në makrorajonin Adriatiko-Jonian AdrionAgroCirc	Prof. dr. I.M	Njësia për energjitë e ripërtëritshme	2023-2026	Në pritje miratimi	124,740	19,000
57	Zgjidhje të bazuara në bio për mbrojtjen dhe zbutjen e ndikimit të specieve të reja ekzotike në rajonet e Adriatikut dhe Jonit BioSPINEAIR	Prof. M.C	Komisioni i biologjisë, bujqësisë e veterinarisë (BBV)	2023-2026	Në pritje miratimi	187,403.5	28,110.5
58	Nxitja e specializimit të zgjuar dhe rritja e kapaciteteve inovative me teknologji të avancuar për krijimin e rajonit të qëndrueshëm Blu dhe të Gjelbër AdriatikJonian SUBER (si partner i asociuar)	Prof. dr. K.G	SShShA Komisioni i shkencave ekonomike, sociale dhe juridike	2023-2026	Në pritje miratimi	si partner i asociuar, përfitim pa fonde	

Burimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë

IX. Projekt propozime për financim nga ASHSH gjatë vitit 2024

Nr.	Titulli i projektit	Drejtuari i projektit dhe stafi	Njësia/ komisioni/ seksioni	Periudha	Status	Buxheti total parashikuar nga ASHSH (lekë)	
59	Vlerësimi sizmik i stokut të ndërtesave betonarme me fokus në godinat e banimit të Shqipërisë SizGoBa	H.B R.O A.B M.L	Njësia e Gjeoshkencave & Gjeoinxhinierive	2024-2025	Në pritje miratimi	1,658,167	
60	Modeli Sizmoteknik i Shqipërisë ModSiz	R.O I.H P.N. D.G E.S R.B D.M O.GJ	Njësia e Gjeoshkencave & Gjeoinxhinierive	2024-2025	Në pritje miratimi	2,000,000	
61	Vlerësimi i dinamikës së vijës bregdetare në rajonin e lumenjve Seman-Shkumbin dhe vlerësimi i impakteve mbi ekosistemet natyrore- Vija bregdetare eko SSh	Prof. Dr H.H Prof. dr. R.Gj Dr. E.B Dr. A.P Dr. A.H Msc. I.T	Njësia e Gjeoshkencave & Gjeoinxhinierive	2024-2025	Në pritje miratimi	1,554,711	bashkëfinancim

62	Karakterizimi morfometrik dhe gjenetik i popullatave të krapit në liqenet natyrore dhe qendrat e kultivimit të rasateve	Akad. A.H	Njësia kërkimore bioteknologji dhe gjenetikë	2024-2025	Në pritje miratimi	3,769,000 për vitin 2024 2,140,867 për vitin 2025 1,628,133	
63	Vlerësimi i dijeve dhe praktikave etnobotanike për bimët mjekësore e erëmirore tek banorët në Bashkinë e Konispolit, Shqipëri DiEtnoBotKon	Akad. N.G	Njësia kërkimore bioteknologji dhe gjenetikë	2024-2025	Në pritje miratimi	1,826,858 për vitin 2024 814,821 për vitin 2025 1,012,037	
64	Studim i niveleve të klorit të lirë dhe aluminit në rrjetin e shpërndarjes të ujit të pijshëm të Tiranës	B.B.	Njësia për pasuritë ujore	2024-2025	Në pritje për aplikim të plotë -> miratim	fond limit 1,000,000	
65	Evidentimi i kapaciteteve të institucioneve kërkimore shkencore në lidhje me monitorimin e cilësisë të ujërave në Shqipëri	B.B.	Njësia për pasuritë ujore	2024	Në pritje për aplikim të plotë -> miratim	fond limit 300,000	
66	Vlerësim i gjendjes dhe sfidave të shkencave ekonomike Shqipëri-Kosovë	Akad. A.A Akad. asoc. A.C	Komisioni i shkencave ekonomike, sociale dhe juridike KESJ	2024-2025	Në pritje miratimi	fond limit 1,000,000	(sipas protokollit ndërkademi me ASHAK)
67	Strategji inovatore in vitro në bioreaktorë nga shfrytëzimi i qëndrueshëmi bimëve aromatike mjekësore (BAM) për prodhimin e metabolitëve dytësorë (MD) të përdorura në farmakologji, si shtesa ushqimore dhe kozmetikë VitroBAM	Akad. E.K V.S A.N B.G A.M	Qendra kërkimoshkencore e bioteknologjisë dhe gjenetikës	2024-2025	Në pritje miratimi	5,590,834 për vitin 2024 1,027,010 për vitin 2025 4,563,824	
68	Studimi i ndryshimeve mjedisore me përdorimin e imazheve satelitore në segmentin ndërkufitar Shqipëri-Kosovë: Bjeshkët e Nëmura-Lugina e Valbonës VALBIEN	Akad. N.F. H.H P.H A.B	SShNT	2024-2025		522,168 për vitin 2024 310,744 për vitin 2025 211,424	
69	5 Projektet NanoAld		Qendra NanoAld	2024-2026		2.5-3 milionë për vitin 2024	

Burimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë

X. Projekte të mbështetura nga Akademia për vitin 2024

Nr.	Titulli i projektit	Shkurtesa	Njësia realizuese	Financuar gjatë 2023	Për vitin 2024 (në lekë)
70	Depistimi i kancerit pulmonar, sëmundjes koronare dhe sëmundjes pulmonare obstruktive kronike (SPOK) me tomographi LDCT duke përdorur inteligjencën artificiale	CanCorSpoLDCT	P.K.	Projekt i ri	2,140,867
71	Karakterizimi morfometrik dhe gjenetik i popullatave të krapit në liqenet natyrore dhe qendrat e kultivimit të rasateve	AquaGenPop	Komisioni i bujqësisë A.H.	Projekt i ri	2,140,867
72	Monitorimi i ajrit në mjediset e brendshme të shkollave dhe institucioneve publike		Komisioni i biologjisë M.S.	Projekt i ri	1,884,000
73	Studimi i niveleve të klorit të lirë dhe aluminit në rrjetin e shpërndarjes të ujit të pijshëm të Tiranës	Klor uji	Njësia për pasuritë ujore B.B.	Projekt i ri	1,000,000
74	Mbi implikimet afatshkurtra dhe afatgjata të emigracionit, ndryshimeve demografike, teknologjisë dhe rritjes së zhvillimit ekonomik		ASHSH, Komisioni ES-J, S. XH.	Projekt i ri	500,000
75	COST CA19109 MEDCYCLONES (Rrjeti europian për ciklonet mesdhetare në mot dhe klimë)	COST	SSHNT N. F. Bashkëpunim kërkimor	Projekt i ri	0 lekë Fonde të BE-së
76	COST CA19134 DGK-Distributed Knowledge Graphs (Rrjetat e shpërndara të dijeve)	COST	SSHNT N. F. Bashkëpunim kërkimor	Projekt i ri	0 lekë Fonde të BE-së
77	COST OC-2021-1-25610 FUTURE4MED (Një rrjet ndërdisiplinor për të kapërcyer shkencën e klimës dhe ndikimet në shoqëri)	COST	SSHNT N. F.	Projekt i ri	0 lekë Fonde të BE-së
78	Studimi i ndryshimeve mjedisore në zonën Bjeshkët e Nëmura-lugina e Valbonës		SSHNT N. F.	250.000	ASHAK
79	Studim mbi ndryshimet mjedisore në zonat kufitare: liqeni i Shkodrës dhe lumi i Bunës		SSHNT N. F.	150.000	

Burimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë

XI. Projekte COST (në pritje)

(85% financohet në kuadër të fondeve IPA dhe 15% nga vetë institucioni si partner përfitues/ zbatues, ndërsa në rastin e partnerit të asociuar, merret rimbursim për kostot e pjesëmarrjes, aplikuar gjatë muajit qershor 2023)

Nr.	Titulli i projektit	Shkurtesa	Njësia realizuese
80	Rrjeti europian për ciklonet mesdhetare në mot dhe klimë (European network for Mediterranean cyclones in weather and climate)	COST CA19109 MEDCYCLONES	SSHNT N.F
81	Distributed Knowledge Graphs	COST CA19134 DGK	SSHNT N.N
82	Një rrjet ndërdisiplinor për të kapërcyer shkencën e klimës dhe ndikimet në shoqëri (Future 4 Mediterranean: a transdisciplinary network to bridge climate science and impacts on society)	COST OC-2021-1-25610 FUTURE4MED	SSHNT N.F
83	Përfaqësues i komitetit të menaxhimit i	COST CA21157	SSHNT

	Shqipërisë për rrjetin europian për klonimin inovativ të bimëve drusore -Aksioni COST (Representative of the Albania Management Committee for CA21157 European Network for Innovative Woody Plant Cloning)	(COPYTREE)	Komisioni i biologjisë
84	Projekt studimor për mësimdhënien e lëndëve matematikë dhe fizikë në sistemin e edukimit	Me FSHNT	Komisioni Matematikë fizikë
85	Program anglisht për IA	Me FSHNT	Njësia IA

Burimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë

XII. Projekte bilaterale me jashtë

Nr.	Titulli i projektit	Njësia realizuese
86	Kurrikul për master në IA në Universitetin Politeknik Tiranë, bashkëpunim me Universitetin e Compiègne-s, Francë (2023-2024)	Njësia IA
87	Ngritja e njësisë së koordinimit me Qendrën Europiane të Kërkimit Bërthamor	IKF, CERN
88	Konkursi ndërkombëtar "Younivers 2023"	IKF, CERN

Burimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë

XIII. Projekt-ide në kuadër të bashkëpunimit me AShAK-un, Akademinë e Shkencave dhe Arteve të MZ (CANU), me Akademinë e Shkencave Bujqësore dhe Pyjore të Rumanisë (AASFR) dhe skemat COST

Nr.	Titulli i projektit	Njësia realizuese	Buxheti (në lekë)	Institucioni bashkëpunues
89	Ekspozitë pomologjike autoktone	Komisioni i bujqësisë E. K	100,000	Bilateral AKKSHI
90	Studimi i gjenetikës së popullatës të Kosovës (sipas modelit në Shqipëri)	Njësia e bioteknologjisë I. M	-	ASHAK
91	Vlerësimi i rrezikut sizmik të një sistemi thyerjesh tektonike aktive për një jetë më të sigurtë, 2-vjeçar	Njësia e gjeoshkencave Rr. O	2,000,000	ASHAK
92	Mikrozonimi sizmik i qyteteve Tiranë dhe Prishtinë, 2-vjeçar	Njësia e gjeoshkencave Rr. O	1,600,000	ASHAK
93	Studimi i burimeve natyrore të ujit gjatë zonës kufitare Shaipëri-Mali i Zi dhe lidhja e hartave hidrogeologjike; 2-vjeçar	Njësia e gjeoshkencave Rr. O	3,000,000	CANU
94	Mekanizmat epigjenetike të adaptimit të kulturave bujqësore ndaj ndryshimeve klimatike	Komisioni i bujqësisë E. B Bashkëpunim kërkimor		COST
95	Zbulimi i hershëm i patologjive të pemëve frutore (sëmundje bakteriale, virale) bazuar në mjete të kombinuara konvencionale dhe molekulare	Komisioni i bujqësisë V. S / M.C		AASFR Rumani
96	Karakterizimi i diversitetit gjenetik ex situ të hardhisë dhe Zbulimi, ndikimi dhe menaxhimi i viruseve të hardhisë duke përdorur mjete konvencionale dhe molekulare	Komisioni i bujqësisë E. B		AASFR Rumani
97	Zbulimi i tolerancës së të korrave ndaj streseve biotike/abiotike nëpërmjet testimit në terren dhe laboratorik të germplazmës lokale nga Rumania dhe Shqipëria.	Komisioni i bujqësisë V. I		AASFR Rumani
98	Karakterizimi gjenomik i racave të blegtorisë lokale për një bujqësi të qëndrueshme	Komisioni i bujqësisë A,H		AASFR Rumani
99	Zhvillimi i akuakulturës duke futur teknika dhe teknologji të reja të përshtatshme për vlerësimin e diversitetit gjenetik dhe sistemet e bujqësisë në të dy vendet	Komisioni i bujqësisë R. S		AASFR Rumani

Burimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT